



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 25 QERSHOR 2009**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
25. JUNA 2009. GODINE**

**QERSHOR – JUN
2009**

Seancën e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Mirë se keni ardhur në seancën e sotshme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 66 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për t'ia filluar punës.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kryesia së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare kanë përgatitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ndërkohë, në pajtim me Rregullën 23.2 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur 23 qershor 2009, me propozim të Komisionit për Buxhet dhe Financa vendosi që Kuvendit t'i propozojë për seancën e sotme plenare Shqyrtimin e dytë të Projektligjit për partneritet publiko-privat dhe koncesione për sigurimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre.

I lus deputetët që me një ngritje dore të deklarohen për propozimin e Kryesisë. Faleminderit! A ka kundër? 6 “kundër”,

(Reagim nga salla)

Nuk ka nevojë, u votua dhe në rend të ditës hyn pika e fundit e rendit të ditës. Nuk ka nevojë për të folur shumë, Gani, se u votua. Ligji futet në rend të ditës me shumicën e votave. 6 ishin “kundër”. A ka abstenime? Nuk ka. Faleminderit!

Me konsultat që kam pasur, deputetë, ju lus, Kuvendi ka rend. Kush do ta marrë fjalën, e ngrit dorën, dhe s'ka nevojë, ju votuat dhe hyni në rend të ditës.

Dy deputetë, me kërkesat e tyre, donë t'i ngrenë dy çështje. Fjalën e ka Kaqusha Jashari.

KAQUSHA JASHARI: I nderuar Kryetar,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë, kolegë,

Më lejoni që si deputete e Partisë Social-Demokrate ta shpreh indinjatën dhe shqetësimin tim me rastin e burgosjes në Bullgari të kryetarit të Partisë Social-Demokrate dhe të ish - Kryeministrit të Kosovës, Agim Çekut, në bazë të një akuze të pabazë dhe të motivuar politikisht nga Serbia.

Shqetësimit tim për këtë ngjarje që është një goditje dhe fyerje e rëndë për shtetin e Kosovës, jam e bindur se i bashkëngjiteni edhe ju të gjithë kolegët e mi deputetë dhe të gjithë qytetarët e Kosovës. Prej ditës ku është dhënë rasti përmes mjeteve të informimit, kemi marrë shumë telefonata, shumë interesim të qytetarëve për rastin, prandaj i bëj thirrje dhe këtij Parlamenti dhe të gjitha institucioneve vendore dhe ndërkombëtare që t'i bëjnë të gjitha përpjekjet të duhura për lirin e tij, zotit Agim Çekut, por edhe që të ndalojnë ndikimin e dëmshëm të politikës serbe edhe në të ardhmen.

Unë i vlerësoj angazhimet e institucioneve të Kosovës, posaçërisht të Ministrisë së Jashtme, të Ministrisë së Rendit, të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Qeverisë në përgjithësi, të kreut të Qeverisë për angazhimin në këtë rast dhe besojmë se ato do të vazhdojnë presionin e duhur te institucionet bullgare që ky rast të përfundojë dhe të rezultojë me lirin e zotit Agim Çeku.

Shpresojmë se ky do të jetë rasti i fundit që një qytetar dhe zyrtar i Kosovës do të ndalohet nga akuzat politike dhe shpifjet që vijnë nga Beogradi. Ne besojmë se institucionet tona, në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare, do t'i ndalojnë arrestimet e tilla arbitrare, sepse tani jemi shtet dhe ne duhet të mbrojmë dhe të ruajmë dinjitetin e qytetarëve tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!
Fjalën e ka kërkuar edhe deputeti Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Unë kam dalë, kolegë, para jush, që të shpreh dy shqetësime, njëri nga të cilët pjesërisht u përmend nga kolegja, arrestimet e shqiptarëve nga Interpoli në bazë të akuzave të Serbisë nuk po kanë të ndalur. Vetëm gjatë këtyre 10 ditëve kemi dy të arrestuar, rasti i fundit i arrestimit të gjeneral Agim Çekut nga autoritetet bullgare, si dhe rasti i ish-ushtarit të UÇK-së, Genc Zogaj, i arrestuar në Hungari dhe i ekstraduar në Serbi gati dy javë më parë.

Të nderuar kolegë,
Ndaj shqetësimin tim, besoj edhe të tuajin dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës për këto arrestime, të cilat kanë për qëllim jo vetëm kufizimin e lirisë së lëvizjes së qytetarëve të Kosovës, por edhe përpjekjen për ta kriminalizuar luftën e drejtë të UÇK-së.

Me këso akuzash të montuara janë arrestuar nga autoritetet e Interpolit disa ish- luftëtarë të UÇK-së, të cilët janë gjykuar dhe gjenden në vuajtje të dënimit në Serbi.

Të nderuar kolegë,
Kërkoj nga institucionet e Republikës së Kosovës që të kërkojnë zyrtarisht nga Interpoli që kosovarët të arrestuar të ekstradohen në Kosovë, si dhe të ndërpriten praktikrat e tilla denigruese për popullin e Kosovës.

Dhe, çështja e dytë, sipas statistikave të Policisë së Kosovës, gjatë 6 vjetëve të fundit, nga aksidentet në trafik, nëpër rrugët e Kosovës kanë humbur jetën mbi 1000 qytetarë, ndërkaq vetëm gjatë këtij viti mbi 30 sish duke përfshirë edhe fëmijë.

Jam thellësisht i shqetësuar që në qytetin e Prishtinës, ku shpejtësia maksimale e lejuar është 35 kilometra në orë, gjatë dy muajve të fundit kanë ndodhur disa aksidente, nga të cilët kanë pësuar tragjikisht katër këmbësorë, tre prej të cilëve fëmijë nën moshën 13 vjeç. Rasti i fundit tragjik ka ndodhur para tri ditëve, disa dhjetëra metra larg nga kjo ndërtesë, ku në kalimin për këmbësorë u aksidentuan dy këmbësorë, njëri ndër të cilët, pak kohë pas aksidentit, ka ndërruar jetë.

Kërkoj nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe nga autoritetet komunale që t'i ndërmarrin të gjitha masat ligjore për të parandaluar tragjedi të tilla. Është shumë shqetësuese që në veçanti këmbësorët janë të rrezikuar në çdo moment nga ngasësit e pandërgjegjshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ju njoftoj se dy deputetët që folën kanë qenë të lajmëruar më parë në bazë të Rregullores. Deputetët e tjerë që janë lajmëruar, unë nuk di për temat që kanë për t'i shtruar. Vazhdojmë me rendin e ditës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, por para se të filloj me pikën e parë të rendit të ditës, besoj që më lejoni, deputetë të nderuar, që të kërkoj nga Presidenti i Kosovës, nga Kryeministri dhe nga dy ministrat, nga ministri i Punëve të Jashtme dhe ministri i Rendit, t'i kryejnë të gjitha obligimet e tyre që i kanë me Kushtetutë dhe ligje dhe vërtet të kërkojnë nga organet përgjegjëse evropiane dhe ndërkombëtare që praktika e ndjekjes së qytetarëve të Kosovës, nga Serbia, që ndjek një politikë të vjetër, të ndërpritet ose edhe qytetarët të disiplinohet, të dinë se kah duhet të lëvizin dhe kur duhet të lëvizin, në këto rrethana kur vërtet Kosovës dhe qytetarëve të saj u bëhen shumë kufizime në drejtim të lëvizjes dhe të qarkullimit.

Çështja e komunikacionit është një çështje në vete. Mendoj që duhet të kërkojmë nga Policia e trafikut që t'i respektojnë më rigorozisht ligjet që janë në fuqi, sepse konsiderojmë se ligjet nuk janë duke u respektuar jo vetëm në qytet, por edhe në të gjitha pjesët e Kosovës.

Vazhdojmë me rendin e ditës, pika e parë:

- Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 28 e 29 maj dhe 11 e 18 qershor 2009

Ju njoftoj se procesverbalet dhe transkriptet e seancave plenare të mbajtura më 28 dhe 29 maj 2009 u janë shpërndarë deputetëve, ndërsa për seancën plenare të 11 dhe 18 qershorit është shpërndarë vetëm procesverbali. Pyes deputetët a kanë vërejtje në procesverbalet e cekura? Meqë nuk ka vërejtje, atëherë konstatoj se Kuvendi miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 28 e 29 maj si dhe më 11 e 18 qershor 2009.

Pika e dytë me radhë është:

- Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në mes të dy seancave është parashtruar një numër i madh i pyetjeve parlamentare, saktësisht 30 pyetje, ndërsa koha e paraparë është kufizuar në 50 minuta. Procedimi i pyetjeve do të bëhet sipas kohës së parashtruar dhe numrit rendor të pyetjeve.

Pyetja e parë është e drejtuar nga deputetja Suzan Novobrdaliu, për Kryeministrin, zotin Hashim Thaçi, që nuk është këtu. Deputete, a doni ta lexoni pyetjen? Urdhëroni! E ka fjalën deputetja Suzan Novobrdaliu.

SUZAN NOVOBRDALIU: Në njërën nga vizitat që i keni bërë QKUK-së, keni deklaruar, parafrazoj, se njeriu më i sëmurë del nga spitalet tona se sa kur hyn këtu. Në buxhetin për vitin 2009, Ministrisë së Transportit dhe të Postë-Telekomunikacionit i ndahet dyfishi buxhetor në krahasim me Ministrinë e Shëndetësisë. Meqë gjendjen në Shëndetësi ju e keni definuar me një fjalë që e thamë në fillim, del krejtësisht paradoksale

kjo mënyrë e ndarjes së buxhetit, kur shëndeti i njeriut vërtet është mbi të gjitha. Pyetja, zoti Kryeministër, të gjitha politikat e deritanishme karshi shëndetit të qytetarëve të Kosovës kanë rezultuar të dështuara, atëherë ju lutem, a keni projektuar politika të tjera buxhetore dhe kadrovike për ta shëruar shëndetësinë kosovare, apo mos jeni duke zhvilluar politika të qëllimshme, dështuese karshi partnerit tuaj, kur dihet që ministri i Shëndetësisë vjen nga Lidhja Demokratike e Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Shkojmë më tej.

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajazi. Ministri është në vizitë në Hungari. A doni ta lexoni pyetjen? Faleminderit!

Pyetja e radhës, deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.

(Reagim)

Mirë, fjalën e ka deputeti Riza Smaka.

RIZA SMAKA: Sipas mjeteve informative të shkruara dhe elektronike, në vendin tonë numri i vetëvrasjeve rrjedhimisht është në rritje. Shkaqet e vetëvrasjeve mund të jenë të shumta dhe të ndryshme, por gjithsesi në mjedise dhe periudha të caktuara ato mund të jenë më tipike dhe më karakteristike. Shkaqet e vetëvrasjeve sikundër të identifikoheshin, të klasifikoheshin, të kategorizoheshin metodologjikisht si dhe sa duhet, do të mund të analizoheshin me profesionalizëm adekuat dhe së andejmi do të mund të rezultonin njohuri të duhura, si për kauzat, ashtu edhe për konsekuencat dhe së andejmi do të mund të bëhej diçka, nëse jo shumëçka në reduktimin esencial të vetëvrasjeve në vendin tonë. Faleminderit! Kjo ishte pyetja.

KRYETARI: Vazhdojmë.

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi. Deputete, a doni ta lexoni pyetjen?

GJYLNAZE SYL: Faleminderit!

Së pari, dua të protestoj për mos prezencën e Qeverisë, sepse po pengon kryerjen e funksionit të Kuvendit të Kosovës në mbikëqyrje.

Zoti Kryetar, ju ftoj që të kryeni përgjegjësinë dhe të siguroni që anëtarët e Qeverisë do të jenë këtu që të përgjigjen në pyetje. Do ta pres ministrin që t'i përgjigjet pyetjes sime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Pyetja e radhës, deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, zotin Zenun Pajaziti.

A doni ta lexoni pyetjen?

RIZA SMAKA: Në vendin tonë, numër i konsideruar i qytetarëve, aktualisht posedojnë, madje mbajnë armë të zjarrta, pa leje zyrtare. Gjendja e tillë është e pavolitshme për sigurinë e qytetarëve dhe për rendin publik në vendin tonë. Në funksion të zgjidhjes së këtij problemi aktual, akut shoqëror, zotëri ministër, çfarë janë objektivat programore të Ministrisë të cilën ju aktualisht e administroni? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala.

RIZA SMAKA: Sipas publikimeve mediale dhe njohurive empirike personale, kontratat për privatizimin e pronave dhe të aseteve shoqërore kryesisht nuk përfillen me konsekuencë dhe në atë mënyrë, ndër të tjera, privatizuesit dëmtojnë ligjin, bashkë me interesat e shumë punëtorëve dhe subjekteve ekonomike deri në privatizimin e tyre.

Zoti ministër, si qëndron çështja në këtë temë socio- legale tepër delikate? Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. A doni ta lexoni pyetjen, deputet?

DRITON TALI: Zoti Kryetar, është njëra nga këto pyetje që shpesh ia kemi bërë zotit ministër, është për punën e pagave që marrin në Trustin e Pensioneve. E kam bërë këtë pyetje duke pasur parasysh që ministri na tregon se e ka bërë biznes partnerin e vet atje kryetar të Bordit, andaj ma merr mendja që ai e informon për informata, por po pres kur të vijë ministri, t'ia bëj atij pyetjen e të na informojë se sa paguhet menaxhmenti dhe Bordi në atë Trustin e Pensioneve? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, që e shfrytëzove kohën, por unë konsideroj që me çështjen e të ardhurave në Trustin e Pensioneve nuk është marrë asnjëherë Qeveria, këtë e di.

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. Deputet, a dëshiron ta lexosh pyetjen? E ka fjalën deputeti Naim Rustemi.

NAIM RRUSTEMI: Unë pyetjen po e bëj me siguri se ndoshta edhe Departamenti i Thesarit e dëgjon këtë pyetje, e di që po bën shkelje të rëndë ligjore, po i shpërndan paratë qysh po do, por unë po dua t'ia drejtoj drejtpërdrejt ministrit Ahmet Shala, le ta dëgjojë publikisht.

Të dhënat tregojnë se ka raste ku punonjësit, shërbyesit civilë ose zyrtarët e një autoriteti publik ose organizate buxhetore sipas një akti të Qeverisë, kërkohet që të shërbejnë në një komision, bord ose organ apo autoritet publik dhe për këtë shërbim pranojnë kompensim shtesë. Pyetja ime është: Pse nuk e respektoni Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë në Ministrinë që ju e drejtoni dhe a mund të tregoni si i ndani paratë?

KRYETARI: Faleminderit! Ti e di se edhe në mandatin e kaluar e keni shfrytëzuar të njëjtin gjë, edhe pse ka qenë edhe atëherë e paligjshme. Ka qenë ligji edhe mirë ka qenë. Deputetja Myrvete Pantina, pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Valton Beqiri.

MYRVETE PANTINA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Deri më tani shumë monumente kulturore historike kanë qenë të lëna në mëshirën e kohës. Këtë fat e ka pasur edhe Kalaja e Vushtrrisë, por me buxhetin e Kosovës për vitin 2009 janë ndarë 60 mijë euro për renovimin e kësaj kalaje.

Zoti ministër, a ka gjasa që ky projekt të realizohet gjatë këtij viti, ashtu siç është paraparë?

KRYETARI: Faleminderit! Fjala është për ministrin.

MINISTRI VALTON BEQIRI: Faleminderit!

I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderur deputetë,

E nderuara deputete Pantina,

Përgjigja është po, por para se ta them këtë përgjigje, më lejoni ta elaboroj pak më gjatë këtë çështje.

Në Programin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për investime në monumentet e trashëgimisë kulturore ka hyrë edhe Kalaja e Vushtrrisë. Pra, ky monument ka hyrë sipas prioriteteve të hartuara nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.

Sipas programit të punës për qasje, ky Institut ka paraparë që i gjithë programi të zhvillohet në pesë faza, të cilat janë standarde për trajtimin e objekteve me vlera të veçanta. Pra, zakonisht në fazat fillestare ato nuk janë të dukshme për popullatën, për qytetarët. Vetëm fazat e studimit, hulumtimit, incizimit të gjendjes ekzistuese, të hartimit të projektit zbatues dhe konservim dhe restaurim dhe pastaj tek fazën e tretë, pra vijnë deri te zbatimi i projektit për konservim dhe restaurim dhe, natyrisht, hartimin e planit dhe të programit për mirëmbajtje.

Pra, duke pasur parasysh limitet tona buxhetore, ne për këtë vit kemi ndarë 60 mijë euro, me të cilat do të realizohen dy fazat e para. Pra, do të realizohen sivjet, ato janë në kompetencë të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe paraprakisht ne kemi pasur edhe bisedime edhe takime me kryetarin e komunës së Vushtrrisë, drejtorin e Departamentit për Kulturë dhe përpos Kalasë së Vushtrrisë, që është një objekt shumë i rëndësishëm në Vushtri, ne kemi filluar të bisedojmë dhe të gjejmë, të fokusohemi në intervenime të tjera, me qëllim të konservimit dhe të restaurimit për Urën e Vjetër dhe për Hamamin e Vushtrrisë. Pra, janë edhe dy objekte të tjera të cilat ne i kemi në plan t'i realizojmë gjatë vitit të ardhshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputete, a ke pyetje shtesë? Faleminderit!

Deputeti Arsim Rexhepi, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. A doni ta lexoni pyetjen? Urdhëro!

ARSIM REXHEPI: Zoti Kryetar,

Pyetjen nuk dua ta lexoj, por ky fat po më përcjell në të gjitha seancat. Do të thotë, unë i bëj pyetjet dhe ministrat nuk janë këtu, pastaj pyetjet po vjetrohen edhe po dalin nga rendi i ditës.

KRYETARI: Botohen në Buletin.

ARSIM REXHEPI: Unë kam botuar mjaft, por po kam qejf t'i dëgjojnë ata edhe kjo, pa të keq, po kjo nuk është fer prej tyre. Nejse, s'po e lexoj.

KRYETARI: Faleminderit, deputet, po fatin kështu e paske.

Deputeti Naim Rustemi, pyetje për Kryeministrin. A doni ta lexoni pyetjen?

NAIM RRUSTEMI: Çështja: Në muajt e fundit, unë deputeti, zoti Naim Rrushemi, kam ngritur në Kuvend një varg këso rastesh që kanë asocuar në afëra korruptive që kërkojnë hetime të mëtutjeshme.

Rastet e ngritura kanë pasur të vetmin qëllim, zhvillimin e jetës demokratike. Republika e Kosovës, si vend i ri, ka nevojë për ngritjen e transparencës dhe luftimin e korrupsionit. Megjithatë, ju Kryeministër i Republikës së Kosovës, më sulmuat fizikisht në familjen time, përmes vëllait tuaj të njohur me veprimet e tij, zotit Gani Thaçi. Pyetja: A besoni në funksionimin e jetës demokratike në Republikën e Kosovës dhe mundësisht të tregoni pse sulmuat fizikisht familjen time të ngushtë? Sigurisht që publikisht mund edhe të përgjigjet.

KRYETARI: Deputet, çështjet private mos na i bini në institucion. Është çështje private dhe çështjet private nuk janë për debat në Kuvend.

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për Kryeministrin. A doni ta bëni pyetjen, deputete? Regjia, fjalën deputetes Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Kryetar, do ta pres Kryeministrin të vijë këtu. Edhe një herë ju ftoj juve që të siguronit pjesëmarrjen e Kryeministrit dhe të Qeverisë, është mekanizëm mbikëqyrës i Kuvendit mbi Qeverinë. Faleminderit!

KRYETARI: Seanca është publike dhe Qeveria e di që është publike.

Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq.

LULJETA SHEHU: Faleminderit Kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Çështja: Një numër i konsiderueshëm i punëtorëve të ndërmarrjeve të privatizuara nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit kanë humbur jetën gjatë luftës së fundit. Familjarët e tyre nuk e gëzojnë të drejtën për t'i trashëguar mjetet nga 20%. Pyetja është, zoti ministër, kërkoj nga ju të ndikoni në Agjencionin Kosovar të Privatizimit që të respektohen kontratat e privatizimit të ndërmarrjeve me spinoff special, por edhe me spinoff të rregullt që edhe kjo kategori e familjarëve të gëzojë këtë të drejtë, se janë dyfish të goditur.

KRYETARI: Zoti ministër!

MINISTRI NENAD RASHIQ: Poštovani predsedniče,

Kolege ministri,

Dame i gospodo, narodni poslanici,

Poštovana poslanice,

Da budem vrlo iskren da dokumentovano pitanje nisam dobio, ali ono što mogu da vam kažem je da bi to sigurno možda trebali podići na nivo za koji bi trebalo i ostatak vlade da zna, odnosno da preko agencije na jedan način da uključujemo više faktora u tu samu našu grupu, da možemo da pokušamo da radimo nešto povodom toga. Ja stvarno nisam dobio pitanje i zbog toga ne mogu konkretno da vam kažem šta možemo mi kao Ministarstvo preduzeti, ali mogu da vas pozovem da dođete kod mene danas ili stura da o tome porazgovaramo i da vidimo šta bi mi kao Ministarvo mogli da uradimo. Zato, izvolite dođite pa možemo da ... Hvala!

KRYETARI: Deputete, a ke pyetje shitesë ?

LULJETA SHEHU: Faleminderit! Do të tentoj që të shkoj të bisedoj me ministrin dhe do të marrë përgjigje.

KRYETARI: Pyetja e radhës. Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, zotin Valton Beqiri.

DRITON TALI: Faleminderit!

Pyetja është kjo, zoti ministër: Sa ka gjasa që federatat e sportit të Kosovës dhe ato të Shqipërisë të integrohen në një ligë të përbashkët të fushave të caktuara me qëllim të arritjeve edhe të rezultateve më të mira në sferën globale, por edhe të krijohet një coulferajn në sport? Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI VALTON BEQARI: Faleminderit!

I nderuar deputet Tali,

Ju e dini se federatat sportive, si në Shqipëri, si në Kosovë dhe në gjithë botën veprojnë si federata të pavarura dhe se shteti nuk ka të drejtë të inteferimit në punën e tyre dhe bashkëpunimi në mes federatave sportive të Kosovës dhe të Shqipërisë është më se i mirë dhe më se i suksesshëm.

Ky bashkëpunim është i nevojshëm për federatat tona në dy paralele, se pari në ngritjen e kapaciteteve për sportin tonë elitare dhe në paralelen tjetër, në ndikimin e federatave të Shqipërisë, të cilat janë anëtare të federatave ndërkombëtare në lobilizimin dhe në përkrahjen e federatave tona.

Shumë shpesh ndodh që atletët kosovarë, sportistët kosovarë, posaçërisht në sportin individual të jenë edhe përfaqësues të federatave, gjegjësisht të Kombëtares së Shqipërisë, pra ju e dini rastin me Majlina Kelmendin, me notuesen tonë dhe përfaqësimi i drejtpërdrejtë nën flamurin e Kosovës, përpos te federatat të cilat janë të adresuara në Federatën Ndërkombëtare, është i pamundur. Mirëpo, ne edhe në biseda me ministrin Turku, disa herë kemi insistuar që të bëjmë presion në federatat përkatëse që të krijojnë mundësi sa më të mëdha të bashkëpunimit mes federatave. Ne i përkrahim të gjitha federatat dhe për momentin, përpos një iniciative nga Federata e Futbollit për të themeluar një ligë të përbashkët, nuk kemi pasur një iniciativë të ngjashme nga federatat e tjera. Për fat të keq, kjo iniciativë ende nuk është realizuar, natyrisht, sepse mund të ketë pra edhe reperkusione që një klub nga Kosova ta përfaqësojë Shqipërinë. Interesi ynë është që ne të përfaqësohemi drejtpërdrejt, si shtet i Kosovës, në ligat ndërkombëtare, në Federatën Ndërkombëtare, prandaj bashkëpunimi i mëtutjeshëm do të jetë vetëm në favor të ngritjes së kapaciteteve sportive dhe të lobizimit për anëtarësimin e federatave tona në Federatën Ndërkombëtare.

KRYETARI: Faleminderit!

A keni pyetje shitesë?

DRITON TALI: Një koment të vogël, zoti Kryetar, në formë të pyetjes gjithmonë.

Unë mendoj se Qeveria duhet të jetë nxitëse për integrimin në liga rajonale, nëse jo integrimin apo coulferajnat në sport për shkak se, nëse nuk mund të integrohemi në sfera të tjera, në sport nuk na ndal askush. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro!

VALTON BEQIRI: Faleminderit!

Qeveria është e angazhuar dhe ndërkombëtarizimin e sportit e ka marrë si prioritet. Sa u përket ligave rajonale, ne marrim pjesë si shtet në ligat rajonale, pra marrim pjesë në garat e ndryshme të organizuara nga federatat e ndryshme, nga shtetet e ndryshme, por këto organizime nuk janë organizime të cilat janë të ndihmuara, të përkrahura nga Federata Ndërkombëtare. Pra, ekipet tona, kombëtares tona marrin pjesë në ligat dhe turnetë e ndryshme rajonale. Aty mundësohet që ne të bëjmë një lobizim më të madh për anëtarësim dhe ndërkombëtarizim dhe po ashtu shihet niveli i federatave tona në nivelin rajonal. Unë besoj që vetë fakti që ndërkombëtarizimi i sportit është prioritet edhe i Ministrisë, edhe i Qeverisë, tregon mjaft që ne jemi të interesuar që sporti ynë të jetë sa më parë në arenën ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, zotin Nenad Rashiq.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Megjithatë, ishin pyetjet e tjera, nga 5 pyetjet e mia sot, 4 ministra, duke përfshirë Kryeministrin, nuk ishin këtu.

Zoti ministër,

Pyetja ime ka të bëjë me ligjin shumë të rëndësishëm, ligjin bazik siç është Ligji i punës. Ky Ligj është i rëndësishëm, duke marrë parasysh politikat e punësimit, nevojën për rritjen e punësimit dhe zvogëlimin e varfërisë. Sipas strategjisë legjislative të vetë Qeverisë, në vitin 2009 është dashur të procedohet më 31 mars 2009 Ligji për punën. Prandaj, pyetja ime është: Kur do të procedohet për shqyrtim në Kuvendin e Kosovës Ligji për punën? Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, e ke fjalën!

MINISTRI NENAD RASHIQ: Hvala, gospodine predsednče!

Gospodo Syla,

Znate vi da smo nekoliko puta pričali, razgovarali baš o ovom zakonu. Ja znam njegovu važnost, znam koliko je važan, koliko jeste bitan, koliko jeste osnovan za utvrđivanje temelja društva. Ali, kao što znate i sami, ima mnogih elemenata koji utiču i na formiranje zakona, i na tehničke detalje tog zakona. Hoću vrlo jednostavno i kratko da vam kažem da će u julu biti, ja mislim, nadam se, završna faza tehničkih priprema zakona. Znate i sami da smo prošle godine morali da ga predlažemo pa da ga povlačimo. Ono što mogu da vam garantujem, da kada se sledeći put zkon bude predložen na usnovanje u Parlamentu, da više neće biti povlačenja. Zbog toga nam i treba toliko vremena, zbog toga i taj rok koji je bio do 31. maja prošao, da bi naše zakonske regulative unutar tog zakona bile održive.

Mi imamo jedan mali problem u vezi koštanja samog zakona. kada kažem mali, to je negde oko 8 miliona i to moramo da regulišemo, a konkretno očekujem, sa rezervom kažem, da u toku septembra možemo imati taj zakon u Vladi. Posle toga će biti na vama kako će taj zakon dalje ići. Ja se, ako mogu da kažem, u ime Ministarstva izvinjavam ukoliko je došlo do blagog zakašnjenja, ali moramo da shvatimo da i članstvo u

Medjunarodnom momentarnom fondu, i članstvo Svetskoj banci, ne znači benificije samo, nego pre svega znači prava i obaveze koje moramo mi da ispunimo da bi bili na tom našem putu ... Znači, još jednom kažem, mislim, smaram da u toku septembra možemo da imamo taj zakon spremam u toj meri da neće biti više vraćen na ponovnu doradu ili tako neko drugo odlaganje što bi moglo da proizvodi.

KRYETARI: Ju faleminderit! Deputete, ke pyetje shtesë? Urdhëro!

GJYLNAZE SYLA: Zoti ministër, dihet se zbatimi i ligjit gjithashtu përfshin koston e ligjit. A mund të na informoni sa është kostoja dhe a është siguruar buxheti për zbatimin e këtij ligji? Ju faleminderit!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Trenutno, ono što je zadnje došlo iz Vladine grupe, radne grupe kao prošlog zakona ili koštanje zakona je bilo 22 miliona. Ali, moram da podesim da u tom zakonu ima jedna stavka koja je faktički nerealna i naš budžet mnogo može da ošteti, a to je materinsko bolovanje ili pushimi i lehonisë, i to je najveći deo baš tog troška. E sada, po standardima i Evropske Unije i po standardima tih osnovnih i najjačih medjunarodnih faktora, je da to ne može tako u toj meri da bude. Zato, na insistiranje Vladine radne grupe mi çmo stvarno morali da insitiramo da to, da taj veliki trošak redukujemo ili čak potpuno smanjimo. Uglavnom, one osnovne stvari, osnovni status koji će zakon da predvidi, biće predvidjeni u zakonu koji će biti nadam se usvojen u roku koji sam od prilike rekao. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Deputetja Gjylnaze Syla, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj.

A doni ta lexoni pyetjen, deputete?

GJYLNAZE SYLA: Do ta pres ministrin të vijë të përgjigjet. Faleminderit!

KRYETARI: A doni ta bëni pyetjen e radhës që e keni për Kryeministrin?

GJYLNAZE SYLA: Kam kënaqësinë ta pres Kryeministrin, me gjithë injorancën që i bën Kuvendit.

KRYETARI: Sigurisht, edhe Kryeministri e ka kënaqësinë të përgjigjet.

Deputeti Driton Tali, pyetje për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, zotin Ahmet Shala. A doni ta lexoni pyetjen, deputet?

DRITON TALI: I kam disa pyetje për Ahmet Shalën, një ma huqet, ka të bëjë për Saachi & Saachi, numri rendor 14/17.

KRYETARI: Pyetjen që e keni bërë më 11.06. 2009.

DRITON TALI: Jo, a po e shihni, ma keni huq një pyetje, zoti Kryetar, 14/17, po nejse, pasi nuk është edhe ministri, po e lë që ai të përgjigjet me ekspertizën e tij.

KRYETARI: Mirë faleminderit!

Përsëri, deputeti Driton Tali, pyetje për ministren e Energjisë dhe të Minierave, zonjën Justina Shiroka – Pula. A doni ta bëni pyetjen?

DRITON TALI: Ka të bëjë me privatizimin e KEK-ut- diskut në realitet, po pres po ashtu përgjigje profesionale nga zonja eksperte.

KRYETARI: A doni ta bëni pyetjen tjetër që e keni për ministrin Ahmet Shala?

DRITON TALI: Ajo tjetra është, kështu, edhe më profesionale për Post -Bankën, unë e di se ai është një ekonomist i shquar, andaj përgjigjen nga ai do ta prisja.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputetja Zylfije Hundozi, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj. Deputetja nuk është këtu.

Deputetja Nurishahe Hula, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi.

Deputete, a doni ta bëni pyetjen? Urdhëro!

NURISHAHE HULAJ: Do ta bëj pyetjen. Faleminderit!

I nderuar Kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Çështja: Sipas Programit të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2009 kanë qenë të programuara që gjer në qershor të vitit 2009 në shqyrtim të parë të arrijnë këto ligje për ndryshim dhe plotësim të fushës së shëndetësisë, punës dhe mirëqenies sociale, me sa vijon: Ligji për duhanin, për shqyrtim të parë, në shkurt 2009, Ligji për produktet dhe pajisjet medicinale, për shqyrtim të parë, mars 2009, Ligji për skemën e ndihmës sociale, për shqyrtim të parë, mars 2009, Projektligji për punën, për shqyrtim të parë, prill 2009, jo për ndryshim dhe plotësim, Ligji për shëndetësi, për shqyrtim të parë, maj 2009, Ligji për Inspektoratin e punës, për shqyrtim të parë, qershor 2009. Projektligji për sigurime shëndetësore, a do të ketë fatin të arrijë gjer në fund të korrikut 2009, për shqyrtim të parë, jo për ndryshim dhe plotësim. Pyetja është: A është ngritur në nivel qeveritar çështja e këtyre ligjeve dhe përse ka ndodhur që asnjë prej këtyre ligjeve të mos arrijnë në shqyrtimin e parë sipas Programit të punës së Kuvendit për vitin 2009? Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Deputetja Luljeta Shehu, pyetje për ministrin e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, zotin Enver Hoxhaj.

Deputete, a doni ta bëni pyetjen?

LULJETA SHEHU: Faleminderit! Kur të jetë ministri, do t'ia parashtoj pyetjen.

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, zotin Alush Gashi, ose për ministrin e Bujqësisë, të Pylltarisë dhe të Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi. Njërin e ke këtu. Deputet, mund ta bëni pyetjen.

RIZA SMAKA: Faleminderit!

Pyetje kuvendore për përgjigje gojore referuar mospërfilljes së dispozitës së nenit 13 të Ligjit nr. 031 për ushqimin, kjo është pyetja ju lutem, ose konform me nenin 13 të këtij ligji - ushqimi që importohet në Kosovë për plasman në treg duhet t'i përmbushë kërkesat ligjore për ushqimin. Rrjedhimisht, në paragrafin 2 të po asaj dispozite, është përcaktuar se ministri i MSH-së dhe ministri MBPZHR- me akt nënligjor, kështu po e lexoj se një minutë e kam, nga sferat respektive definojnë kushtet për importimin e ushqimeve.

Zotëri ministra,

Me konsideratë po ju pyes se si e keni rregulluar këtë materie, nëse e keni normuar juridikisht, dhe sa dhe si i përfillni normat e tilla gjatë importimit të ushqimeve të jashtme në vendin tonë? Unë vlerësoj se kjo pyetje është me rëndësi fundamentale për shëndetin e qytetarit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, e ke fjalën.

IDRIZ VEHAPI: I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar deputetë, ministra,

I nderuari deputet Smaka,

Siç e dini, pas miratimit të ligjit për ushqimin dhe themelimit të Agjencionit të Ushqimit dhe të Veterinarisë të Kosovës, ky agjencion shkon pranë Zyrës së Kryeministrit. Ndërkaq, me ligj, pikërisht me nenin që cituat ju, parashihet që brenda 6 muajve Ministria e Bujqësisë si dhe Ministria e Shëndetësisë kanë kompetencë që të plotësojnë këtë ligj me legjislacionin sekondar.

Ne si Ministri jemi duke draftuar udhëzimet administrative, të cilat i kemi quajtur si pako higjienike me të cilat rregullohet kjo çështje.

Ndërkaq, në versionin final të këtij legjislacionin do të formohet edhe grupi ndërqeveritar punues në të cilën do të ketë përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë, si dhe Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Ekonomisë dhe e Financave.

Deri në periudhën 6- mujore janë në fuqi të rregullat dhe udhëzimet administrative sipas ligjit të vjetër. Pas kësaj periudhe kalimtare, domethënë të gjitha ato shfuqizohen dhe hynë në fuqi udhëzimet administrative të reja, të cilat i kemi për obligim ne si Ministri ta plotësojmë këtë ligj në përgjithësi Ligjin për ushqimin. Kjo është përgjigja.

KRYETARI: Faleminderit! Deputet, a ke pyetje shtesë?

RIZA SMAKA: Faleminderit! Them se, jo që është konkluzion imi, por se i institucioneve më kompetente, se shumë e shumë artikuj ushqimorë në tregun tonë shiten ani pse me origjinë krejtësisht të dyshimta dhe ani pse me skadencë të përdorimit. Fundi i fundit, ka edhe shumë raste ku konstatohet nga konsiliumi mjekësor se ushqimi i degraduar ishte shkaku kryesor për helmime tepër serioze, madje edhe me pasoja më të rënda. Natyrisht, ju mbështesim për përpjekjet tuaja, por do të kishim pasur dëshirë që të jeni shumë energjikë edhe shumë konsekuent në zbatimin e këtyre dispozitave ligjore që i kemi tani për tani. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Deputetja Gjylnaze Sylja, pyetje për kryeministrin, zotin Hashim Thaçi. A doni ta bëni pyetjen? Faleminderit!

Deputeti Riza Smaka, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. A doni ta parashtroni pyetjen, deputet?

RIZA SMAKA: Pyetja është publike, unë besoj që zotëri Kuçi nëse drejtpërdrejt jo, do t'i lexojë këto shënimet e procesverbaleve.

Pyetja është e shkurtër, por do të kërkonte përgjigje më të gjatë.

Pyetja kuvendore për përgjigje gojore, referuar shkallës së ulët të besimit të qytetarëve kosovarë në institucionet publike vendore. Ky konkluzion është i mbështetur në shumë burime të cilat i kam edhe në koment, edhe në futnotë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Edhe pyetja e fundit, po nga deputeti Riza Smaka, për ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, zotin Valton Beqiri.

RIZA SMAKA: Zotëri Kryetar, zotëri ministër,

Duke u nisur nga eksperiencat (negative) personale, deklaramet ad-hoc të qytetarëve dhe publikimeve analitike të shumta, rezulton se rregullisht dhe pa kurrfarë pengesash në vendin tonë nëpërkëmbet e drejta themelore e autorit, e kem ligjin, përndryshe. Në atë mënyrë, ndër të tjera krijohen pasoja juridike, morale, materiale të dëmshme të karaktereve më se të ndryshme.

Zotëri ministër,

Më konsiderata ju pyes përkitazi me të dhënat zyrtare të cilat i dispononi edhe ju lidhur me kontekstin e cenimit të Ligjit për të drejtat e autorit. Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën!

MINISTRI VALTON BEQIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar, deputet Smaka,

Më lejoni t'ju njoftoj se në bazë të Ligjit janë shumë organe të cilat duhet të jenë ata të cilët do të angazhohen për mbrojtjen e këtij ligji. Aktualisht, Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta është analizuar në kuptim të përshtatshmërisë me konventat ndërkombëtare dhe me *acquis –communitaire*.

Ministria e Kulturës ka formuar një grup punues për hartimin e Draft- rregullores për themelimin e Zyrës së të drejtës së autorit, të Draft-rregullores për certifikimin e organizatave për menaxhim kolektiv dhe të Draft-rregullores për anëtarët e Bordit këshillëdhënës, siç parashihet me Ligj. Po ashtu, Grupi punues është duke përgatitur një model-statut për organizatat për menaxhim kolektiv.

Ju e dini që organizata të tilla nuk janë themeluar ende në Kosovë dhe nuk është përgjegjësi as e Qeverisë e as e Ministrisë sonë për vetorganizim të këtyre organizatave. Njësi tjetër, janë po ashtu edhe gjykatat dhe mediatorët, të cilët kanë nevojë për trajnimin dhe profesionalizim të mëtutjeshëm në këtë fushë. Kapaciteti i brendshëm për të ofruar këtë lloj të specializimeve ende nuk ekziston.

Po ashtu, Policia dhe Dogana e Kosovës janë mekanizëm i rëndësishëm i shtetit në sigurimin dhe përdorimin e ligjshmërisë në Kosovë, po ashtu edhe të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta. Ju e dini se, posaçërisht lufta e Policisë dhe e Doganave të Kosovës, ka të bëjë në luftën kundër piraterisë në këtë fushë.

Në formën aktuale, Ligji për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, neni 6.1 përcakton qartë, që e drejta e autorit është e drejtë e posaçme, e cila i takon autorit si subjekt të pronës intelektuale për veprën e vet. Pra, ligjet e Kosovës u ofrojnë mundësi autorëve për të zgjedhur se cilat të drejta ata duan t'i mbajnë apo t'i transferojnë duke bërë kontrata të vlefshme ligjore që shprehin kushtet dhe mënyrën e përdorimit të veprave të tyre.

Në fund, pirateria, pra, prodhimi, shpërndarja, shitja dhe emetimi ilegal i materialeve që janë subjekt i Ligjit për të drejtat e autorit, apo i marrëveshjeve ndërkombëtare për mbrojtjen e pronësisë intelektuale të cilat Republika e Kosovës do t'i nënshkruajë, është një formë e padrejtë e konkurrencës në treg dhe sipas ligjit tonë, konsiderohet si vepër penale. Në këtë kuptim, Ministria e Kulturës mund të deklarojë që pirateria i dëmton interesat e autorëve dhe pronarëve të tjerë të drejtat, rrezikon të provokojnë kundërmasa ndërkombëtare në tregti dhe në marrëdhëniet ndërshtetërore, po ashtu, vendos në një pozitë të padrejtë ekonomike ata të cilët veprojnë në përputhje me ligjin dhe pengon zhvillimin normal të ekonomisë së tregut.

Për luftimin e kësaj dukurie, duhet angazhuar të gjithë mekanizmat e shtetit.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Urdhëro, deputet, e ke fjalën!

RIZA SMAKA: Mesatarisht kushton një tekst universitar 3000 euro. Teksti universitar nuk mbrohet nga askush edhe, po e marr shembull, meqenëse e njoh më së miri. Në çdo kioskë ka tekste të fotokopjuara. Ky është një problem tepër serioz. Për këtë pasojat janë shumë të rënda. Më pastaj, plagjiati dhe pirateria në vendin tonë janë në lulëzim, nuk ka kurrfarë pengese kundër piraterisë edhe plagjiatit. Ato veprat artistike, shkencore e tjera e tjera fotokopjohen, shiten e stërshiten edhe kështu që dëmtohen edhe arti, edhe shkenca, edhe kultura, edhe krijuesi, edhe lexuesi.

Prandaj, zotëri ministër, duke ju përkrahur për aktivitetin tuaj, do të kisha pasur dëshirë që me të vërtetë të mobilizoheni edhe më tepër dhe në bashkëpunim edhe me ministrinë përkatëse, se këtu është fjala edhe për konkurrencën jolojale të bëni atë që e përcaktojnë normat tona, e plus të inicioni propozim për ndryshime e plotësime të aktit ligjor, në mënyrë të kenë autorizime edhe inspektorët...

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

Unë duhet të them diçka, sidomos për deputetët që janë duke parashtruar shumë pyetje, prej seance në seancë. Vetë prezenca e deputetëve në këtë sallë tregon që pyetjet nuk po zgjojnë interesim, jo vetëm te Kryeministri dhe Qeveria, te Kabineti qeveritar, por as te deputetët. Mendoj që pyetjet duhet të jenë më parlamentare, më të përgatitura dhe një pyetje parlamentare, prej seance në seancë dhe jo 10 pyetje. Mendoj që vetë prezenca e deputetëve në sallë po tregon se këto pyetje nuk tërheqin interesimin e deputetëve, prandaj është mirë që vetë ta gjykonin. Ju lutem, mos i bëni për vlerësimet që i bën KDI-ja këtu, veç ta bëj një pyetje sa për ta bërë, por pyetjet le të kenë përmbajtje. Ju lutem, pyetjet nuk bëhen për çfarë rrahjesh dhe çfarë problemesh ndodhin në restorantet e kryeqytetit të Kosovës, ne nuk mund t'i sjellim ato probleme në seancën e Parlamentit. Prandaj, ju lus, keni kujdes pyetjet që i bëni të jenë përmbajtjesore dhe ta tërheqin vëmendjen e të gjithë deputetëve dhe, natyrisht, edhe interesimin e Qeverisë për t'u përgjigjur në ato pyetje.

Të nderuar deputetë,

Pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje në dy seancat plenare, do të publikohen në Buletinin e Kuvendit. Më vjen keq, por mund t'ju them se janë bërë pyetje në këtë Parlament, që edhe politikisht kanë qenë të dëmshme dhe nuk iu kanë kontribuar as zhvillimeve politike në Kosovë. Prandaj, ju lus, pyetjet të jenë më përmbajtjesore, që në rend të parë ta kenë interesimin e deputetëve dhe të Qeverisë.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës

Në bazë të Rregullës 35.1 të Rregullores së Punës, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin në parim të këtij Projektligji. Ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë, të Zhvillimit Rural, zotin Idriz Vehapi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: I nderuar, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Më lejoni që shkurtimisht ta bëj prezantimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet e Kosovës, duke filluar me titullin e Projektligjit.

Titulli i Projektligjit është Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003 / 3 për pyjet e Kosovës. Qëllimi i Projektligjit është që t'i rregullojë çështjet të cilat janë shumë të rëndësishme dhe me prioritet në drejtim të mbrojtjes dhe të shfrytëzimit të pyjeve dhe për të siguruar ... legjislacion për Ligjin për pyjet e Kosovës. Ndryshimi dhe plotësimi duhet të bëhet me bindje të plotë se mbrojtja e pyjeve do të jetë shumë më efikase dhe më mirë e organizuar nga institucionet që janë më afër pyjeve, përkatësisht nga qeveritë lokale.

Fusha e veprimit e këtij projektligji është edhe objektiva qenësore e programit të politikave zhvillimore në drejtim të menaxhimit sa më të qëndrueshëm të pyjeve dhe resurseve të tyre, shërbimet profesionale, mbrojtjes së pyjeve dhe zhvillimit të vlerave të pylltarisë.

Nevoja për plotësim ndryshimin e Ligjit për pyjet e Kosovës, numër 2003/3 është mbështetur në përvojën aktuale në mbrojtjen e pyjeve. Konsiderojmë se delegimi i kompetencave në këtë fushë, nëpër nivele komunale, do të gjejë zbatueshmëri edhe më të plotë një njërën anë përderisa në anën tjetër edhe qasja e drejtpërdrejtë e komunave në shfrytëzimin pyjeve përmes dhënies së tenderëve është fare reale dhe e akceptueshme. Gjithashtu, nevojën për plotësim ndryshimin e këtij ligji e bëjnë të domosdoshme ushtrimi i përgjegjësisë dhe kompetencave të qeverive lokale në pajtim me Pakon e Presidentit Ahtisari.

Pastaj, neni 18 i Ligjit për vetëqeverisje lokale, ku theksohet se mbrojtja e pyjeve dhe dhënia e tenderëve për prerjen e druve të delegohet si kompetencë e komunave. Pastaj, pika e tretë e rekomandimeve të seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbajtur vitin e kaluar si dhe planit të veprimit për partneritet evropian dhe aktivitete në kuadër të mekanizmit të stabilizim- asociimit. Prandaj, bazuar në të gjitha këto që i thamë, kjo situatë ka sjellë nevojën e ndryshimit dhe plotësimin të Ligjit në fuqi.

Arsyetimi për Projektligjin: Ky plotësim-ndryshim do të ishte në vijë të plotë me përkushtimin e Qeverisë në forcimin e zbatimit të ligjshmërisë në kuadër të Programit të politikave të zhvillimit, ruajtjes, investimit dhe të menaxhimit sa më të qëndrueshëm të resurseve pyjore.

Propozuesi gjithashtu konsideron se me këtë projektligj do të bëhet ndarja e kompetencave dhe përgjegjësi në këtë fushë, jo vetëm që mbrojtja dhe shfrytëzimi i këtyre resurseve, do të jenë më afër qytetarit, përkatësisht institucioneve lokale, por edhe mundësia e ndërmarrjes së të gjitha masave në drejtim të menaxhimit dhe investimit sa më të qëndrueshëm në pyje, do të jenë më mëdha dhe të realizueshme.

Përmbajtja e Projektligjit: Ky projektligj përmban 16 nene, të cilat kanë të bëjnë me çështjen e përgjithshme që ndërlidhen me mbrojtjen e pyjeve dhe të drejtën e qeverive komunale në dhënien e tenderëve për prerjen e drunjtëve në pajtim me planet vjetore operacionale të menaxhimit me pyjet e aprovuara nga Agjencia Pyjore e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, pjesë e këtij Projektligji janë edhe dispozitat e shqiptimit të masave ndëshkimore që qartësojnë më shumë marrjen e aktvendimeve ndaj dëmtuesve të pyjeve dhe tokave pyjore.

Rëndësia e Projektligjit: Duke pasur parasysh rëndësinë shumëdimensionale të pyjeve në zhvillimi ekonomik, avancimin dhe rritjen e vlerës me interes të përgjithshëm zhvillimin dhe përparimin e ekonomisë së lirë të tregut dhe të industrisë së drurit si dhe ndërrimi i rrethanave politike dhe ekonomike në Kosovë, u krijua domosdoshmëria e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për pyjet e Kosovës, numër 2003/3 3 përmes këtij projektligji

Risite dhe avancimet e Projektligjit: Me hyrje në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, kjo fushë, jo vetëm që do të begatohet dhe rregullohet në pajtim me direktivat e BE-së dhe praktikat më të avancuara për pyje, por edhe ndërmarrja e masave profesionale, hulumtuese dhe investuese në krijimin e pyjeve të shëndosha dhe të qëndrueshme, do të jetë shumë më e madhe nga ana e Agjencisë Pyjore të Kosovës, pasi që kjo tani lirohet nga dy kompetenca të rëndësishme, të cilat tani u delegohen qeverive komunale. Gjithashtu, ky projektligj është harmonizuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe zbatimi i këtij projektligji nuk do të ketë implikime buxhetore.

Hartimi i Projektligjit është bërë në pajtim me neni 36 të Rregullores së Punës së Qeverisë, mbështetur në burimet specifike të legjislacionit të BE-së si dhe harmonizimi i Projektligjit me standardet e hartimit të legjislacionit në përgjithësi edhe në vendet e regjionit.

Konsideroj se kjo ekspozë do t'ju ndihmojë më shumë në procedurat e miratimit të këtij projektligji, prandaj ju thërras që ta miratoni në parim dhe t'i hapni rrugë amendamentimit të mëtejshëm të Projektligjit në grupet funksionale. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e merr zoti Eqrem Kryeziu, anëtar i Kryesisë

KRYESUESI EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti ministër!

Pas këtij prezantimi, të nderuar deputetë, hap debatin për diskutim, në parim. Në qoftë se kryetari i komisionit funksional dëshiron ta marrë fjalën ose përfaqësuesi i komisionit funksional, nuk po mund ta identifikoj që është paraqitur dikush prej këtij komisioni. A ka dikush nga komisionet e përhershme që dëshiron ta marrë fjalën? Nuk ka. Atëherë, shkojmë te kryetarët e grupeve parlamentare. Nga Partia Demokratike e Kosovës, zoti Luzha, me kartelën e zotëri Buçincës.

BERAT LUZHA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Komisioni nuk e ka shqyrtuar paraprakisht këtë projektligj, prandaj edhe nuk mund të flasim në emër të komisionit. Unë flas në emër të Grupit Parlamentar.

Ligji për pyjet është miratuar nga ligjet e para në pranverën e vitit 2003 dhe qysh atëherë është konstatuar se kemi të bëjmë me një ligj të dobët, i cili do të paraqet probleme gjatë zbatimit të tij. Prej atëherë e deri tash është bërë një ndryshim - plotësim i ligjit, në vjeshtën e vitit 2004, por ka qenë një ndryshim- plotësim shumë formal që nuk ka paraqitur ndryshime përmbajtjesore dhe prej atëherë është kërkuar nga komisioni, por edhe nga instancat e ndryshme që projektligji të ndryshohet në mënyrë përmbajtjesore, jo formale.

Vjet, para një viti është prurë një plotësim – ndryshim, si Projektligj, i cili i është kthyer Ministrisë nga komisioni dhe nga Kuvendi këtu. Gjithashtu, është mbajtur edhe një debat për pyjet në Kosovë, ku është konstatuar se gjendja është shumë e rëndë, madje edhe është një gjendje kaotike. Kuvendi ka miratuar disa rekomandime, një nga ato ka qenë që të bëhet edhe në projektligj për ndryshim dhe plotësim të ligjit të vitit 2003 dhe, tash na ka ardhur ky projektligj.

Unë, konsideroj se përsëri ky projektligj nuk paraqet ndryshime përmbajtjesore, ashtu siç janë kërkuar, megjithatë janë formale, përveç një neni cili obligohet nga Ligji për vetëqeverisjen lokale që mbrojtja dhe dhënia e licencave të barten në komuna, nuk ka ndryshime të tjera. Unë mendoj se do të duhej që ndryshimet të jenë përmbajtjesore. Edhe vetë në memorandumin përcjellës të Projektligjit është konstatuar se ligji në fuqi i cili ishte i miratuar në vitin 2003, kishte mangësi të shumta dhe nuk kishte zbatim të plotë. Mirëpo, tash përsëri nuk tregohen se cilat ishin ato mangësi dhe me këtë projektligj, së paku nuk eliminohen shumica dërmuese e atyre mangësive.

Projektligji, kryesisht merret me ndryshimin, me formulimet e disa definicioneve, me korrigjimin e disa gjobave, që megjithatë nuk paraqet diçka të rëndësishme dhe nuk kemi të shënuar edhe grupin punues i cili e ka hartuar këtë projektligj. Megjithatë, për Kuvendin është e rëndësishme se dihet se kush e ka hartuar, kush është përpiluesi i këtij projektligji i cili, vërtet, nuk i plotëson kërkesat, së paku ashtu siç i kemi kërkuar ne.

Megjithatë, unë mendoj se komisioni duhet të merret shumë me këtë projektligj, nëse mund të bëjë diçka dhe me këtë shpresë, Grupi Parlamentar e miraton, në parim, dhe të shohim se çka mund të bëjmë në komision. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Luzha!

Nga Lidhja Demokratike e Kosovës, zotëri Zef Morina.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet numër 2003/3, është vërtet i një rëndësie të veçantë për t'u amendamentuar, sepse ky ligj është ndër ligjet e para të miratuara në legjislaturën e parë të Kuvendit të Kosovës, në kohën kur Kosova ishte me status ende të padefinuar. Tani kur Kosova është shtet i pavarur, është e nevojshme që shumë ligje të miratuara në atë kohë të amendamentohen për shkak të pengesave që kanë hasur në zbatimin e tyre në praktikë. Pra, edhe ky ligj nuk ka mundur të zbatohet, andaj duhet të ndryshohet dhe të plotësohet dhe duke e amendamentuar, në mënyrë që të jetë i kuptueshëm dhe lehtë i zbatueshëm në praktikë.

Ne si Komision pas vizitave që i kemi pasur nëpër kuvendet komunale dhe pas bisedave që kemi pasur me udhëheqësit e komunave, janë paraqitur shumë probleme të cilat, vërtet, janë parë të arsyeshme që duhet të eliminohen pasi që ligji qartë nuk i definon. Ndër to janë: kompetencat dhe përgjegjësitë jo qartë të definuar në mes të institucioneve qendrore dhe atyre lokale. I kemi dy ministri të cilat kanë të bëjnë pikërisht me këto çështje, është Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Planifikimit Hapësinor. Duhet të jetë koordinimi i tyre shumë më i qartë edhe në ligj të përcaktohet për nxjerrjen e udhëzimeve administrative, në mënyrë që ligji të jetë shumë më i qartë i zbatueshëm, bashkëpunimi në mes të institucioneve qendrore dhe lokale, bashkëpunimi pra i ministrive me kuvendet komunale.

Përcaktimi i qartë i kompetencave që ka Agjencioni Pyjor i Kosovës. Në të vërtetë ky agjencion, sipas ligjit që është në fuqi nuk ka të caktuara qartë kompetencat edhe pse si Agjencion ka shumë përgjegjësi për çështjen dhe ruajtjen e pyjeve. Problem tjetër është, Prokuroria dhe gjyqësori, të cilët nuk kanë qenë në nivel të detyrës, pikërisht për të qenë më azhur në mbrojtjen e problemeve që janë paraqitur tek dëmtimi i pyjeve.

Rojtarët e pyjeve duhet të jenë të uniformuar dhe të kenë siguri gjatë kohës kur ata bëjnë vizitat në ruajtjen e pyjeve dhe të jenë të mbështetur nga Policia e Kosovës. Këto janë vërejtje të cilat janë hasur në praktikë dhe besoj se në projektligj tani duhet të përfshihet, andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së, mbështet plotësimin e këtij ligji dhe përmes anëtarëve të vet në komisione do të kontribuojë që ky ligj të jetë sa më i lehtë i zbatueshëm në praktikë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Morina!

Nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Naim Maloku.

NAIM MALOKU: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

I nderuar zoti ministër Vehapi,

Ne e kemi pritur këtë plotësim - ndryshim të Ligjit për shkak se nevoja ka qenë që të plotësohet Ligji për pyjet, i miratuar në vitin 2003. Unë, për të mos përsëritur disa konstatime të parafolësve të mi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, konstatoj se ky ndryshim dhe plotësim nuk i ka plotësuar kërkesat dhe pritjet që i kemi pasur, që të ketë ndryshim dhe plotësim esencial të atij ligji.

Me gjithë faktin se esenca e çështjes me të cilën merret ligji, pra, ruajtja, licencimi dhe mbrojtja e pyjeve, decentralizohet me këtë plotësim dhe kalon në menaxhim, praktikisht të komunave. Ky ka qenë një "konflikt" mund të them mes të autoriteteve lokale dhe qendrore dhe se përzierja e kompetencave se kush duhet të ketë kompetenca në mbrojtjen, menaxhimin e pyjeve dhe në dhënien e licencave. Unë, zoti ministër, po i referohem nenit 12, pastaj 29.7 ku thuhet, citoj: "Mbrojtja e pyjeve dhe dhënia e licencave për prerjen e druve në territorin e komunës, përcaktohet si kompetencë e deleguar sipas nemit 18 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale". Nëse e kam kuptuar kështu, do të thotë, qartë që kompetencat në menaxhim kalojnë në një nivel lokal, atëherë kjo ka qenë esenca me të cilën është dashur të merret Ministria gjatë hartimit të këtyre plotësimeve.

Zoti ministër, ka shumë paqartësi edhe te gjërat që janë ndryshuar, pra qoftë kufijtë minimal dhe maksimal, për shembull kemi 1000 deri në 25.000 euro ose janë ato çështje

të cilat mendoj se ne duhet të punojmë bashkërisht -komisioni parlamentar funksional me ministrinë dhe këto të rregullohen ashtu si duhet. Me gjithë faktin se unë kam pritur se komisioni do të ketë pak punë, duke iu referuar, zoti ministër, vizitës që e kemi pasur te ju, si komision parlamentar, dhe çështjet që i kemi debatuar mu për këtë plotësim, por nga kjo që ne e kemi marrë, e shoh se ne duhet të punojmë bashkërisht, pra komisioni me ministrinë që të mundohemi që në formë të amendamenteve t'i bëjmë ndryshimet edhe më të sakta dhe më të qarta, sepse kemi të bëjmë këtu me kompetenca, qoftë të nivelit qendror, lokal, qoftë me kompetencat ose bashkëpunimin në mes të dy ministrive. Mendoj se duhet punë mjaft e madhe në mes të komisionit dhe ndoshta edhe të dy ministrive.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ne e mbështesim në parim këtë ndrysim-plotësim të ligjit dhe ofrojmë bashkëpunim dhe kontributin tonë në komisionet funksionale gjatë shqyrtimit të mëtejme. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Maloku!
Nga Aleanca Kosova e Re, zoti Haset Cakolli.

HESET CAKOLLI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pyjet numër 2003/3 është me rëndësi të veçantë, sepse ka për qëllim; mbrojtjen, rritjen, zhvillimin si dhe shfrytëzimin e pyjeve të Kosovës në mënyrë profesionale.

Projektligji për ndryshimin e ligjit në fjalë, ka gjithsej 16 nene, por neni 10 i këtij projektligji përcakton kushtet për transportin dhe përpunimin e masës drunore, që mendoj e rregullon një çështje mjaft me rëndësi ky nen i këtij ligji.

Neni 11, me 4 pikat e tij përcakton masat që duhet t'i ndërmarrin pronarët, shfrytëzuesit dhe menaxherët e pyjeve për mbrojtjen e tyre dhe të tokave pyjore nga sëmundjet e ndryshme dhe dëmtuesit.

Neni 12, pika 29.7 përcakton kompetencat dhe përgjegjësitë e komunave për mbrojtjen e pyjeve, si dhe dhënien e licencave për prerjen e drunjve në territorin e saj sipas Ligjit për qeverisje lokale dhe ne mendojmë se ky nen e rregullon, domethënë, kompetencën e komunave rreth menaxhimit dhe ruajtjes së pyjeve.

Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar këtë projektligj me kujdes të veçantë, sepse ky projektligj për ndryshim të Ligjit për pyjet i është kthyer edhe njëherë sponzoruesit, prandaj, ky projektligj besojmë se do të përmbushë qëllimin kryesor të tij dhe ne si Grup Parlamentar e mbështesim në parim, ndërsa nëpërmes anëtarëve tonë në komisionet funksionale do të kontribuojnë në ndryshim të këtij projektligji me amendamente konkrete, me të vetmin qëllim që ky projektligj të jetë sa më i zbatueshëm në praktikë dhe të përmirësohet gjendja në terren e pyjeve të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Cakolli! I kërkoj falje zotëri Makollit që nuk e lexuam emrin e tij si kryetar i Grupit. Ju faleminderit, shkojmë te Lidhja Demokratike e Dardanisë. A ka të paraqitur? Zoti, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë me vëmendje i ka përcjell gjatë kësaj periudhe zhvillimet që kanë ndodhur në sektorin pyjor në kontekst të nivelit jo të kënaqshëm të menaxhimit dhe të mbrojtjes së këtij sektori, duke pasur në konsideratë që ky Kuvendi i Kosovës seriozisht ka debatuar në një seancë të veçantë plenare për gjendjen e rëndë në sektorin pyjor të Kosovës, që lirisht sot mund të konkludojmë se përmasat e degradimit të këtij sektori nuk kanë të ndalur dhe nevoja për një qasje shumë serioze dhe një qasje pro aktive e Qeverisë në këtë sferë, sot është shumë e domosdoshme.

Ky Kuvend i Republikës së Kosovës, në rekomandimet e veta të cilat i ka nxjerrë, thuhet se me konsensus të plotë të gjitha grupimeve parlamentare, një prej rekomandimeve ka qenë në mënyrë decizive ndryshimi i Ligjit të pyjeve të bëhet në pajtim me politikat zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në qoftë se ky ndryshim është bërë në pajtim me politikat e Ministrisë dhe të Qeverisë, atëherë vij në përfundim se këto politika qenkan shumë të mangëta dhe janë të diskutueshme se a ekzistojnë.

Shikoni, ne konsiderojmë se ky ndryshim është shumë kozmetik dhe nuk ofron mbrojtje efikase, nuk ofron menaxhim efikas dhe nuk ofron zhvillim të qëndrueshëm të sektorit pyjor. Nevojat për ndryshim të ligjit duhet të jenë substanciale. Unë e përsëris në emër të Grupit Parlamentar tendencën që të ndryshohet dhe në këtë parim jemi në një gjatësi valore, mirëpo, kolegët parafolës folën për transferin apo bartjen e përgjegjësi në nivel lokal sipas nenit 12, në fakt ndryshimi i nenit 29 pika 7 i ligjit bazik. Por duhet ta kemi parasysh një çështje, neni 29, shërbimi i mbrojtjes sipas ligjit bazik, i adresohet përgjegjësi ekskluzive Agjencionit Pyjor të Kosovës dhe derisa nuk ndryshohet struktura menaxheriale në kuptimin e asaj legale dhe në kuptimin e kompetencave dhe përgjegjësi që do të adresohen në nivelin lokal, atëherë ky ndryshim është tejet kozmetik dhe nuk ofron në substancë atë qëllimin për çka edhe ne kemi insistuar në vazhdim si komision dhe si Kuvend. Kujtoj që qasjen që po e domostrojmë në raport me pyjet, nuk është qasje serioze dhe mungon vullneti i duhur që kjo çështje të adresohet konkretisht.

Nevojat për ndryshim të ligjit janë substanciale. Ne duhet të shikojmë çka ndryshojmë dhe çka ofron ky ndryshim. Ky ndryshim nuk ofron në esencë atë shqetësimin tonë për të cilën kemi debatuar shumë herë, mirëpo, ajo çka bie ndesh drejtpërsëdrejti edhe me legjislacionin, të cilin e ka miratuar ky Kuvend i Kosovës lidhur me gjobat dhe dënimet. Shikoni, gjobat dhe dënimet janë skandaloze në kuptimin e manovrimeve dhe aferave të ndryshme të cilët kanë qenë prezentë dhe do të barten në vazhdimësi, në qoftë se miratohet kjo formë çfarë është sot.

Nuk mund të thuhet, shikoni, neni 36, pika 1 në ligjin bazik, ndërsa në ndryshimin e ligjit e kemi neni 14 gjobat dhe kundërvajtjet. Teksti i paragrafit 1 fshihet dhe bëhet si vijon: Me dënim me gjobë prej 2000 deri 25.000 euro, prej 500 deri në 15.000 euro, çfarë difference, me legjislacion që e kemi miratuar është dhjetëfishi, do të thotë, nëse thuhet 500 duhet 5000 euro ose kemi edhe 400, 200 deri në 5000 euro, gjë që lë shumë hapësirë për diskutim në këtë plan. Prandaj, ne konsiderojmë se qasja jonë ndaj këtij projektligji që është fundamental në kontestin e ruajtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të sistemit pyjor, të sektorit të pyjeve duhet të ndryshojë

Për ministrin dhe Qeverinë është një pyetje fundamentale që ky Kuvend ka adresuar si shqetësim të vetin. Duhet pasur në konsideratë që ato rekomandime që i ka miratuar seanca plenare, njëra prej tyre ka qenë që Qeveria e Republikës së Kosovës të fillojë

procedurën për krijimi e lehtësirave doganore për importuesit potencial të drurit, në mënyrë që ta mbrojmë, t'i mbrojmë resurset pyjore, të krijojmë lehtësira doganore në mënyrë që të mos dëmtohet, në mënyrë që të krijojmë mundësi për alternativa shitesë, një gjë e tillë nuk është bërë, nuk ka ndodhur. Shtrohet pyetja pse? Pa ashtu, shumë dilema, shumë shqetësime janë nxjerrë në adresë të sistemit gjyqësor.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka qenë rekomandim i Kuvendit të Kosovës, është kërkuar nga Qeveria që të kërkojë nga gjykatat e Republikës së Kosovës, që shqyrtimi i lëndëve që ndërlidhen me dëmtimin e pyjeve, të ketë prioritet për shkak se numri i madh të lëndëve që janë grumbulluar dhe mundësia e vogël deri tash për t' u zbardhur, për t' u ndriçuar për t' u adresuar përgjegjësia.

Nëse nuk ndërmarrim veprime konkrete, t'i eliminojmë të gjitha këto mangësi dhe të metat që na kanë përcjell për këtë periudhë që po e lëmë pas, atëherë me një qasje të tillë edhe ligji më i madh edhe ligji, unë do të thosha më cilësor, nuk do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese që ekziston. Ne e përsëhendesim iniciativën për ta ndryshuar, por ndryshimet duhet me të jenë substanciale dhe komisioni parlamentar, kujtoj se duhet t'i marrë në konsideratë edhe përvojat edhe të vendeve të tjera dhe të mos bazohemi në këto specifikat tona të cilat nuk kanë qenë në shërbim të ruajtjes të sistemit pyjor, por në shërbim të interesave dhe të grupeve të caktuara. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Zeneli!

Në emër Grupit Parlamentar "7+", zotëri Sadik Idriz

SADIK KDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna grupa „7+“ će podržati ovaj Nacrt zakona o izemanama i dopunama Zakona o šumama. Daće svoj doprinos u funkcionalnoj komisiji i smatramo da je jako dobra prilika da se izvrše određene korekcije ovog zakona koji je veoma značajan i koji u svom radu ima, odnosno u implementaciji je bilo dosta problema na terenu. Ove izmene imaju, neke su suštinske ako se dovrše u fazi izrade zakona, odnosno amandamentiranja Zakona. Članom 10 reguliše ovih izmena reguliše se transport i zaštita zloupotreba, izdavanja znači propratnica i ostalih dokumenata. Stanje sa šumama na Kosovu je svima poznato i mislim da bi i Ministarstvo i Agencija koja se bavi, Agencija za šume, trebalo bi da učine sve da se ovo sačuva, ukoliko nije kasno u nekim sredinama.

Članom 11. predviđaju se neke izmene oko zaštite šuma. Imamo zadnjih nekoliko godina, bili smo svedoci da smo imali velike šumske požare na Kosovu, kakvih ranije nije bilo. Ponekad ti šumski požari imaju kriminalne aktivnosti. Ljudi su pokušavali da preko šumskih požara sakriju ono što su radili neka dela koja nisu legalna.

U članu 12. ovih izmena su delegirane nadležnosti prema Zakonu o lokalnoj upravi da se određene nadležnosti oko licenci, izdavanja licenci o seći šuma spuštaju na opštinski novo, to je u skladu sa Zakonom o lokalnoj upravi. Videćemo dali će to biti bolje nego što je bilo do sada, kada su licence bile centralizovane, odnosno izdavanje licenca za sve ili će ovo biti prilika da se još više šume ugroze. U svakom slučaju, biće verovatno više posla za šumsku inspekciju da bi se to zatštitilo.

Mi ćemo kao Parlamentarna grupa podržati i cenimo, znači, daćemo svoj doprinos i želimo puno uspeha u zaštiti šuma. Na teritoriji na koje žive naše zajednice, delom su i parkovi, nacionalni parkovi. Želimo da se to očuva, sačuva, znači to prelazi u domen

drugog ministarstva, takodje je, nešto što ovde nije, ali što je problem u procesu privatizacije mnoga preduzeća koja su bila ne šumska, nego javna preduzeća, koja su imale pašnjake, a koji su pašnjaci danas pretvoreni u šumske teritorije i to je dato na privatizaciju, primer je „Šar proizvodi“, nekadašnji pašnjaci, danas su velike šumske površine koje mogu da padnu u ruke ljudima koji nisu. Zaista je potrebno da se i tu, taj proces je veoma problematičan. Nekada je opština izdavala pašnjake na upravljanje raznim zadrugama ondašnjim, koje su danas vlasnici i privatizuje se nešto što je nekada pripadalo, što je bilo opšte društveno, opštinsko i danas će se to privatizovati, onda će dobar deo šuma, znači na teritoriji Opštine Dragaš, da ogromne površine sa šumama, najboljim šumama danas pripadaju ovom gazdinstvu, Poljoprivrednom gazdinstvu „Šar proizvodi“ koji je počeo privatizaciju i koji će ugroziti šumsku teritoriju.

U svakom slučaju, znači mi ćemo podržati ovaj Nacrt zakona sa najboljim namerama. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Idriz!

Nga Grupi Parlamentar SLS, nuk ka të paraqitur. Atëherë, është radha e deputetëve. I pari, e ka fjalën Armend Zemaj, le të bëhet gati zonja Gjylnaze Syla.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zotëri kryesues!

Tenderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë do të ndalem, se ndoshta për shkak edhe që sot ishte në rend të dite, domethënë ndryshim- plotësimi i këtij ligji, me shumë dëshirë dhe vullnet pata arsye që ta ngrit një çështje, shkatërrimin e pyjeve që po ndodh në Rafshin e Dukagjinit, konkretisht në Pejë, Deçan dhe deri në Gjakovë.

Duke marrë parasysh, zotëri ministër, se si janë menaxhuar pyjet që 10 vjet, ky plotësim-ndryshim nuk jep shpresë se do të kemi përmirësim apo mbrojtje të këtyre pyjeve. Me të vërtetë, nuk e di se edhe çka do të mbrohet, ata që e njohin atë territor dhe që vazhdojnë ta shohin edhe gjatë kësaj periudhe se si sistematikisht shkatërrohen pyjet. Në komunën e Deçanit ekzistojnë më shumë se 60 sharra apo gereta, që quhen, dhe paramendoni se sa është importi nga jashtë, ndërsa ato sharra punojnë 24 orë pa ndërprerë dhe tash ta vlerësojnë vetë edhe deputetë edhe ju se nga furnizohen ata.

Sa u përket gjobave, sinqerisht të them, me këto gjoba do të dënohen qytetarët e thjeshtë, do të dënohen fshatarët, do të dënohen ata që ndoshta për bukë goje shkojnë ta presin një dru, sepse nuk do të dënohen ata që i vjedhin pyjet sistematikisht, ata që i vjedhin pyjet me tender dhe me këto licenca. Këtë e them, sepse ne kemi pasur edhe djegie të pyjeve, kemi edhe tash që në emër të pastrimit të pyjeve, aty me të vërtetë ndodh pastrim, po ndodh pastrim i pyjeve të shëndosha dhe bëhet furnizimi i këtyre sharrave në mënyrë ilegale. Prandaj, ajo çka është edhe unë çka mendoj, duhet të ndërmerren masa në Agjencionin e Pyjeve dhe atëherë, ndoshta, do të vlejë edhe ligji dhe do të zbatohet edhe ligji, sepse nuk ka qenë as ligji i kaluar, domethënë të bëhet ai farë rishikimi, nuk dallon shumë me këto ndryshime, përpos që është bërë një ndarje e gjobave, por duhet të ndërmerren masa ndaj njerëzve që, në mënyrë legale, e them, i shkatërrojnë pyjet, sidomos të atij territori, dhe besoni se nuk e di çka do të kemi të mbrojmë tash edhe me ligj edhe ata njerëz që kanë prona, prona private.

Ne kemi pasur shpresë që të bëhet ripërtëritja ndaj Fondit për pyjet dhe do të fillojë diçka, sepse deri më tani ajo trevë është në asimilim, të them, dhe shumë shpejt, në vitet e ardhshme, gjeneratat që do të vijnë do t'i trashëgojnë pasojat si nevojë edhe në biodiversitet. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Armend! Harrova të të them se nuk ka transmetim televiziv. Zonja Sylja, le të bëhet gati zotëri Xhavit Haliti.

GJYLNAZE SYLA: Rasim Selmanaj me kartelën time.

RASIM SELMANAJ: Me kartelë të Gjylnazës, Rasim Selmanaj.

KRYESUESI: Po, urdhëroni atëherë!

RASIM SELMANAJ: I nderuar, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Në bazë të Pakos së Ahtisarit, në kapitullin -Delegimi i kompetencave, është paraparë që mbrojtja e pyjeve të bartet te komuna. Nuk është definuar mirë se çka nënkuptohet me mbrojtjen e pyjeve, konkretisht a kemi të bëjmë me mbrojtjen vetëm nga prerjet, apo edhe me mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit pyjor: insektet, kafshët e egra, zjarret, shtrëngata, bora, ngricat e tjera. Te neni 18 i Ligjit për qeverisje lokale shkruan, te kompetencat e deleguara, citoj, pika f) “Mbrojtja e pyjeve që ndodhet në territorin e komunës, hyn në kuadër të autorizimeve të deleguara nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e drunjëve në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria”.

Pyes ministrin, çka nënkuptohet me licencat, kush do t'i japë lejet për prerje apo shfrytëzim të pyjeve për punët silvikulturore, cila është e drejta e komunave për menaxhimin me pyje, sepse vetë nocioni - dhënia e licencave nuk është i qartë dhe në bazë të këtij formulimi, frikohem se çështja e administrimit dhe të menaxhimit të pyjeve dhe të tokave pyjore do të mbetet si gjer më tani. Unë mendoj se këto çështje duhet të sqarohen. E ngrit këtë çështje edhe për faktin se jam deputet nga Deçani dhe atje komuna jonë ka një pasuri të madhe të pyjeve dhe konsideroj se, nëse në fakt, në esencë nuk kalon menaxhimi në komuna, atëherë unë mendoj se këto janë vetëm ndryshime kozmetike. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit! Zotëri Xhavit Haliti! Armendi do ta ketë të drejtën për një minutë, le të bëhet pastaj gati zotëri Shkumbin Demaliaj.

XHAVIT HALITI: Zoti kryesues,

Zotërinj ministra,

Deputetë të nderuar,

Unë kam parasysh që pyjet në përgjithësi dhe gjelbërimi kudo, edhe në Kosovë, janë dhe duhet të mbesin mushkritë e qytetarëve dhe duhet të shprehim shqetësimin njësoj të gjithëve për këtë katastrofë ekologjike që po ndodh në Kosovë, veçanërisht në këtë periudhë dhjetëvjeçare.

Vërtet, nuk është vetëm në pyje, është edhe në lumenj, është edhe në shumë fusha, por me qenë se po flasim për pyjet sot, ata që e dinë se si ka qenë gjendja e pyjeve përpara dhe si është sot, vërtet, duhet të shqetësohemi të gjithë dhe duhet të jetë njëri ndër prioritetet e mëdha të Qeverisë së Kosovës dhe i neve si përfaqësues të qytetarëve dhe

të popullit të Kosovës, se si të veprojmë dhe çfarë të bëjmë për t'i ruajtur mushkритë tona, për ta ruajtur gjelbërimin, për t'i ruajtur pyjet e Kosovës.

Në të kaluarën, u përmendën këtu tenderët. Pra, ata që po i vjedhin pyjet ne nuk kemi si t'i trajtojmë ndryshe. Nuk ka hajn të vogël dhe hajn të madh. Ai që e pret pyllin, qoftë edhe një lis pa leje, ai e ka emrin dhe duhet të dënohet kushdoqoftë ai. Nëse këtë parim e ndjekim, atëherë ne mund t'i shpëtojmë pyjet. Nuk po dua të flas për elektorat, se të flisja për elektorat, do t'i ndaja ata që i kanë dhënë tenderët për t'u pasuruar vetë dhe ndoshta kompanitë e tyre, nga qytetarët të cilët vërtet jetojnë me pyllin ose duke vjedhur, prapë po them, pa leje drurët, qofshin ata halorë, qofshin të tjerë.

Unë e dëgjova këtu se cilat janë dënimet për ata që me ligj do t'i marrin në qoftë se zihen duke prerë pyje ose në qoftë se kanë prerë. Nuk po dëgjoj këtu që të ketë dënim për ata që bëjnë lëshim, për ata që nuk i ruajnë pyjet dhe paguhet për t'i ruajtur pyjet dhe do të thosha për ata që i kanë dhënë tenderët dhe nuk e kanë kontrolluar ekzekutimin e tyre, a janë pastruar pyjet nga drunjtë e këqij apo janë prerë pyjet, janë prerë drunjtë e mirë dhe ka vazhduar lënia e pyjeve të pa pastruara me tenderët që i kanë marrë nga drejtoritë e pyjeve apo kush i ka dhënë?

Së dyti, në qoftë se vazhdon kështu t'i lihet detyrë Drejtorisë së Pyjeve dhe jo Policisë, unë mendoj se është një gabim i madh me ligj, sepse Policia e Kosovës, në qoftë se kalon para maunave të ngarkuara me dru dhe me trupa, siç thonë, halorë të prerë pa leje dhe nuk i ndalojnë dhe, në fund të fundit, nuk shpërblehet kjo polici në qoftë se i ndalon, unë nuk e besoj që drejtoritë e pyjeve pa kompetenca ekzekutive, do ta quaja, të periudhave të mëhershme ose të praktikave që kanë vendet që i ruajnë pyjet, do të kemi mundësi që ta trajtojmë këtë çështje siç duhet.

Jo, pa qëllim po e theksoj një ditë që më ka thënë njëri në Bjeshkët e Isniqit vitin e kaluar. Atje kanë vërshtuar të gjithë për të ndërtuar shtëpi të dytë pushimi, e ku ta di unë, dhe i kanë ligjet e tyre. Domethënë, e di ti se në të kaluarën ne jemi detyruar që edhe ato rrethoret që i kanë bërë për delet dhe për bagëtinë e tyre, t'i sjellin nga poshtë dhe nuk kanë guxuar ta presin asnjë degë të halorëve në bjeshkë, kurse tani tërë ditën dhe tërë natën gumëzhijnë motorët që i presin ato dru, ata halorë aq të bukur, e cila është jo vetëm pasuri për t'u prerë, po thjesht për ta mbajtur jetën e njerëzve në nivel. Prandaj, lind pyetja dhe, do të thosha, në këtë rast meqenëse edhe ministri është këtu dhe nuk e kam të qartë mirë si janë dhënë ata tenderë për pastrim. Unë mendoj që është koha e fundit që Ministria dhe Qeveria të krijojnë komisione përkatëse për të kontrolluar dhe për të konstatuar si janë ekzekutuar tenderët e dhënë deri më tani dhe, në të njëjtën kohë, të shihet mundësia e një marrëveshjeje permanente me policinë dhe e detyrimit të policisë që të merret të paktën në zonat urbane, kur të bien poshtë pyjeve, që të mos i ngarkojnë të dalin nëpër mal policia, që kur hasin në maunat e ngarkuara me dru dhe me lëndë të tjera të pyjeve, t'i ndalojnë dhe t'i qojnë për penalitet.

Një çështje tjetër, e cila ndoshta, do të ndikonte shumë në ruajtjen e pyjeve është edhe definimi i pronës. Ne e kemi një pronë të padefinuar me këto pyje, kemi disa, do t'i quaja, ligje të pashkruara të vendorëve, të cilët i kanë ndarë zonat që i kanë shfrytëzuar dikur, që nga koha e Turqisë, dhe thonë kjo është bjeshkë e këtij fshati, bjeshka e atij fshati dhe në regjistrat e pronës nuk janë prona të tyre. Tani, unë mendoj që është koha e fundit që të mos mbesin këtu prona të padefinuara, ose duhet që me ligj t'iu kthehen ish-pronarëve pasuritë e tyre, që ata të kujdesen për pronën e tyre, ose

shteti ta marrë përgjegjësinë dhe shteti të jap llogari para ligjit për ruajtjen ose mos ruajtjen e këtyre pyjeve. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Haliti! Minuta e juaj, zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Ju faleminderit shumë, kryesues, që ma dhe shansin të jem më konkret. Ndoshta është për shkak të moshës, sepse unë mendoj më shumë për të ardhmen dhe më vjen shumë keq pse nuk jam në televizion dhe të më dëgjojnë të gjithë ata keqpërdorues. Nuk jam në anën e tyre dhe do të jem kundërshtar i hapur, sepse unë e thashë jo rastësisht, 60 sharra punojnë 24 orë dhe ato furnizohen nga hajnat ilegal edhe tash do të jem edhe më konkret. Përcjellja bëhet edhe me polici, edhe rojet e pyjeve nuk janë të përgjegjshme dhe prandaj i ngrita këto çështje dhe shumë po më vjen keq që nuk jemi në transmetim të drejtpërdrejtë, por shpresoj që ata do ta dëgjojnë në njëfarë forme. Do të jem kundërshtari më i madh i shkatërrimit të atyre pyjeve derisa të jem në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zoti Zemaj! Zotëri Shkumbin Demaliaj e ka fjalën, le të bëhet gati zotëri Ibrahim Makolli.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministra,

Zoti ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe i Zhvillimit Rural,

Plotësim- ndryshimet që kanë ardhur sot para nesh, më shumë janë një harmonizim se sa plotësim- ndryshime. E them harmonizim, sepse më shumë, në nenet që janë caktuar për plotësim- ndryshim, është punuar në atë drejtim që të rregullohet performanca apo përgjegjësia dhe statusi i njerëzve që i drejtojnë këta mekanizma, duke përcaktuar përgjegjësit në kuadër të dikastereve të kësaj Ministrie, se a janë shefa, kryeshefa, a është autoritet apo agjencion, sesa problematika që duhet të ndërlidhet me këtë sëmundje të shoqërisë, që vazhdimisht na prek sedrën kur flitet për tenderët.

Them kushtimisht, se deri tash u fol për keqmenaxhimin e kësaj Ministrie lidhur me obligimet që ka pasur me ligj për menaxhimin e pyjeve. E them këtë kushtimisht, se deri tani gjithçka çka është menaxhuar nga Ministria përkatëse, janë menaxhuar tenderët dhe nuk është menaxhuar cilësia, sepse janë ndarë tenderët vetëm për halorët, ndërkaq, drunjtë tjerë teknikë që mund të përdoren në industri, ne e dimë që eksporti nuk funksionon në këtë drejtim, nuk janë trajtuar fare dhe ata, flas për zonat ku janë kryesisht ahishtat, janë sëmure ata drunjë dhe sot po shkatërrohen për shkak se e kanë humbur cilësinë nga mospërdorimi, mos prerja dhe, ajo çka tha zoti Haliti, mos pastrimi i pyjeve. E them kushtimisht këtë, se ka paqartësi në mes neneve të propozuara për plotësim-ndryshim. Te neni 11 thotë, - pëlqimin për përdorimin e pesticideve në pyje, është pika 26.6, e jep Ministria me kërkesën e pronarëve dhe të shfrytëzuesve të pyjeve. Në qoftë se këtë nuk e bëjnë pronarët dhe shfrytëzuesit, kush janë shfrytëzuesit në këtë rast? Shfrytëzues mund të jetë çdonjëri prej qytetarëve, por nuk dëshiron këtë vit ta shfrytëzojë një hapësirë, do të thotë, duhet të përcaktohen rregullat më të qartësuar. Për rastet e jashtëzakonshme, Ministria me urdhëresë ose pika 26.7 përcakton ndërmarrjen e masave përkatëse për mbrojtjen e pyjeve të cilat duhet t'i zbatojë institucioni kompetent. Kush është institucioni kompetent? Pronarët dhe shfrytëzuesit e tyre. Edhe këtu jepet një hapësirë edhe pse me urdhëresë, pse mos ta hartojë një rregullore të mirë, sepse urdhëresa jepet vetëm në raste të jashtëzakonshme, edhe pse përfshin pjesën e akteve nënligjore.

Në rast të prishjes, 26.8, të baraspeshës biologjike për dëme serioze ose për dëme joserioze, vetëm serioze kur janë, në ekosistemin pyjor Ministria përcakton masat e nevojshme për synimin e pyjeve. Si, do ta bëj këtë Ministria? Do të thotë, po i jepet shumë mundësi Ministrisë që të rregullojë e të marrë masa të çfarëdollojshme vetëm e vetëm për t'i harmonizuar kërkesat e tyre.

Pronarët dhe shfrytëzuesit e pyjeve janë të obliguar që të hartojnë plane për mbrojtjen e pyjeve kundër zjarrit, do të thotë, vetëm me hartimin e një plani rregullon edhe pronarin, edhe shfrytëzuesit, edhe tenderuesit, do të thotë, vetëm planin ta hartojë, se nuk kanë nevojë që të kenë masa të tjera të nevojshme që duhet ta rregullojnë kjo çështje, veç një hartim plani dhe e ka rregulluar çështjen, mund të jetë shfrytëzues i kësaj ngastre apo hapësire pyjore.

Vijmë te neni 14, neni 36, titulli “gjobat” ndryshohet dhe bëhet “me kundërvajtje”.

Për nenin 36.1 folën edhe parafolësit më herët, me “dënim me gjobë prej 2.000 deri 25.000 euro dënohet për kundërvajtje”. Nuk ma merr mendja se edhe me standarde, ligjet e përcaktuara, por edhe Kodi ynë penal dhe ligjet në vijim se ka kundërvajtje 25.000 euro. Pra, duhet të përcaktohet lartësia e dënimeve se kur është kundërvajtje e kur është vepër penale. Një kundërvajtje 25.000 euro i shkel të gjitha konditat që të jetë e rregulluar në këtë formë.

Neni 36.6, teksti i paragrafit 6- fshihet dhe ndryshon si vijon: “me dënim me gjobë prej 200 deri 3.000 euro për kundërvajtje dënohet prindi”. Nuk po jetojmë në periudhën e akuzatorëve, domethënë, në qoftë se je fajtor, shtine dorën në zjarr, mos t'u djeg të nuk je fajtor. Duhet të përcillen edhe të jenë fletëlëshimet tjera, të dihet saktësisht se kush e ka detyruar dikë të shkojë në mal apo diçka tjetër, se po e shoh se është e rregulluar në qoftë se është fëmija i mitur, por edhe për të miturin, besoj se fëmijët deri në klasën e parë nuk mund të shkojnë në mal dhe ta dëmtojnë malin, por për të mitur ka sanksione apo forma të tjera, janë masat e enteve e gjëra tjera. Mirëpo, besoj se me qenë se e kemi këtë projektligj për ndryshim e plotësim, në lexim të parë, edhe komisioni funksional, po edhe sponzorizuesi do të marrë masa të nevojshme për mundësinë e rregullimit të standardizimit të kësaj hapësire brenda këtyre plotësimeve ndryshimeve, që unë i quaj harmonizim.

Ndërkaq, kur flitet për Deçanin, që është hapësira që më së shumti është shkatërruar, kisha pasur dëshirë t'i them ministrit, në qoftë se mund të na saktësojë një shumë të inkasimit të hyrave nga Ministria, nga komuna e Deçanit, mund të jetë edhe ndonjë pyetje e radhës në seancat e ardhshme, sepse duhet t'i harmonizojë a më shumë ka marrë Ministria me tenderë në Deçan, apo i ka dhënë Deçanit krejt Qeveria? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Shkumbin. Fjalën e ka zotëri Ibrahim Makolli, të bëhet gati zotëri Riza Smaka.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Ne edhe para disa kohe kemi pasur në këtë Kuvend një raport për gjendjen e pyjeve në Kosovë dhe me plot të drejtë nga shumë prej kolegëve gjendja ekzistuese në pyjet e Kosovës, shkatërrimi që po u bëhet, është vlerësuar me plot të drejtë se po bëhet krim në Kosovë, sepse krime ka të llojllojshme.

Dhe, nuk po shoh që në këtë ndërhyrje të ligjit, Ministria ka pasur parasysh rekomandimet, vërejtjet dhe sugjerimet që janë dhënë në atë raport, që ka qenë shumë përmbajtjesor.

Ligji, besoj që do të duhej të ketë edhe funksionet e tjera, përpos funksionit sanksionues. Me plot të drejtë këtu e tha një prej kolegëve që nuk është zgjidhje dhe nuk është ruajtje e pyjeve nëse policia pret në asfalt kamionë dhe traktorë me drunjtë e prerë, por pyjet ruhen aty ku janë dhe ju e dini shumë mirë, besoj që shumica e këtyre pyjeve të shkatërruara në Kosovë dhe jo vetëm në bjeshkë të Deçanit, por në të gjitha pjesët e Kosovës, ka ndodhur edhe me letra. Kur e them me letra, kam parasysh që pjesëmarrës në këtë krim që ka ndodhur e po ndodh në pyjet e Kosovës, janë pikërisht ata që do të duhej të ishin ruajtësit më të mëdhenj të pyjeve. Besoj shumë që edhe në këto momente që po flasim ne për pyjet në Kosovë, gjithandej nëpër bjeshkët tona, nëpër male tona gumëzhijnë motorët duke prerë drunjtë me dhe pa leje. Në këtë projektligj nuk po shoh edhe pjesë ku Ministria do të duhej të shikojë mundësitë e pyllëzimit të pyjeve në ato vende ku janë shkatërruar. Ministër, me gjithë respektin që kemi për Ministrinë e Bujqësisë, megjithatë nuk ruhen pyjet duke pritur kamionët dhe duke i dënuar njerëzit që i presin, por duke qenë në vend aty ku ruhen, sepse në botën perëndimore ju e dini se sa janë dhe çfarë janë sanksionet vetëm për një dru të prerë. Ndërkaq, në Kosovë ka shkatërrim masiv, me qindra e qindra hektarë në të gjitha pjesët e Kosovës gjatë këtyre dhjetë vjetëve janë shkatërruar masivisht, besoj e dini edhe përplasjet që kanë ekzistuar në mes të një agjencionit dhe akuzat e agjencionit kinse për ruajtjen e pyjeve, ndërkaq e vërteta do të ishte që ky agjencion të quhet Agjencion për Shkatërrimin e Pyjeve. Nëse i keni dhe besoj se është dashur t'i vizitoni ato vende ku janë dhënë tenderët për prerjen e pyjeve ose pastrimin, si thuhet pastrimi, por unë po them më mirë, pyjet, i shihni që edhe dhjetëra hektarë të tjerë të këtyre pyjeve, të këtyre pjesëve janë shkatërruar, janë prerë dhe nuk kemin në ndonjë veprim të drejtpërdrejtë. Ajo që mendoj se do të duhej për t'u përqendruar më tepër Ministria në të ardhmen, është që të merret me pyllëzimin e hapësirave të shpyllëzuara. Po përmend, sepse shumica prej nesh e kemi afër, vetëm shikojeni Gërmënë, parkun e mbrojtur, është i mbrojtur me ligje, me të gjitha ligjet, shikojeni se si është shkatërruar. Madje, janë shkatërruar edhe drunjtë të cilët janë qindravjeçar këtu dhe askush nuk ka pasur ndonjë sanksion.

Ligji do të duhej të ketë edhe pjesën e preventivës dhe jo të merret vetëm me sanksionim të atyre që për arsye të ndryshme, sepse është biznes i mirë në Kosovë edhe me drunjtë, por do të duhej të merrej me preventivë dhe pyjet të ruhen aty ku janë. Nuk është e rëndësishme se kush do ta shfrytëzojë atë dru kur të ndalohet nga ana e policisë. Me rëndësi është që të ruhet aty ku e ka vendin dhe sugjerimet tona janë që në këtë ligj, i cili do të përpunohet nga ana e komisioneve, të parashihen edhe format e drejtpërdrejta të ruajtjes së pyjeve tona, por po ashtu edhe sanksionim më drastik dhe më i rreptë i atyre të cilët e keqpërdorin drurin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Makolli! Fjalën e ka zotëri Riza Smaka, të bëhet gati zotëri Ramadan Avdiu.

RIZA SMAKA: I nderuar, zoti kryesues!

Ministra dhe deputetë,

Zakonisht ligji, ligji juridik, se ka ligje biologjike, fizike e tjera, e tjera, i referohet një segmenti të jetës shoqërore reale, konkrete. Edhe ky dokument do të duhej, natyrisht edhe iu ka referuar, po jo sa e si duhet, t'i referohej gjendjes të pyjeve e ajo është kjo, shkurtimisht thënë – ajo devastohet, ajo shkatërrohet pamëshirshëm, pothuaj se

pandalshëm dhe zakonisht e kryesisht drunj të tanë eksportohen, si lëndë e parë importohen, ndoshta, të njëjtit dru, porse në prodhime finale, që i shkaktohen dëme kolaterale ekonomisë së vendit. Ndër tjera, do të duhej, tash flas për ligjin, në parim a po jo, që të ketë dispozita që do ta restriktionin eksportimin e shlrshëm e të lirshëm të drurit si lëndë e parë, apo jo, por ta stimulojmë eksportimin e prodhimeve finale.

Disa vërejtje parimore. Sanksionet juridike në këtë dokument nuk i adresohen organit, ndoshta aludohet në gjykatat për kundërvajtje. Është një intencë që gjykatat për kundërvajtje të suprimohen krejtësisht, ndërsa funksionet e tyre t'i marrin organet e administratës publike. Bie fjala, në këtë rast, Agjencionit për Pyje, nëpërmjet inspektorateve, sepse do të ngrihej një shkallë e lartë e efikasitetit. Gjykatat e kundërvajtjeve në vendin tonë janë gjykata të mira, kanë gjykatës të mirë, por kanë lëndë –numër të madh të rasteve edhe praktikisht fletëparaqitja në Gjykatën e Kundërvajtjeve, do të thotë, absolutim për delinkuentin, sepse ndoshta pas shumë viteve do të ftohej, tek më pastaj pason shkalla e dytë, e tretë. Kjo është një çështje parimore që duhet të meditojmë se kush duhet ta caktojë dënimin me të holla apo edhe sekuestrimin, për tjerat dihet.

Ky është, fundi i fundit, ligj special dhe është ajo rregulla lex specialis derogat, lex gjeneralis, që do të thotë me këtë mund të përcaktohen dispozitat e këtilla dhe të bëhet rregullim adekuat në funksion të ruajtjes, të mbrojtjes së pyjeve tona.

Ky dokument, kryesisht, të mos them përfundimisht, i referohet sektorit të pyjeve publike. Në rregull është ajo, mirëpo ka shumë entitete private që kanë, që janë pronarë të pyjeve private, a ruajtja e mbrojtja e pyllit privat duhet të jetë në regjimin e njëjtë sikundër pyjet publike, se prerja e një druri në qoftë se do bëhej jashtë zezonës të lejuar për prerje apo kundër rregullave për prerje, qoftë në oborrin e shtëpisë, do t'i shkaktojë dëm sikundër të prehej në mjedis të pyllit të pronës, ta quajmë, shtetërore apo të pyllit publik.

Prandaj, duhet një segment i veçantë t'i referohet ruajtjes dhe mbrojtjes së pyjeve në përgjithësi, jo vetëm publike. Ka njerëz që kanë me qindra hektarë, ju lutem, që janë pronarë, legalë, legjitimë të pyjeve private e tash do të dilte se ata apo ato pyje janë jashtë regjimit të mbrojtjes dhe do të mund t'i presin si do të donin. Nuk lejohet një gjë e tillë, ne e dimë fare mirë, kemi eksperiencë, kemi njohuri empirike, në vendet e përparuara nuk lejohet prerja e një dege në oborr, e lëre më e një pjese të pyllit apo të pyllit në përgjithësi.

Do të duhej, si vërejtje parimore, që të inkorporohej edhe një kaptinë sa i përket gradimit, se ne degradimin po e dimë, devastimin po e dimë, shkatërrim po e dimë, mirëpo gradimit, pyllëzimit dhe ripyllëzimit. Obligim, në qoftë se unë pres një dru me leje apo jo në sezonin e lejuar dhe në mënyrën e përcaktuar me ligj, do të duhej që ta mbjell fidanin dhe të më jepet leja për ta bartur atë trup, po e zëmë, apo masën e drurit prej aty, tek kur fidani do të kishte sukses në mënyrë që të sigurohet kontinuiteti. Kjo është rregull, është mirë ne të shërbelemi edhe me praktikën e shteteve të përparuara. Dhe, përfundimisht, unë e përkrah ministrin, e përshëndes për punën që e kanë bërë, natyrisht Ministria – ministri, që të bëhet amendimi i këtij dokumenti, po me të vërtetë ky dokument meriton kujdes më të shtuar, sepse është fjala për interesin shoqëror të rëndësisë së veçantë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Smaka! Fjalën e ka zotëri Ramadan Avdiu, të bëhet gati zotëri Ardian Gjini, si folës i fundit, kështu që në të njëjtën kohë po i lus deputetët të kenë durim se pas pak do të hyjmë në procedimin e votimit.

RAMADAN AVDIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Të respektuar kolegë deputetë,

Padyshim se një prej pasurive më të mëdha që e ka Kosova, është pasuria e pyjeve. Për fat të keq, ato pyje nuk po mund të prevenohen, që të ruhen. Ne kemi debatuar në këtë Kuvend, domethënë, brenda këtij viti lidhur me gjendjen në pyjet e Kosovës. Zona e cila ka qenë më së shumti e dëmtuar në të kaluarën, ka qenë Malësia e Gallapit. Për fat të mirë, tashmë ajo zonë është regjeneruar, pyjet janë regjeneruar, jo se ka pasur ndonjë mbrojtje, por më shumë për shkak të mungesës së njerëzve, sepse është një zonë bukur shumë e boshatisur nga popullata, kurse tash pyjet po atakohen atje ku ka dru industrial, kryesisht, dhe është mirë që në zonën e Gallapit të shtohet ruajtja e pyjeve për arsye se ka filluar regjenerimi. Ai dru nuk mund të përdoret shumë për industri, por përdoret për djegie dhe tash mund të vërshohet shkatërrimi edhe i kësaj zone, prandaj edhe në të kaluarën, kur kemi biseduar për pyjet, kam kërkuar që të shqyrtohet mundësia e ngritjes së një njësie të veçantë në kuadër të Shërbimit Policor të Kosovës, e cila do të jetë njësi e policisë pyjore, sepse Agjencioni për Pyjet apo Shërbimi për ruajtjen e pyjeve nuk po është në gjendje që t'i ruajë pyjet e Kosovës.

Po ashtu, është vërtet e dëmshme që në emër të pastrimit të pyjeve të shkatërrohen jo vetëm pyjet, por të shkatërrohet edhe biodiversiteti. Me këtë rast, unë do të dëshiroja që ta përsëritet edhe njëherë iniciativën e Kryeministrit në këtë pranverë dhe nismën e tij me moton: "çdo banor ta mbjellë një fidan", domethënë nëse 2 milionë banorë e mbjellin nga një fidan, do të jenë 2 milionë drunjtë rinj në Kosovë dhe këtë nismë është mirë që ta nxisin edhe komunat, që të shtohen, në komuna të regjenerohen pyjet, por edhe të ngrihen hapësira të gjelbëruara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Avdiu! Fjalën e ka zotëri Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Zoti ministër,

Me keqardhje duhet të konstatoj prapë, e ndoshta do të jetë një parafrzim i kolegut, Xhavit Haliti, se pasuritë tona publike janë mbrojtur më mirë dikur se tash. Kjo është e dhimbshme, është me të vërtetë e dhimbshme përderisa deklarativisht të gjithë themi se pasuria publike është pasuri jona, se e duam vendin, se punojmë për vendin tonë, ajo që e shohim që ndodhë, jo vetëm me pyjet, por me pasuritë publike në përgjithësi, është e dhimbshme dhe faj kemi të gjithë, mendoj se faj kanë të gjithë qytetarët e Kosovës vetë, askush tjetër. Tani, kur kemi faj të gjithë dhe kur e pranojmë fajin se degradimi i pronës publike po ndodh me fajin tonë dhe jo të dikujt nga jashtë, i takon institucionit, i takon Qeverisë që të hartojë plane se si të dilet prej kësaj gjendjeje në cilëndo sferë.

Ky është një prej problemeve, që unë e shoh në këtë ndryshim të ligjit. Është tentuar që të ndryshohet ligji për ta përmirësuar gjendjen, mirëpo këtij ndryshimi të ligjit nuk i ka paraprirë një analizë shumë serioze, pse gjendemi në këtë situatë, cilat hallka të sistemit nuk kanë funksionuar dhe ligji t'iu përgjigjet saktë atyre çështjeve të cilat do të kishin dalë si një analizë serioze. Ne këtë nuk e shohim.

Dhe, tani, prapë mund të kthehemi në të kaluarën, është shumë lehtë të kthehemi në të kaluarën, mirëpo mendimi im është se kur janë rritur pritjet qysh prej zgjedhjeve të fundit, atëherë për një vit e gjysmë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i ka pasur të gjitha mundësitë, të gjitha mjetet në dispozicion dhe gjithë kohën e nevojshme për të arritur deri te një analizë serioze afatgjate të gjendjes, në mënyrë që ky ndryshim i ligjit tani të na ofrohet neve në formën e saktë dhe të na thotë: nuk janë implementuar gjrobat, arsye për mos implementimin e gjrobave janë këto, një, dy, tre, katër, cilado që të jenë ato dhe këto elemente do t'i ndryshojmë në ligj, në mënyrë që të implementohen gjrobat. Tani, çka na sillet neve? Na sillet rritja e gjrobave.

Rritja e gjrobave, kolegë të nderuar, zoti ministër, nuk është mjet për ta implementuar ligjin dhe ka qenë dashur të jetë e qartë për të gjithë njerëzit tanimë. Shikoni, për shembull, çka ndodh në komunikacion. Prej kohës kur janë rritë gjrobat, ka shumë pak shqiptim të gjrobave. A e dini pse? Se nuk kanë të drejtë morale policët t'i shqiptojnë gjrobë dikujt që është më e madhe se rroga e tij. Domethënë, është disproporcion i madh në mes asaj çka synohet për ta bërë dhe mënyrës se si po synohet për ta bërë këtë. Ka qenë dashur ta kemi në një raport sa gjoba janë shqiptuar, shembull ta marrim gjatë dy, tri, katër ose pesë vjetëve të kaluara ose për gjashtë muaj? Dhe, nëse e kemi një raport se sa gjoba janë shqiptuar, atëherë mund të konkludojmë se a është problemi se gjrobat janë të vogla, apo është problemi se nuk po shqiptohen gjrobat. Dhe, atëherë do të ishte shumë më lehtë që ne të merremi me ligjin, por diçka konkrete, të saktë, në këtë drejtim nuk kemi.

Ky është një prej problemeve të tjera që e ka ligji dhe na bën të besojmë se nuk ka për ta zgjidhur problemin për të cilin jemi duke folur. Ligji nuk po ndryshohet për ta rregulluar situatën administrative brenda ministrisë. Ligji ndryshohet për ta ndryshuar gjendjen në pyjet e Kosovës, për ta ndryshuar qasjen tonë ndaj pyjeve të Kosovës, jo për ta rregulluar administratën. Administrata rregullohet me çështje të tjera, me rregullore.

Mua më bën që të dyshoj që ky ligj nuk e arrin qëllimin për të cilin ka filluar, shembull ta marrim.

Një çështje tjetër është se nuk është bërë analizë serioze nga Ministria se a e ka vendin Departamenti i Pyjeve në Ministrinë e Bujqësisë, të Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural? A mos duhet, ndoshta, të ndahet me Ministrinë e Mjedisit apo mos duhet të kalojë në Ministrinë e Mjedisit?

Dikur është diskutuar në këtë temë dhe prapë kemi ardhur në situatën që të bisedojmë se cilët njerëz duhet t'i mbajnë kompetencat për vete e jo se ku duhet të jetë ky departament që t'i shërbejë Kosovës? Prapë kemi ardhur në situatë që të bisedojmë me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës se kush duhet të ketë kompetenca për t'i menaxhuar pyjet, si individë është fjala ose si grup i individëve, e jo se ku do të kishte me qenë më mirë që të jetë i sistemuar një lëmi e tillë e rregullimit të jetës tepër me rëndësi në Kosovë?

Me mijëra herë kemi dëgjuar që pyjet janë një ndër pasuritë më të mëdha të Kosovës, që rrugët janë pasuria më e madhe e Kosovës, se njerëzit nuk guxojnë të ndërtojnë ilegalisht. Po, çka po ndodhë në realitet, është krejtësisht e kundërt. Ne po sillemi ndaj pyjeve sikur nuk janë tonat, sikur janë pyje të huaja ose sikur as nuk e kemi kuptuar as përafërsisht se sa me rëndësi janë pyjet.

Propozimi im është se ligji duhet të kthehet, duhet të kemi analizë të saktë dhe të mos kalojmë ligj i cili nuk e rregullon çështjen për të cilën esencialisht ka filluar që të hartohet, të shikohet mundësia që lëmi i pylltarisë të kalojë në Ministri të Mjedisit ose që të ndahet në mes dy ministrive, që të shkatërrohet rrethi vicioz në të cilin e kanë futur sistemin e menaxhimit të pyjeve një grumbull i njerëzve, të cilët menaxhojnë për një kohë të gjatë, të cilët i kanë futur rrënjët më thellë se pyjet e Kosovës në këtë sistem, i cili nuk po e lejon Kosovën që ndaj pasurisë së vet, një ndër pasuritë më të mëdha, të sillet sikur të jetë e veta. Kosova nuk po sillet ndaj pyjeve të veta sikur që duhet të sillet dhe në këso situata i takon Qeverisë dhe askujt tjetër të prodhojë vizion, të prodhojë strategji dhe të ndërmarrë hapa të nevojshëm se si të dilet prej kësaj gjendjeje.

Kjo është ajo që desha ta ndaj me ju, me qëllimin më të mirë, që të mbërrijmë pas një kohe në Kosovë, të mund të themi, kemi filluar t'i menaxhojmë pyjet ashtu si duhet, kemi filluar t'i trajtojmë pyjet si pasuri tonën dhe jo si pasuri të huajën dhe, të mbërrijmë të themi që mbjellja e dy milionë fidanëve duhet të ndodhë, por duhet të ndodhë jo për shkak të fushatës, por duhet të ndodhë për shkak se kemi nevojë jetike për to. Dhe, prapëseprapë duhet të kemi plan se si mbillen dhe si nuk mbillen dhe jo të përfundojmë në këso gjendje çfarë jemi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Gjini! Është e vërtetë se kemi edhe dy emra këtu të paraqitur, është e drejta e tyre, por kisha për të konstatuar që mos të merren vendime të atypëratyshme për fjalë. Kjo është këshillë, sepse unë nuk mund të urdhëroj gjëra të tilla. Sidoqoftë, meqë kemi zonjushën Njomza Emini dhe zonjën Elheme Hetemi, do ta kemi kënaqësinë t'i dëgjojmë edhe ato.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryesues!

Duke ditur edhe rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve, unë do të doja të jap kontributin tim për atë që mendoj se është përmirësuar sa i përket Ligjit për mbrojtjen e pyjeve, por do të kisha sugjeruar që nuk ka ndodhur shkatërrimi i pyjeve vetëm tani, por ky shkatërrim ka ndodhur edhe nga... do të thotë, nuk kanë bërë edhe qeveritë paraprake për mbrojtjen e pyjeve, sepse ato pyje nuk ndodhin vetëm për një kohë të shkurtër, për një afat, mirëpo para se të bëhen sanksionet ose edhe gjobat për personat që i shkatërrojnë ose e prishin ndotjen edhe për qytetarët që janë dhe jetojnë aty afër, unë do të sugjeroja për Ministrinë që është edhe prezent, që para se të ndodhin sanksionet, të parandalohen dhe të kërkohet që këtë t'i bëjnë edhe asamblatë komunale që të sigurohen që aty të ketë njerëz adekuat të cilët e mbrojnë dhe të jenë të sigurt ata që i mbrojnë. Do të thotë, kisha sugjeruar që edhe tek qytetarët që të krijohet kultura, do të thotë vetëdija qytetare që të mos presin vetëm sanksionet, por ata vetë, secili që shihet të paraqet te organet kompetente dhe të jenë sa më të sigurt pyjet e Kosovës.

Unë do të doja këtu, me qëllimin më të mirë të kontributit u paraqita që të krijohet vetëdija qytetare, pa i menduar sanksionet që vijnë, por secili le ta ruajë pjesën ku është, aty ku edhe jeton dhe e do Kosovën, duke ditur se Kosova i ka bukuritë natyrore, që njihet me bukuri të rralla natyrore. Kjo, pra, ishte ajo për çka unë desha ta jap kontributin tim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja Elheme.

ELHEME HETEMI: Faleminderit, zoti kryesues!

Me qëllim të sqarimit rreth asaj, jo paraqitjes së problemeve se tashmë janë të identifikuar, po pajtohem të gjithë se problemet janë të një shkalle të nivelit të lartë rreth mbrojtjes dhe menaxhimit të pyjeve, që nuk kanë të bëjnë vetëm me drunjtë sikur po paraqitet këtu rasti, kanë të bëjnë edhe me pronën që është në kuadër të pyjeve të Kosovës e që ato janë djerrina dhe mund të shfrytëzohen si një pasuri e mirë nacionale. Problemet, thashë, janë në një shkallë të lartë të zhvillimit për arsye se kanë filluar vonë të trajtohen.

Unë me këtë rast dua ta falënderoj Ministrinë e Bujqësisë, përkatësisht Qeverinë, që ka filluar ta trajtojë dhe ka filluar të merret më seriozisht me këtë problematikë. Është edhe një angazhim në nivel i Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Ambient dhe Planifikim Hapësinor. Dua të them edhe një çështje këtu, që u ngrit nga deputetët, e unë dua ta marr si propozim për komisionin funksional gjatë shqyrtimit të këtij ndryshimi dhe plotësimi të këtij projektligji, se ekziston dilema a duhet Agjencia të jetë në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, apo në kuadër të Ministrisë së Ambientit? Është e njëjta.

Unë mendoj se krejt problemet kanë qenë rreth qasjes, rreth vullnetit të mirë për një menaxhim të mirëfilltë të pyjeve të Kosovës. Dhe, në këtë kuptim, unë mendoj se kjo çështje ka filluar të trajtohet dhe të merret më seriozisht. Ka shumë probleme që janë më komplekse, u përmendën edhe disa propozime këtu e shumë të tjera. Mendoj se komisioni funksional të gjitha këto propozime që dolën nga deputetët e nderuar dhe propozimet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe aktorët e tjerë, palë të interesit, do t'i shqyrtojmë në komisionin funksional, në mënyrë që amendamentimi i këtij projektligji të jetë sa më i mirë, në mënyrë që menaxhimi i pyjeve të Kosovës, si pasuri nacionale, të jetë më i mirë, më në nivel. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputete Hetemi! Zotëri Gani Buçinca e ka shtypur butonin.

GANI BUÇINCA: Faleminderit, zoti kryesues!

Shqetësimi i kolegëve këtu në lidhje me ligjin që po e trajtojmë, padyshim është shumë qëllimshëm dhe legjitim.

Problemi i resurseve natyrore, siç janë pyjet, si pasuri nacionale e Kosovës, duhet të trajtohet me një seriozitet më të madh dhe duhet të implikohen në këtë problem jo vetëm Ministria e Bujqësisë, por edhe disa hallka të pushtetit në Kosovë, ndoshta edhe disa ministri tjera këtu në Kosovë.

Unë, në parim e përkrah ligjin, për arsye se ligji ka mundësi që të amendamentohet, gjatë procesit të amendamentimit të ndryshojë, kuptohet në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe besoj që në komisionin funksional ka mjaft ekspertizë, për aq sa kam mund të vërej këtu në Kuvend, dhe vullnet politik që ligji të bëhet i zbatueshëm, të plotësohet me vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve që u dhanë këtu.

Një prej problemeve që më shqetëson mua si qytetar i Kosovës në lidhje me mbrojtjen e pyjeve, shfrytëzimin dhe ruajtjen e tyre në mënyrë racionale, është problemi dhe shqetësimi kryesor se pyjet në Kosovë praktikisht nuk dihet në kompetencë të kujt janë.

Ma merr mendja se gjatë procesit të leximit të dytë, deri te leximi i dytë, shumë përgjegjësi duhet të delegohen në komuna, sidomos për mbrojtjen e pyjeve. Komunat duhet të bëhen përgjegjëse për arsye se asnjë ministri nuk do të ketë kapacitete as resurse

njerëzore t'i ketë nën kontroll dhe t'i mbrojtë pyjet në Kosovë për arsye se është hapësira shumë e madhe dhe krejt energjia e Ministrisë së Bujqësisë duhet të orientohet pikërisht në mbrojtjen e pyjeve, kështu që duhet të delegohen përgjegjësitë për mbrojtjen e pyjeve në komuna. Të rishikohet roli i Agjencisë së Pyjeve a është duke e kryer misionin të cilin e ka dhe të bëhen ndryshimet adekuate, t'i caktohet roli çfarë duhet ta ketë, në mënyrë që ky ligj, më në fund të bëhet i zbatueshëm dhe t'i japë rezultatet e veta.

Një prej problemeve më të mëdha për mbrojtjen e pyjeve është edhe kërkesa e madhe në treg për energji të kësaj natyre. Ne duhet të mendojmë për burimet e energjisë alternative, sidomos për amvisni. Në rast se ne nuk i ulim kërkesat në treg për këtë lloj energjie, sidomos për ngrohje, duhet të jemi të vetëdijshëm të gjithë se dëmtimi i pyjeve do të vazhdojë, do të vazhdojë në mënyrë individuale, do të vazhdojë në mënyrë të organizuar për përfitime nga subjektet ekonomike legale, ilegale e tjera. Kështu që ma merr mendja se ne, një resurs natyror që e kemi thëngjillin, sidomos do të duhej ta shfrytëzojmë më shumë dhe duhet të kemi politika në këtë drejtim që ta shpërndajmë te qytetari energjinë elektrike, sidomos te ato kategori që marrin asistencë sociale, te të gjithë qytetarë e Kosovës,

ta japim thëngjillin falas, në mënyrë që kërkesa të bie në treg. Sidomos gjatë periudhës së dimrit ne nuk kemi një politikë adekuate si t'i mbrojmë kategoritë e varfra në Kosovë, se ata duhet të ngrohen disi, ose me energji, ose me dru, ose me energji elektrike, përkundër faktit që ata s'kanë mundësi ta paguajnë energjinë elektrike. Ne duke e racionalizuar energjinë tonë, një burim energjetik që e kemi në Kosovë dhe duke ua shpërndarë qytetarëve, sidomos familjeve të dëshmorëve, familjeve në asistencë sociale, të papunëve, ne do t'i ulim shumë kërkesat në treg për dru dhe në mënyrë të tërthortë ne do t'i mbronim edhe pyjet tona që, megjithatë, gjendja në të cilën janë, është e papranueshme për të gjithë. Pra, duhet të ndalet degradimi dhe rrënimi i mëtutjeshëm i tyre.

Unë apeloj te deputetët që ta votojmë në parim ligjin dhe t'ia lëmë kompetencat komisionit funksional, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse, dhe ta bëjmë një ligj të zbatueshëm dhe një ligj që do të japë rezultate konkrete në terren. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Buçinca! Tani është koha e rezervuar për ministrin Vehapi.

MINISTRI IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Unë edhe si qytetar i Republikës së Kosovës jam shumë i brengosur me gjendjen në pyje, por si ministër jam përgjegjës për t'i mbrojtur ato. Dhe, ne, besoj që vitin e kaluar, por edhe këtë vit po vazhdojmë ta bëjmë punën tonë dhe duhet të them se vetëm në vitin 2008 për kundërvajtësit, rojet e pyjeve kanë ngritur 10.000 padi, të cilat janë bartur në gjykatat e Republikës së Kosovës. Dhe, gjithashtu, kemi fakte se shumë padi lëndët e të cilave vjetrohën, ato hidhen, ka me qindra sosh.

Në rast se ne bëjmë krahasime me të kaluarën dhe të tashmen, unë besoj se të gjithë jemi të vetëdijshëm dhe e dimë pse në të kaluarën janë ruajtur pyjet më mirë dhe pse tani është e pamundur kjo. Dhe, nuk dua të hy në ato biseda ose komentime, sepse, të gjithë e dimë pse ka ndodhur ajo.

Unë si ministër, bashkë me ministrin e Ambientit dhe me ministrin e Punëve të Brendshme kemi vizituar komunën e Deçanit dhe kemi vizituar rajonin e pyjeve të

komunës së Deçanit dhe kemi biseduar edhe me strukturat komunale edhe me strukturat e policisë. Unë personalisht kam dëgjuar eprorë të policisë duke thënë se jemi të kërcënuar prej prerësve të pyllit. Vërtet, ka pasur edhe përfaqësues të KFOR-it dhe për mua ka qenë ajo e çuditshme.

Vitin e kaluar kemi pasur dy raste të rrahjeve të rënda të rojeve të pyjeve dhe ne këtu për keqardhje askush prej deputetëve nuk i përmendi këto raste. Këtë vit po ashtu kemi pasur një rast shumë të rëndë në komunën e Ferizajt që një roje e pyllit është prerë me sëpatë në shpinë. Gjithashtu, kemi pasur edhe gjuajtje me armë zjarri në komunën e Vushtrisë.

Ju them se nuk është shumë lehtë të mbrohen pyjet, është lehtë ndoshta të bisedohet dhe të diskutohet dhe, plotësisht pajtohem me ju të gjithëve se ne duhet të gjejmë një mënyrë që t'i mbrojmë ato.

Tjetër, me të gjithë përfaqësuesit e Komisionit Evropian që janë ekspertë të fushës së pylltarisë ishim të mendimit se vërtetë edhe ligji që ka ekzistuar nuk ka qenë i keq. Ne kemi e kemi filluar këtë plotësim-ndryshim, kemi propozuar këtë plotësim-ndryshim dhe sipas propozimit të Pakos së Presidentit Ahtisarit, e unë besoj që kjo është e mirë, sepse mbrojtjen e pyjeve në përgjithësi e nënkuptoj mbrojtje edhe prej prerjeve, edhe prej zjarreve, prej sëmundjeve dhe që këto të barten në kompetencë të komunave dhe besoj se shpërndarja e përgjegjësi është shumë e mirë dhe të ngarkohen me përgjegjësi edhe kryetarët e komunave, edhe drejtoritë komunale, edhe policia në përgjithësi, sepse ne kemi pasur në vitin 2007, siç e dini edhe ju dhe unë atëherë nuk kam qenë ministër dhe, kemi pasur zjarre masive dhe nëpër komuna kanë fjetur dhe askujt nuk i ka interesuar a po ndizet pylli diku apo jo.

Ndërkaq tani, besoj, me këtë ligj nuk do të ndodhë kjo. Edhe dhënia e licencave do të bëhet prej komunave. Ata do të përshkruajnë gjendjen dhe do të vendosin se çka do të bëjnë më tutje.

Shumë është përfolur për komunën e Deçanit dhe të regjionit në përgjithësi. Ju them me përgjegjësi të plotë, atje nuk ka pasur tender. Atje ka pasur pastrim të pyjeve prej ekonomive pyjore. Se si ka shkuar ajo, unë kam pasur informata se vitin e kaluar ka pasur një përmirësim të gjendjes, një përmirësim të lehtë të gjendjes dhe unë kam informacione se ka nevojë atje edhe më tej të pastrohen pyjet prej druve të djegura dhe të sëmurë, por këtë vit, derisa ky ligj nuk është fuqiplotë unë nuk kam lejuar që atje të veprohet më tej në mënyrë që pastaj komunave t'u mbetet ajo përgjegjësi dhe ato të vendosin.

Unë besoj se është mirë që ky ligj të amendohet dhe të procedohet më tej, sepse, me siguri, se do të na ndihmojë në ruajtjen e pyjeve në mënyrë më efikase.

Dhe dua të them edhe diçka, dhe besoj se këtë ju mund ta nënkuptoni, ne nuk guxojmë ta bëjmë një dezintegrim të plotë sa i përket përgjegjësi në fushën e pylltarisë, deri në fund nëpër komuna. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri ministër!

Të nderuar deputetë,

Tani ka ardhur koha të deklarohe mi me votim për miratimin në parim të këtij projektligji.

Duke qenë se e kemi raportin e saktë se të pranishëm në këtë seancë janë 64 deputetë, atëherë mund të procedojmë me votim dhe lus regjinë e deputetët të bëhen gati për votim. Votojmë tash:

A ka pa kartela që votojnë “për”? O mashalla! Sa janë? Urdhëro, shërbimi le t’i numërojë. Gjashtë!

A ka kush pa kartela, por që është “kundër”? Nuk ka.

A abstenon kush? Jo, atëherë, të presim deri sa t’i bëjmë hesapet për këto punë.

Pra, 56 – me kartelë janë “për” (50 + 6), “kundër” janë 3 dhe 3 abstenojnë.

Do të thotë, miratohet në parim ky projektligj. Faleminderit shumë!

Dhe, në bazë të Rregullores së Punës, Kuvendi ngarkon këto komisione:

- Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
- Komisionin për Komunitete, dhe
- Komisionin për Integritet Evropian.

Komisionet duhet që brenda dy muajve nga shqyrtimi i parë, do të thotë nga sot, Kuvendit t’i paraqesin raporte me rekomandime.

Ju faleminderit shumë dhe shkojmë në pikën tjetër të rendit të ditës. E kemi parasysh, edhe Kryesia e nderuar e ka parasysh nevojën tuaj, mirëpo për ta merituar drekën, me të drejtë të plotë do të kryejmë edhe këtë pikë tjetër të rendit të ditës, se nuk do të marrë shumë kohë.

Dhe pikërisht, është:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit numër 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë.**

Do të thotë, është leximi i dytë dhe shkon shpejt.

Komisionet parlamentare, ta keni të qartë, e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet e këtyre komisioneve u janë shpërndarë deputetëve.

Para se të procedojmë me votim të amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, zonjën Selmani, apo raportuesin e komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandimet. Fjalën e ka zonja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zotëri kryesues!

Përsëritje për të dy ministrat që janë këtu prezent dhe për të gjithë deputetët!

Komisioni, në bazë të shqyrtimit të parë të Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit 2004/5 për tregti me naftë dhe derivate të naftës në Kosovë ka propozuar amendamentet me rekomandim që të miratohen në këtë seancë plenare, ndërsa kryesuesi i grupit punues për këtë ndryshim-plotësim të këtij ligji ka qenë zotëri Haki Shatri, por për momentin tash nuk është. Besoj se deputetët mund t'i japin edhe vërejtjet e tyre nëse kanë në amendamente, por lus për një votim. Faleminderit shumë!

KRYESUESI: Faleminderit, shumë zonja Selmani!

Atëherë, të nderuar deputetë, shkojmë me votimin e amendamenteve që i keni përpara dhe të propozuara nga komisioni funksional, sipas radhës.

Regjia, a kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve të pranishëm në sallë? Më falni, vetëm të verifikojmë numrin e deputetëve.

Ashtu. Atëherë, e kemi numrin e mjaftueshëm – 61 dhe kalojmë në votimin e amendamenteve.

Regjia, deputetët gati!

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Faleminderit! 48 janë “për”. Ju lutem pa kartela “për”. Faleminderit!

A ka pa kartela “kundër”. A abstenon kush pa kartela? Jo.

Atëherë, konstatojmë se 51 vota janë “për”, 3 abstenojnë dhe asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2. Regjia dhe deputetët gati. Votojmë tash:

48 janë “për” dhe 3 pa kartela – 51, 1 abstenon, asnjë “kundër” – miratohet edhe ky amendament.

Shkojmë te amendamenti 3.

Regjia, deputetët gati. Votojmë tash:

47 janë “për” – 3 pa kartela – 50 deputetë, abstenojnë 2, nuk ka asnjë “kundër” – miratohet edhe amendamenti 3.

Shkojmë te amendamenti 4. Votojmë tash:

48 janë “për” – 3 pa kartela – 51.

Abstenojnë 3, nuk ka asnjë “kundër” – miratohet edhe amendamenti 4.

Shkojmë te amendamenti 5. Regjia dhe deputetët gati. Votojmë tash:

T’ju përkujtoj se të pranishëm janë 62 deputetë në seancë.

49 janë “për” – 3 pa kartela – 52.

Abstenojnë 2, nuk ka asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 5.

Shkojmë te amendamenti 6.

Regjia, deputetët gati. Votojmë tash:

49 janë “për” – 3 pa kartela – 52.

3 abstenojnë, asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 6.

Shkojmë te amendamenti 7.

Regjia, deputetët gati. Votojmë tash:

49 janë “për” – 3 pa kartela – 52.

3 abstenojnë, asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 7.

Shkojmë te amendamenti 8.

Regjia, deputetët gati. Votojmë tash:

50 janë “për” – 3 pa kartela – 53.

Abstenojnë 2. Nuk ka asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 8.

Shkojmë te amendamenti 9.

Regjia, deputetët gati. Votojmë tash:

49 janë “për” – 3 pa kartela – 52.

3 abstenojnë. Asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 9.

Shkojmë te amendamenti 10.

Regjia, deputetët gati. Votojmë tash.

47 janë “për” dhe 3 pa kartela – 50.

3 abstenojnë. Asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Regjia, deputetët gati. Votojmë tash:

50 janë “për” dhe 3 pa kartela – 53.

2 abstenojnë. Asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Regjia, deputetët gati. Votojmë tash:

49 janë “për” – 3 pa kartela – 52.

3 abstenojnë. “Kundër” nuk ka – miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13. Regjia, deputetët gati. Votojmë tash:

Në sallë janë 63 deputetë.

46 janë “për” dhe 3 pa kartela – 49 “për”.

2 abstenojnë, asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Regjia dhe deputetët gati. Votojmë tash:

49 janë “për” dhe 3 pa kartela – 52.

2 abstenojnë, asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Regjia dhe deputetët gati. Votojmë tash:

52 janë “për” – 3 pa kartela – 55 janë “për”.

3 abstenojnë, asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Regjia dhe deputetët gati. Votojmë tash:

53 janë “për” – 3 pa kartela – 56.

3 abstenojnë, asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Regjia dhe deputetët gati. Votojmë tash:

Për amendamentin 17 kanë votuar “për” 48 dhe 3 pa kartelë – 51, ndërkaq kanë abstenuar 3 dhe asnjë “kundër” – miratohet amendamenti 17.

Të paraqitur për fjalë e kemi zotëri Riza Smakën. Urdhëroni, zoti Smaka!

RIZA SMAKA: Një projekt amendament në tekstin e nenit 21 të këtij dokumenti, i cili fillimisht thotë kështu: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”, i cili ,sipas meje, do të duhej të ndryshohej si vijon: “Ligji për plotësimin e Ligjit numër 2004/5 për tregtinë me naftë dhe derivatet e naftës hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”, sepse në rastin konkret do të hynin në fuqi ndryshimet e këtij dokumenti e jo ligji. Tek e fundit, kjo do të arsyetohej edhe me nenin e parë atje 1, ku nuk është dhënë definicioni se ky dokument do të quhet tash e tutje ligj, porse nuk është thënë e me qenë se nuk është thënë, do të krijohej konfuzion dhe është fjala për emërtimin e plotë që në substancë nuk ndryshon asgjë, mirëpo e jep një shpjegim të nevojshëm për këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Smaka. T’ju përkujtoj se amendamenti i zotëri Smakës nuk e ka përkrahjen e komisionit funksional, si do qoftë, ne do ta hedhim në votim dhe do të votojmë “për” ose “kundër” dhe pikërisht tani regjia është gati dhe ju. Votojmë tash:

(Reagime)

Shikoni, do të votojmë amendamentin e zotëri Smakës, i cili amendament nuk e ka përkrahjen e Komisionit.

(Reagime)

Unë thashë, po më duket, ju lutem, regjia edhe një herë të përsëritet votimi. Besoj se jemi gati! Votojmë tash:

E kemi këtë rezultat: 28 janë “për”, 6 abstenojnë, 10 janë “kundër”. Atëherë, edhe si i tillë miratohet amendamenti. Faleminderit për asistimin juridik.

Atëherë, ka ardhur koha që të votojmë tekstin e ligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Regjia, deputetët gati! Votojmë tash:

Rezultati i votimit është: 51 janë “për” plus 3 pa kartelë – 54. 3 abstenojnë dhe asnjë “kundër”, prandaj në këtë mënyrë e kemi miratuar ligjin bashkë me amendamentet.

Duke qenë se ka ardhur koha për drekë, ju uroj drekë të mirë. Shihemi në orën 14:30.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI, EQREM KRYEZIU: Zonja dhe zotërinj deputetë, po vazhdojmë seancën e sotshme dhe në radhë është pika e pestë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lizingun financiar**

T'ju përkujtoj se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për lizingun financiar dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet dhe rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve.

Para se të procedojmë me votim të amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet e Financa, zotëri Gani Kocin që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime, në qoftë se është i vullnetshëm dhe e sheh të nevojshme.

Nuk e sheh të nevojshme, zotëri Koci? Atëherë, deputetë të nderuar, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga Komisioni funksional sipas radhës që paraqitet në raport.

T'ju përkujtoj se në sallë janë të pranishëm 61 deputetë, që do të thotë se mund të procedojmë me votimin e amendamenteve.

Shkojmë te amendamenti numër 1.

Regjia dhe deputetët, gati! Votojmë tash:

Konstatoj se me 48 vota “për”, 4 abstenojnë, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 1.

Tani në sallë janë 62 deputetë.

Shkojmë te amendamenti numër 2.

Regjia, deputetët, gati! Votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 2.

Shkojmë te amendamenti numër 3.

Regjia, deputetët, gati! Votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 5 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 3.

Shkojmë te amendamenti numër 4.

Regjia, deputetët, gati! Votojmë tash:

42 janë “për” dhe 5 pa kartela – 47, 4 abstenojnë, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 4.

Shkojmë te amendamenti numër 5.

Regjia dhe deputetët gati! Votojmë tash:

Konstatoj se me 46 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 5.

Shkojmë te amendamenti numër 6.

Regjia dhe deputetët, gati! Votojmë tash:

Konstatoj se me 52 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 6.

Shkojmë te amendamenti numër 7.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 50 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 7.

Shkojmë te amendamenti 8.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 3 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 8.

Shkojmë te amendamenti numër 9.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër” miratohet amendamenti 9.

Shkojmë te amendamenti 10.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 50 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 10.

Shkojmë te amendamenti numër 11.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 48 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 11.

Shkojmë te amendamenti numër 12.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 50 vota “për”, 3 abstenime, 2 “kundër” miratohet amendamenti numër 12.

Shkojmë te amendamenti numër 13.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 49 vota “për”, 2 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 13.

Ju njoftoj se të pranishëm në sallë janë 60 deputetë, që do të thotë se nuk mund të vazhdojmë dhe lusim regjinë t’i bie ziles edhe një herë a dy.

Tani mund të vazhdojmë. I kemi 61 deputetë në sallë.

Shkojmë te amendamenti 14.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 14.

Shkojmë te amendamenti numër 15.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 55 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 15.

Shkojmë te amendamenti numër 16.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 3 abstenime, 1 “kundër” miratohet amendamenti numër 16.

Shkojmë te amendamenti numër 17.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatoj se me 53 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 17.

Shkojmë te amendamenti 18.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 56 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 18.

Shkojmë te amendamenti numër 19.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 19.

Ju përkujtoj se në sallë janë 61 deputetë dhe mund të vazhdojmë.

Shkojmë te amendamenti numër 20.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti numër 20.

Shkojmë te amendamenti 21.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 53 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 21.

Shkojmë te amendamenti 22.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 22.

Shkojmë te amendamenti 23.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 55 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 23.

Shkojmë te amendamenti 24.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 52 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 24.

Shkojmë te amendamenti 25.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Konstatohet se me 54 vota “për”, 2 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 25.

Shkojmë te amendamenti 26.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Për amendamentin 26 kanë votuar 51 deputetë “për”, ndërkaq abstenojnë 3 dhe nuk është asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 26.

Shkojmë te amendamenti 27.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Amendamenti i fundit ka marrë 55 vota “për”, ndërkaq kanë abstenuar 2 dhe nuk është asnjë “kundër” dhe miratohet amendamenti 27.

Ju njoftoj, me kënaqësi, se kemi 65 deputetë në sallë. Në këtë mënyrë mund t’i qasemi votimit të tekstit të ligjit në tërësi, bashkë me amendamentet e miratuara.

Prandaj, lus regjinë dhe ju, zonja dhe zotërinj, që të bëheni gati dhe votojmë tash:

Ligji në tërësi, bashkë me amendamentet ka marrë 58 vota “për”, 4 kanë abstenuar dhe nuk është asnjë “kundër”, kështu që Kuvendi miratoi Ligjin për lizingun. Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës, që është:

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore

Ju njoftoj se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për themelimin e Departamentit për Mjekësi Ligjore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet me rekomandimet e komisioneve u janë shpërndarë deputetëve.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotëri Bahri Hysenin apo ndonjë raportues të komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandimet. Zoti Bahri Hyseni!

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë,

Pas leximit të parë të Projektligjit për Departamentin e Mjekësisë Ligjore, duke kuptuar rëndësinë e Projektligjit në fjalë, duke kuptuar se deri më tani ky institucion ka qenë i organizuar në forma të ndryshme, kemi organizuar edhe takime të përbashkëta me ekspertë që vijnë pikërisht nga kjo fushë, por edhe me ekspertë të faktorit ndërkombëtarë, natyrisht jemi konsultuar edhe me propozuesin, me Ministrinë e Drejtësisë dhe në bashkëpunim me anëtarët e komisionit kemi arritur që të hartojmë 8 amendamente, edhe pse Projektligji ka qenë jo vëllimor, për të cilat amendamente konsiderojmë se e kanë qartësuar përmbajtjen e dispozitave ligjore të Projektit për Departamentin e Mjekësisë Ligjore.

Vlen të përmendet se tash e tutje, me këtë projektligj, Departamenti do të kalojë në Ministrinë e Drejtësisë dhe natyrisht se do të krijohet si Departament i pavarur në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë.

Vlen të përmendet se kemi filluar në Projektligj që të krijojmë një bazë të qëndrueshme që ky departament në të ardhmen të sjellë rezultate duke marrë parasysh se deri më tani ky departament ka qenë anash dhe në mungesë të ekspertëve dhe në mungesë të organizimit jo të mirë ka pasur ngecje sa i përket detyrës prioritare që e ka pasur me rastin e caktimit të ekspertëve të ndryshëm, sidomos nëpër gjykatat e Kosovës ku aktualisht, për shembull, disa ekspertë edhe pa u bazuar në ligj po japin mendime mjekoligjore me raste të ndryshme ku kërkohet mendim ligjor.

Prandaj, kisha lutur deputetët e Kuvendit të Kosovës që t'i shikojnë amendamentet, t'i përkrahin dhe, natyrisht, së bashku me amendamentet ta përkrahin edhe ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni!

Atëherë, të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional, sipas radhës së paraqitur në raport.

Ju njoftoj se 63 deputetë janë të pranishëm në sallë, prandaj shkojmë me votim.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati për votim.

Votojmë amendamentin 1 – i quajtur “Smaka”, por i përkrahur... Mirë! Amendamenti “Smaka” i përkrahur nga komisioni funksional.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Amendamenti ka marrë 50 vota “për”, 2 abstenime dhe asnjë “kundër” miratohet amendamenti numër 1.

Amendamenti 2.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 3 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 53 vota “për”, 5 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 6 abstenime dhe 1 “kundër”, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 44 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 52 vota “për”, 4 abstenime, 1 “kundër”, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 4 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti i fundit 8.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 51 vota “për”, 5 abstenime, asnjë “kundër”, miratohet amendamenti 8.

Tash do të votojmë Ligjin në tërësi, bashkë me amendamentet e miratuara.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati. Votojmë tash:

I tërë teksti i Ligjit, bashkë me amendamentet, ka marrë 55 vota “për”, 4 abstenime dhe asnjë “kundër”, prandaj miratohet Ligji për Departamentin e Mjekësisë Ligjore.

Tani, zonja e zotërinj deputetë, vazhdojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës, që është:

- Rishqyrtimi i Ligjit për të drejtat sendore

Në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, datë 30 korrik 2008, dhe të mocionit të miratuar më 3 tetor 2008 për procedimin me ligjet e pashpallura, komisioni përgjegjës raportues ka rishqyrtuar tekstin e Ligjit për të drejtat sendore dhe Kuvendit i ka parashtruar rekomandimet me amendamentet e propozuara për shqyrtim dhe miratim.

Ky raport u është shpërndarë deputetëve.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, lus kryetarin e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, zotëri Bahri Hysenin, që të arsyetojë raportin me rekomandimet. Atëherë, në vend të tij, fjalën e ka Ramadan Gashi.

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Që në fillim dëshiroj të theksoj se ky ligj bën pjesë në grupin e ligjeve të pa shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe se është një ligj mjaft i rëndësishëm dhe është bërë një punë e madhe dhe me përkushtim i komisionit për trajtimin e këtij ligji. Andaj, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me Rregullën 35.4, 36 dhe 46 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2009, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të datës 30 korrik 2008, rishqyrtoi Ligjin për të drejtat sendore, të propozuar nga Qeveria e Kosovës dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqet këtë

R A P O R T

Komisioni vlerësoi se Projektligji për të drejtat sendore ka bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ligji për të drejtat sendore rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen dhe shuarjen e të drejtave sendore, rregullon pronësinë dhe të drejtat sendore të kufizuara si posedimin, të drejtat sendore të sigurimit dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit, rregullon çështjen e shndërrimit të të drejtave të kufizuara të pronësisë sendore ose të drejtave sendore tjera që mund të jenë të përshtatshme për këtë qëllim.

Ky ligj përcakton kushtet dhe procedurën, përkufizimin dhe marrjen e pronësisë dhe të drejtave tjera sendore kundër vullnetit të titullarit. Përmban dispozita që qartësojnë se ky ligj nuk zbatohet në fushën e të drejtave sendore publike ose për vlerat pasurore të përbashkëta, të cilat rregullohen me ligje të veçanta, përveç se në mënyrë specifike, kur parashihet ndryshe me këtë ligj.

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në cilësi të komisionit funksional, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të datës 30 korrik 2008 për riprocedimin e ligjeve të pashpallura të PSSP-së, në mbledhjen e 9 shtatorit 2008 për shqyrtimin e këtij ligji, caktoi grupin punues në përbërje të të cilit ishin anëtarët e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe jashtë Kuvendit caktoi ekspertë të fushës përkatëse, si vijon:

- një ekspert nga Fakulteti Juridik,
- një ekspert nga Gjyqësori, përkatësisht nga Gjykata Supreme e Kosovës, dhe
- një ekspert nga USAID-i.

Grupi punues ka punuar me përkushtim të madh dhe ka mbajtur dhjetëra takime dhe ka shqyrtuar çdo dispozitë të ligjit.

Grupi punues gjatë shqyrtimit ka gjetur se ka hapësirë për ndërhyrje me qëllim të qartësimit përmbajtjesor të ligjit.

Vlen të theksohet se gjatë punës në grupin punues kontribut të veçantë ka dhënë eksperti nga USAID-i, i mbështetur dhe i ndihmuar nga të gjithë anëtarët tjerë të grupit punues.

Komisioni, me rastin e shqyrtimit të Projektligjit me amendamentet e propozuara nga grupi punues, vlerësoi se ato ofrojnë një strukturë ligjore praktike, e cila kishte për të qenë efikase për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të titullarëve të të drejtave sendore.

Ky ligj, që është i lidhur me procedurën kontestimore, procedurën jo kontestimore dhe përmbaruese, mbulon në mënyrë solide materien përkatëse, e cila është e një rëndësie të veçantë dhe e cila për herë të parë po normohet me një ligj të tillë.

Komisioni për Legjislacion, duke u mbështetur në raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të datës 25 maj, konstatoi se ligji dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore dhe duke pasur parasysh masën e ndërhyrjes në Projektligj, Komisioni propozoi që amendamentimi të bëhet duke përfshirë kapituj të tërë dhe pjesë të veçanta dhe vendosi Kuvendit t'i paraqet rekomandimin që të miratohet Ligji për të drejtat sendore i propozuar, me dhjetë amendamente. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Gashi.

Atëherë, deputetë të nderuar, vazhdomë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional sipas radhës së paraqitur në raport.

Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati të votojmë amendamentin 1 dhe votojmë tash:

T'ju përkujtoj se në sallë janë 66 deputetë.

Me 48 vota “për”, 4 abstenime dhe 1 “kundër” miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Regjia dhe deputetët gati për votim, votojmë tash:

Me 48 vota “për”, 3 abstenime dhe 2 “kundër” miratohet amendamenti 2.

E kemi këtu në monitor zonjën Kosara Nikoliq. Pse, është paraqitur për fjalë zonja Kosara Nikoliq?

KOSARA NIKOLIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

U vezi ove tačke ja sam tražila da uzmem reč još kada je bilo usvajanje dnevnog reda, gospodin predsjednik Jakup nije mi dozvolio da se javim.

U vezi ovog zakona, imala bih da kažem to, da član 180. u opšte nema prevod na srpskom jetiku, a imamo 4-5 članova koji su vezani za taj član i ne znamo u opšte na šta se odnosi. I mi u Poslaničkoj grupi smo razmatrali to i mislimo da trebamo dati svoje učešće pošto se radi o zakonu koji je veoma bitan. Imamo tu nekih stavova koje možda treba protumačiti, jer nisu dobro ni prevedeni ni obrazloženi. Zato smatram da ovu tačku treba odložiti.

KRYESUESI: Faleminderit!

Vazhdojmë te amendamenti numër 3.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 47 vota “për”, 2 abstenime dhe 4 “kundër” miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 2 abstenime dhe 6 “kundër” miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 1 abstenim dhe 7 “kundër” miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 48 vota “për”, 1 abstenim dhe 6 “kundër” miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 49 vota “për”, 2 abstenime dhe 5 “kundër” miratohet amendamenti 7.

Në sallë janë 66 deputetë.

Amendamenti 8.

Regjia dhe deputetët gati për votim, votojmë tash:

Me 47 vota “për”, 2 abstenime dhe 4 “kundër” miratohet amendamenti 8.

Amendamenti i fundit, 9.

Regjia dhe deputetët gati për votim, votojmë tash:

Me 52 vota “për”, 1 abstenim dhe 5 “kundër” miratohet amendamenti 9.

Në këtë mënyrë tash kemi rastin të votojmë tekstin e Ligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Regjia dhe deputetët gati, votojmë tash:

Me 52 vota “për”, 1 abstenim dhe 5 “kundër”, miratohet Ligji për të drejtat sendore. Ju faleminderit!

Kalojmë te pika e tetë e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit për Ndihmë Juridike

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës ka shqyrtuar raportin e punës të Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2008 dhe ka rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin e tij në seancë plenare me rekomandimet e paraqitura në raport.

Raporti i punës së Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2008 me rekomandime të komisionit u është shpërndarë deputetëve.

Prandaj, e lus zotëri Bahri Hysenin, në qoftë se dëshiron ta marrë fjalën. Zotëri Bahri Hyseni e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në kuadër të fushëveprimit të komisionit kemi edhe rekomandimin e raporteve apo miratimin e raporteve të agjencioneve të pavarura. Në bazë të nenit 4 pika 4.17 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/36, Komisioni për Ndhimë Juridike brenda afatit të paraparë ligjor dhe për herë të parë ka raportuar në Komisionin për Legjislacion me raportin e punës për periudhën e vitit 2008.

Komisioni për Ndhimë Juridike është themeluar më 26 shtator 2007 në bazë të Rregullores 2006/36 dhe është organ i pavarur përgjegjës për të siguruar ndihmë juridike falas për të gjitha kategoritë e njerëzve të cilët nuk kanë mundësi materiale të kenë mbrojtje gjatë proceseve të ndryshme, qofshin ato penale, civile, administrative apo edhe për dhënien e ndonjë udhëzimi për çështje sociale dhe çështje të tjera.

Vlen të përmendet se ky Komision për Ndhimë Juridike ka qenë i pavarësuar nga Departamenti i Drejtësisë nga faktori ndërkombëtar më 24 qershor 2008. Themelimi i këtij organi të parë të këtij lloji në regjion, dëshmon aspiratat e shoqërisë sonë dhe dëshmon aspiratat e shtetit të Kosovës që qytetarëve të Kosovës t'u japë ndihmë juridike në rastet kur nuk e kanë mundësinë të caktojnë avokat për shkak të kushteve të vështira materiale. Është diçka e veçantë që, natyrisht, rregullorja që ka qenë në fuqi, që është nxjerrë nga Përfaqësuesi Special, ka pasur shumë zbrazësi juridike dhe zbrazësi të cilat kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në funksionalitet dhe në efikasitet të Komisionit për Ndhimë Juridike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 142 i ka dhënë mbështetje, në nenin 31 paragrafi 6 i ka dhënë mbështetje dhe ka paraparë ndihmën juridike si kategori kushtetuese dhe një herë e ka shfuqizuar këtë institucion me qëllim që ky institucion të përfundojë veprimtarinë e vet për të cilin është krijuar.

Komisioni për Ndhimë Juridike edhe pse ka vepruar për një kohë të gjatë, pra nga viti 2007, ende mund të thuhet lirisht se është i panjohur shumë për qytetarët e Republikës së Kosovës, edhe pse komisioni ka provuar që edhe nëpër mediume elektronike, edhe nëpër ato të shkruara shpeshherë të bëjë informacione me qëllim që qytetarët të lajmërohen për të paraqitur rastet të cilat i kanë dhe rastet për të cilat kërkojnë zgjidhje.

Megjithatë, vlen të përmendet që edhe sot qytetarët e Kosovës nuk e kuptojnë drejt dhe nuk kanë mundësi të marrin ndihmë juridike në të gjitha pjesët e Kosovës duke marrë parasysh organizimin të cilin e ka paraparë Rregullorja që sapo e përmenda.

Vlen të përmendet se Komisioni për ndihmë juridike vepron në tri shtylla. Është Komisioni për Ndhimë Juridike apo Këshilli, i cili përbëhet nga një komisioner dhe 8 zëvendëskomisionerë, gjë për të cilin komisioni ka pasur vërejtje, mirëpo është çështje e rregullores në fuqi, duke pas parasysh nga ky numër i madh i anëtarëve të cilët kanë për obligim të mbikëqyrin vetëm diku 13-14 zyrtarë ligjorë dhe nja 7-8 asistentë. Vepron në bazë të zyrave koordinuese për ndihmë juridike, të cilat kanë nga dy ekspertë ligjorë dhe nga një asistent dhe, natyrisht, i ka byrotë e qarkut për ndihmë juridike, të cilat veprojnë në zyrat operative në 5 komuna të Kosovës.

Nëse merret dhe shikohen kriteret të cilat janë përdorur për dhënien e ndihmës juridike, mund të theksohet se komisioni ka vepruar pikërisht me rregulloren dhe ndihmë juridike iu ka ofruar të gjithë banorëve të Kosovës të cilët kanë pasur nevojë, ndihmë juridike iu ka ofruar edhe qytetarëve të cilët përkohësisht jetojnë në Kosovë, nëse kanë ardhur nga vendet të cilat iu kanë dhënë ndihmë qytetarëve të Kosovës, do me thënë, parimi i reciprocitetit ka vlerë, por edhe për vendet të cilët i ofrojnë ndihmë juridike shtetasve të Kosovës dhe të cilët përkohësisht janë në misione të ndryshme në Kosovë.

Por, vlen të përmendet një fakt, që ndihma juridike edhe pse ka pasur një buxhet, konsiderojmë se ky buxhet ka qenë i pamjaftuar, por në këtë rast mund të theksoj se nuk ka qenë faji shumë të Ministria për Ekonomi e Financa, të Qeveria e Kosovës që nuk ka paraparë buxhet shumë për këtë institucion, sepse institucioni në fjalë nuk ka arritur ta shfrytëzojë buxhetin të cilin e ka pasur edhe në kodin i cili iu ka ndarë, por ekzistojnë disa arsye që unë nuk do t'i përmend tash. Çështja ka qenë, nuk kanë pasur në fillim staf të mjaftueshëm civil, nuk i kanë pasur organet e domosdoshme të cilat merren me çështje të buxhetit, të prokurimit e kështu me radhë.

Nëse e marrim dhe e shikojmë përbërjen e komisionit, e shihni që janë 8 zyrtarë zëvendëskomisionerë, të cilët natyrisht që për punën që e kanë bërë në këtë këshill, kanë marrë mëditje në formë të pagave, të cilat nuk janë edhe shumë të vogla në krahasim me pagat të cilat sot i marrin punonjësit që punojnë nëpër institucionet e Kosovës. Por, mbetet shumë diskutabile dhe shumë ka qenë shqetësuese për komisionin, a thua a ka nevojë një këshill t'i ketë 9 zyrtarë, 1 komisioner dhe 8 zëvendëskomisionerë, si i quan rregullorja, e të menaxhojmë me kaq numër të vogël të zyrtarëve, a thua ky komision është krijuar për t'u dhënë ndihmë qytetarëve të Kosovës që kanë nevojë, apo është krijuar për t'i mbështetur njerëzit në këto këshilla, të cilët takohen sipas ligjit shumë pak brenda 12 muajve, por edhe nëse takohen një herë në javë, natyrisht që mbështetja financiare është shumë e lartë.

Ju thashë në fillim që Këshilli ka pasur për obligim t'i shqyrtojë të gjitha kërkesat, duke i përmendur edhe ato që vijnë nga fushat penale, civile, administrative dhe çështjet tjera të cilat janë me karakter social dhe, natyrisht, edhe udhëzime të ndryshme për të mbrojtur ndonjë çështje.

Por, nëse e marrim numrin e ankesave për të cilat ka vendosur ky komision për ndihmë juridike, për ne pak mandej del shqetësuese. Gjithsej kanë qenë diku 1.384 kërkesa, të cilat i ka vendosur Komisioni për Ndihmë Juridike brenda periudhës për të cilën po raportojmë. Dhe, ndarjet kanë qenë në penale, civile, shumë pak ka pas në penale, 78 apo 80 raste, të tjerat kanë qenë më tepër në çështjet civile dhe administrative.

Dhe, me plot të drejtë mund të konstatojmë se komisioni, për shkak të organizimit që e ka jo adekuat, nuk ka pasur mundësi për të dhënë ndihmë meritore çfarë e dëshirojnë qytetarët e Kosovës, sepse i bie që diku 20 zyrtarë, nëse mund t'i marrim tash edhe si ekspertë gjyqësorë apo gjyqtarë, kanë zgjidhur vetëm 1.384 lëndë dhe shumica prej këtyre lëndëve nganjëherë kanë qenë vetëm sa për ta orientuar një qytetar se ku duhet ta kërkojë të drejtën apo për ta orientuar një qytetar në cilën ministri duhet të lajmërohet apo për të njoftuar një qytetar se si duhet të hartohet një ankesë, pa i përjashtuar edhe rastet penale dhe civile të cilat kanë qenë pak më të koklavitura. Por, nëse e marrim dhe e krahasojmë me një punë të gjyqtarit, atëherë kishim për të thënë se një gjyqtar i cili me gjithë punën joefikase që e ka Gjyqësori në Kosovë, megjithatë ai vetë brenda një viti i

përfundon diku ndoshta s'po them më tepër, por nga 200 – 300 lëndë të karakterit penal dhe civil, për të cilat kërkohet natyrisht edhe punë, edhe mund, edhe hetime dhe gjithçka më tepër.

Prandaj është një fakt që vlen të përmendet, që në të ardhmen duhet domosdo të shikohet mënyra e organizimit të Komisionit për Ndihmë Juridike. Ne e respektojmë punën që....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, le t'ia vazhdojë zotëri Hysenit përfundimin e ekspozeut.

BAHRI HYSENI: Unë me qëllim e zgjata pak për atë arsye se është për herë të parë dhe nuk..., mirëpo nuk po e zgjati më tepër dhe po dal te rekomandimet të cilat Komisioni i propozon Kuvendit të Kosovës që t'i aprovojë:

Së pari, konsideroj që Qeveria e Kosovës sa më parë duhet të marrë nismë për ta hartuar Ligjin për ndihmë juridike. Rregullorja aktuale e bën shumë të paqartë dhe t'ju them se Komisioni për Ndihmë Juridike krejt punën e vet e bën pa e nxjerrë asnjë udhëzim administrativ apo urdhëresë, sepse kjo e drejtë iu ka dhënë Përfaqësuesit Special dhe paramendojeni sa mund të jetë efikase kur nuk ka mundësi të nxirret asnjë urdhëresë për ta zbatuar këtë rregullore.

Çështja e dytë, organizimi dhe funksionimi i tanishëm i Komisionit për Ndihmë Juridike në bazë të kësaj rregulloreje, ju thashë në fillim, është shumë i disfavourshëm për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve sepse vepron vetëm në pesë qendra, kështu të them, dhe zyrtarët detyrohen t'i vizitojnë të gjitha komunat, mirëpo paramendojeni sa probleme ndodhin kur një zyrtar duhet të shkojë për të vizituar një komunë nga regjioni, për shembull, i Gjilanit në Ferizaj, apo në Shtërpçë, apo në Kaçanik dhe paramendojeni, qytetarët duhet të presin vetëm për një udhëzim apo diçka tjetër.

Meqë ndihma juridike është edhe kategori kushtetuese, ne konsiderojmë se duhet gjithsesi Qeveria e Kosovës në të ardhmen të mendojë që të ketë buxhet dhe të ketë hapësirë, mirëpo ta mendojë edhe mënyrën e organizimit, të jetë mënyrë më efikase me qëllim që t'iu kryejë shërbimet qytetarëve.

Dhe, krejt në fund, kemi konstatuar se në Këshillin e Komisionit për Ndihmë Juridike janë edhe dy anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi për gjykatës të Gjykatës Kushtetuese, andaj kërkujmë që menjëherë Komisioni për Ndihmë Juridike në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës të fillojnë procedurën për ndryshimin e tyre, sepse Ligji për Gjykatën Kushtetuese nuk i lejon gjykatësit, përveç në çështjet akademike, të jenë anëtarë nëpër komisione tjera.

Prandaj, duke ju kërkuar, të nderuar deputetë, që t'i aprovoni edhe rekomandimet, ju falënderoj për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hyseni. Atëherë shkojmë me kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Partia Demokratike e Kosovës, e kreu. Zotëri Gashi!

RAMADAN GASHI: Faleminderit, zoti kryesues!
Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar raportin e punës së Komisionit të Ndihmës Juridike dhe rekomandimet e Komisionit për Legjislacion, si komision funksional, lidhur me këtë raport. Vërtet, kryetari i Komisionit këtu i tha në mënyrë të shkoqitur të gjitha ato çka përbën raportin por, vërtet, shikuar atë raport të Komisionit për Ndihmë Juridike se çka ka bërë për një vit, del se zyrtarët regjionale kanë zgjidhur më pak se një lëndë në ditë, do të thotë, ndihma nga ky komision juridik te qytetari ka arritur fare pak, do të thotë, është pothuaj se e paprekshme. Dhe, si i tillë, vërtet duhet diskutuar se a meriton të ekzistojë. Por, duke pasur parasysh se ndihma juridike është paraparë si kategori kushtetuese dhe është paraparë pikërisht për shtresat të cilat nuk kanë mundësi materiale që të përballen me drejtësinë, atëherë vërtet ia vlen që ky komision të bëhet funksional dhe ne e përkrahim rekomandimin që e ka bërë grupi, në fakt, komisioni funksional, që vërtetë ta funksionalizojmë këtë komision. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Gashi! Lidhja Demokratike e Kosovës, zotëri Zemaj është paraqitur.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zotëri kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pasi që ky organ i themeluar është edhe i pari i këtij lloji në regjion dhe tanimë edhe me Kushtetutë të Republikës së Kosovës është përcaktuar statusi dhe veprimtaria e tij, Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin në fjalë. Ne nuk do të ndalemi më shumë, sepse ato çka patëm edhe ne t'i themi, i sqaroi në mënyrë shumë të mirë edhe kryetari i Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, por ne mendojmë që krahas hartimit të këtyre raporteve duhet të kemi edhe kujdes në fushëveprimin, do me thënë, dhe aktivitetet të cilat paraqiten. Unë do të ndalem te dy vërejtje, njëra që ka të bëjë me prononcimin e njërës anëtare të këtij komisioni, tanimë gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, Gjylitetë Mushkolaj, e cila thotë se ky Komision për Ndihmë Juridike është gjithashtu përgjegjës për të siguruar që grupet e rrezikuara të shoqërisë, përfshirë komunitetet etnike jo shumicë, të kenë qasje në drejtësi, informim publik, ligjor dhe të kërkojë nga qeveria që procedurat për ndihmë juridike të jenë sa më të thjeshta, si dhe për të siguruar të dhëna statistikore për qasje në drejtësi.

Dhe, ne mendojmë se kjo bie ndesh me raportin, i cili është statistikor, i cili paraqitet në faqen 22, ku për ndihmë juridike dhe këshilla më së paku kanë kërkuar komunitetet pakicë dhe në këtë rast, për shembull, në regjionin e Mitrovicës nga komuniteti serb ka zero, do me thënë, që kanë bërë kërkesë apo ankesë.

Çështja e dytë, që ne i bëjmë vërejtje, është paraqitja mediale dhe e cila duhet të japë hapësirë që opinionin publik të informohet për këtë organ, i cili ekziston dhe mund ta shfrytëzojnë për të drejtat e tyre.

Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Zemaj! Në radhë është Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zotëri Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne kemi shqyrtuar raportin e Komisionit për Ndihmë Juridike dhe do të paraqes dy çështje, që mendoj se janë të rëndësishme në lidhje me këtë raport, pa u lëshuar në

çështje, në detaje teknike, që raporti megjithatë i ka disa mangësi që duhet të korrigjohen. Por, pa i përmend ato, po ndalem në dy çështje tjera. Nën një, është arsyeshmëria e funksionimit të Komisionit për Ndihmë Juridike ose logjika e ekzistimit të këtij komisioni. Ky komision është formuar në bazë të një rregulloreje të UNMIK-ut, numër 2006/36, është formuar në rrethana të veçanta dhe për qëllime të veçanta, që të përkrahë njerëzit që nuk kanë aftësi dhe nuk kanë mundësi, potencial apo përkrahje financiare për të mbrojtur të drejtat e tyre para ligjit në Kosovë.

Para se gjithash, duhet të thuhet që ky komision është rast i veçantë në rajon. Asnjë shtet tjetër në rajon nuk ka një komision të tillë që funksionon mbi baza të tilla siç funksionon Komisioni për Ndihmë Juridike në Kosovë.

Arsyeshmëria e ekzistimit të komisionit vihet në pikëpyetje për shumë arsye. Nën një, që është, besoj, më themelorja, mungon masa vlerësuese për suksesin e komisionit. Sipas përshkrimit të rregullores mbi të cilën vepron ky komision, komisioni ka për detyrë të ndihmojë qytetarët vetëm për të udhëzuar se ku duhet të orientohen ankesat e tyre. Nuk shkon më tutje. Po ta banalizojmë pak, do të thotë, një qytetar nuk di ku të orientohet për një të drejtë të tij dhe kërkon ndihmën e komisionit dhe komisioni e orienton, ta zëmë, se personi në fjalë duhet të drejtohet në kuvendin komunal, në ekzekutivin e komunës ose në këtë ministri ose në këtë drejtorat, e tjera, e tjera.

Do të thotë, komisioni ofron këtë ndihmë, por komisioni nuk e përcjell rastin tutje për të parë efektshmërinë e punës së vet. Kështu që, edhe në raportin që është ofruar, edhe në shqyrtimin që ne e kemi bërë në komision, Komisioni për Ndihmë Juridike ka qenë në gjendje të ofrojë shifra -sa raste i ka trajtuar, por nuk ka qenë në gjendje të ofrojë të dhëna për cilësinë e shërbimeve që ka kryer vet. Nuk ka qenë në gjendje dhe nuk mund të jetë në gjendje asnjëherë të thotë se prej këtyre rasteve të trajtuara, kaq për qind kanë rezultuar të efektshme ose me sukses. Kjo është arsyeja e parë që e vë në pikëpyetje logjikën e ekzistimit të këtij komisioni.

Arsyeja e dytë ka të bëjë me mosefikasitetin e veprimit të këtij komisioni. Nëse e marrim, për shembull, Byronë e Qarkut në Mitrovicë, që është njëra prej pesë byrove të Komisionit për Ndihmë Juridike dhe i shikojmë shifrat që ofron raporti i komisionit, atëherë nëse bëjmë një zbërthim të ditëve të punës të personave që punojnë në këtë byro dhe të lëndëve që e kanë trajtuar, atëherë i bie se brenda një viti kjo byro, që ka 3 vetë të punësuar, 2 ekspertë dhe një zyrtar të thjeshtë teknik, i bie se për një ditë pune ka trajtuar 0.68% të një rasti, do të thotë as një rast të plotë për një vit të plotë të punës. Nëse merret mesatarja që e përmendi edhe një koleg më herët këtu, e lëndëve të trajtuara nga një gjykatës i gjykatës në Kosovë, atëherë rezultati mund të jetë se një gjykatës vepron më me shumë efekt se sa një byro, njëra prej 5 byrove të Komisionit për ndihmë juridike.

Prandaj, në të ardhmen mendoj se institucionet e Kosovës duhet ta trajtojnë seriozisht këtë çështje në këtë kuptim, të debatohet a ka efekt dhe a ka logjikë ekzistimi i komisionit në këtë mënyrë çfarë është i organizuar tash. Që kanë nevojë qytetarët e Kosovës për ndihmë juridike falas ende, nuk e përjashtoi këtë mundësi, do të thotë kanë nevojë, por duhet të shikohen mënyra tjera të organizimit, e jo kjo çfarë është kështu në bazë të kësaj rregulloreje.

Çështja e dytë që desha ta trajtoj, është në rrethanat e tashme, do të thotë deri sa ekziston ky komision, ky komision tash ekziston dhe funksionon mbi bazë të kësaj rregulloreje të UNMIK-ut, e cila rregullore ka lënë shumë zbrazësi. Atëherë, ne mbështesim

propozimin, rekomandimin e komisionit që të hartohet ligji për komisionin nëse vihet në përfundim se ekziston nevoja për funksionimin e një komisioni të tillë. Do të thotë, nëse përfundimisht pajtohemi se duhet të ekzistojë një komision i tillë, atëherë ai duhet të rregullohet me ligj, por para se të bëhet ligji, Kuvendi duhet ta batojë arsyeshmërinë e ekzistimit të një komisioni të tillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Kosumi. Tani e ka radhën Aleanca Kosova e Re, zotëri Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Para vetes e kemi raportin e Komisionit për Ndihmë Juridike dhe unë do të doja që vetëm të tërheq vëmendjen e disa prej çështjeve që përmenden në këtë raport.

Në faqen 3, thotë kësisoj, po citoj: “Në formimin dhe veprimtarinë e Komisionit për ndihmë juridike roli i UNMIK-ut veçmas në fillim ishte parimor, gjë që nuk mund të mohohet, por më pas ky rol u zbeh dhe personeli i UNMIK-ut në bashkëveprim me të zgjedhurit e vet vendës filluan të bëhen pengesë serioze në zhvillimin dhe funksionimin e Komisionit për Ndihmë Juridike”. Na thotë diçka se çka kupton kjo, domethënë ky është raporti. Dhe pastaj e keni në të njëjtën faqe: “Me insistimin tim të vazhdueshëm dhe të KNJ-së, në qershor të vitit 2008 është nënshkruar marrëveshja e mirëkuptimit me Departamentin e Drejtësisë së UNMIK-ut, me ç’rast bëhet bartja definitive e të gjitha kompetencave”. Ne të gjithë e dimë që kompetencat janë bartë në të gjitha fushat pa insistim të askujt.

Kolegë, ne jemi të vetëdijshëm që Kushtetuta e Republikës së Kosovës, por edhe dokumentet tjera garantojnë mbrojtjen juridike të qytetarëve të Kosovës edhe pa këtë komision. Kushtetuta e Republikës dhe të gjitha ligjet garantojnë që në rast të pamundësisë për të angazhuar mbrojtës të drejtpërdrejtë, atëherë kemi mbrojtësit e autorizuar nga ana e gjykatave, por edhe të tjera.

Dhe, përderisa e kemi këtë gjendje kësisoj, unë vetëm do të përmend edhe një rast tjetër, edhe një çështje. Ky komision nuk ofron mbrojtje të drejtpërdrejtë juridike për personat që kanë nevojë. Ky komision i shqyrton dokumentet e atyre që kërkojnë ndihmën dhe në mbështetje të këtyre dokumenteve të tyre i drejtojnë pastaj në fazën tjetër, që janë avokatët, që kryesisht angazhohen përmes Odës së Avokatëve të Kosovës. Pra, kemi një lidhje në mes të këtyre, por nuk ofrojnë ndihmë të drejtpërdrejtë juridike.

Vetëm po të shihni këtu, u përmend edhe nga ana e kryetarit të komisionit, por edhe nga të tjerët, merreni me mend, e keni një bord prej 8 ose 9 vetëve, thua se kemi të bëjmë me një organizatë që ka mijëra të punësuar dhe nuk mund të menaxhohen. 8 vetë i menaxhojnë 23-24 vetë. Do me thënë, kjo flet më së miri për nevojën që ka nxjerrja e shpejtë e një ligji për ndihmën juridike falas në mbështetje të të cilit pastaj do të përcaktoheshin edhe format, edhe modalitetet e tij, madje në shumë raste, sepse këto qendra ekzistojnë vetëm në qendra të mëdha, qytetarët ndoshta kanë shpenzuar shumë më tepër duke shkuar te këto zyre, se sa që kanë pasur benifit prej këtyre zyrave drejtpërdrejt.

Ne angazhohemi që të nxirret Ligji për Komisionin për Ndihmë Juridike, që në mbështetje të ligjit pastaj të përcaktohen edhe format se të çfarë natyre do të duhej të ofrohen ndihma dhe cilat kategori mund të përfitojnë nga këto ndihma. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Makolli! Është radha për Lidhjen Demokratike të Dardanisë, zotëri Adem Salihaj e ka fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Lidhja Demokratike e Dardanisë e ka shqyrtuar raportin e Komisionit për Ndhimë Juridike dhe ne përafërsisht kemi për të thënë atë që kryesisht u tha këtu. Është një komision që, të themi sinqerisht, nuk ka qenë i njohur sa duhet për ne deputetët, e të mos flasim për qytetarët e Kosovës dhe, si pasojë pra, qytetarët nuk arrijnë sa duhet ta shfrytëzojnë ndihmën e këtij komisioni. Edhe ashtu ky komision duket se nuk ka mund të japë ndonjë ndihmë shumë serioze. Në anën tjetër, ka një këshill drejtues të madh për një komision të vogël, do të thotë edhe këtu duhet të shihet edhe aspekti i tillë dhe, në anën tjetër, duhet të shihet ndryshimi i ligjit për këtë komision, plotësimi i tij në mënyrë që vërtet të jetë një komision që mund ta japë një kontribut deri diku serioz për çështjen për të cilën ekziston. Pra, ne do të angazhohemi për ndryshimin dhe kompletimin e ligjit dhe kjo është mënyra që ne ta bëjmë efikas këtë komision. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri Salihaj! Është radha për Grupin “7+”, zotëri Xhezair Murati.

ĐŽEZAIR MURATI: Hvala predsedavajući!

Pošto nema ministara, ja pozdravljam sekretara i svoje kolege u sali i to pominjem javno, jer nema nam ministara, možda je njima strana ova kategorija, ali da napomenem samo da predsednika komesara i članova ove komisije postavlja upravo premijer u dogovoru sa resornim ministarstvom, dakle Minstarstvom pravde, predsednikom Vrhovnog suda, sa Komisijom za prava i interese zajednica i tako dalje i na tom spisku već vidim dva imena koja su izabrana za sudije Ustavnog suda Republike Kosova, tako da po gotovo iz manjinskih zajednica, iz redova manjinskih zajednica treba što pre da se popuni taj član, jer u opisu poslova rada ove Komisije, jedna od važnih segmenata je pravna pomoć ugroženim grupama i manjinskim zajednicama. Mislim da bi smo trebali biti efikasniji kako bi se ova pravna praznina popunila. Ja bih takodje rekao da Komisija za pravnu pomoć je predviđena Ustavom Republike Kosova i da je ona relativno nepoznata za širu javnost, da se njene usluge vrlo malo koriste, da mi treba da na svaki način kosovsku javnost obavestimo, pogotovno ugrožene grupe građana koji nemaju sredstva da plate skupe takse koje naplaćuju pravni zastupnici i tako dalje, kako bi koristili ovu pomoć, a da ne, recito, da komisija pruža pomoć gadjanima koji materijalno bolje stoje, koji mogu lakše doći do ovih komisija. Njene članove uglavnom čine pravni eksperti tako da je njen delokrug rada veoma širok i posebno je bitno to da ona pruža pomoć ugroženim kategorijama, recimo hendikepirana lica sa otežanim sposobnostima i tako dalje, i zaista mislim u javnosti je malo poznato da postoji, ja bih rekao, pravni servis usluga građana.

Mislim da je ovo jedna pravna novina za nas i da trebamo sve učiniti kako bi njen rad zaista zaživeo i njenu pomoć doživeli oni kojima je potrebno. Vrlo je bitno to da u odredjivanju članova komisije treba da učestvuju i predstavnici nevladinih organizacija, tako da mi kao Parlamentarna grupa podržavamo ovaj Izveštaj i pridružujemo se onima koji misle da treba da se donose zakon o radu ove komisije. Hvala vam!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Murati!

Nga Grupi parlamentar SLS, është paraqitur zotëri Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsedavajući!

Uvažene kolege poslanici,

Parlamentarna grupa SLS će podržati ovaj izveštaj, jer smatramo da je stvarno postojanje jednog ovakvog tela organa ili komisije jako neophodno. Medjutim, ako malo analiziramo šta su oni radili u prethodnom periodu, izgleda slaba vajda pa bih ja hteo da kažem, neka su nam živi i zdrvi samo i da probamo da nateramo te ljude da malo budu poznantiji javnosti, jer da se ne rukovodimo po onoj narodnoj „U Solunu jedan dinar jedan somun, a do Soluna dva somuna“ jer pričamo o socijalno urgorženim kategorijama ljudi kojima treba bezplatna pravna pomoć, a ove kancelarije ili gde su sedišata ovih sudova su toliko daleko i da ne mogu ljudi da dolaze, trebaju im više para da dodju da potraže Komisiju, da dodju do saznanja, nego da plate nekog advokata koji već u njihovoj opštini i u okruženju ili u mestu funkcioniše.

Naravno, ako je problem i budžet i finansije, mnogo je bolje dati veća sredstva da bi nešto bilo funkcionalno, nego trošiti bilo kolika sredstva za nešto što nema nikakvog smisla. Ja mislim da moramo malo više da povedemo računa, pogotovo oni koji su nadležni za postavljenje i mirovanje ove komisije, kako bi ovo dalo pun doprinos jer vam ja odgovorno tvrdim da ljudi iz Srpske zajednice, a verujem i iz ostalih zajednica, nisu dovoljno upoznati, jer kada vidim ovde prema broju slučajeva koji su prijavljeni i prema broju stanovnika i znajući koliko broj ljudi po svom socijalnom statusu zaslužuju ovakvu pomoć, mislim da bi malo više morali da uradimo na promociji te komisije kako bi dali funkcionalnost i ona stvarno opravdala svoju ulogu, jer da radimo formu radi suštine, a ne formu radi forme. Hvala!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri Stojanoviq!

Tani shkojmë te deputetët që janë paraqitur për ta marrë fjalën dhe është radha për zonjën Sanije Alijaj, të bëhet gati zonja Gjylnaze Syla.

SANIJE ALIJAJ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Raporti i Komisionit për Ndhimë Juridike që sot po e shqyrtojmë në këtë seancë plenare, është raport që prezanton veprimtarinë e Komisionit për Ndhimë Juridike, të themeluar në shtator të vitit 2007, me një rregullore të UNMIK-ut, i cili është organ i pavarur që u ofron ndihmë juridike palëve për çështjet penale, civile dhe administrative, qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe qytetarëve të huaj që përkohësisht jetojnë në Kosovë.

Raporti kryesisht prezanton anën organizative dhe numrin e kërkesave të drejtuara nga qytetarët e Kosovës, kurse nuk jep informacion të duhur sa i përket procedimit të mëturjeshëm për zgjidhjen e shkeljes së të drejtave të njeriut për të cilat qytetarët tentojnë të gjejnë zgjidhje.

Komisioni për Ndhimë Juridike veprimtarinë e vet e ushtron përmes gjashtë komiteteve dhe Zyrës koordinuese për ndihmë juridike, byrove të qarkut, për ndihmë juridike që funksionojnë në gjashtë qendrat kryesore të Kosovës: në Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjiilan.

Nga raporti kuptojmë se Komisioni për ndihmë juridike, me kapacitetet ekzistuese, qofshin ato njerëzore, organizative, ligjore, në veçanti ato buxhetore, nuk mjaftojnë për të përmbushur standardet në drejtësi, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me konventat ndërkombëtare për realizimin e të drejtave civile, administrative dhe penale. Edhe përkundër këtyre pengesave, Komisioni për Ndhimë Juridike si organ i pavarur për të mbikëqyrë sistemin e ndihmës juridike, efikasitetin e

punës ka tentuar ta rrisë përmes 26 trajnimeve për stafin e saj, përmes edukimit dhe ngritjes së vetëdijes së publikut, përmes prezantimit të objektivave të punës, në tryezat e organizuara nga shtetet fqinje dhe përmes prezantimit të punës së tij në media.

Komisioni për Ndihmë Juridike punën e vet e bazon në parimet themelore që garantojnë të drejtat e njeriut, duke ju ofruar ndihmë juridike falas në lëmin e çështjeve civile dhe ka tentuar të zgjidhë 454 raste, në lëmin e çështjeve administrative dhe ka tentuar të zgjidhë 769 raste, kurse në lëmin e çështjeve penale do të ndalem në bazë të raportit. Për shkak të mosgatishmërisë për bashkëpunim të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për ofrimin e ndihmës në çështje penale, Byroja e Qarkut për Ndihmë Juridike ka dhënë vetëm këshilla juridike në 82 raste për përpilimin e shkresave dhe për shkurtimin e procedurave. Pra, gjithsej ka zgjidhur 1354 kërkesa falas, që krahasuar me nevojat e qytetarëve janë shumë pak.

Duke u nisur nga të dhënat e prezantuara në raport, por edhe nga adresimet që i bëhen Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, është një numër i madh i kërkesave ku shkelen të drejtat e njeriut, e në veçanti e drejta e punës, del se një numër i madh i qytetarëve ka nevojë për ndihmë juridike. Duke u nisur nga këto fakte, përkrah rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, por që Komisioni për Ndihmë Juridike të jetë efikas, propozoj të krijohen nga Ministria e Drejtësisë, konkretisht nga Qeveria e Kosovës, edhe disa parakushte: buxhet të mjaftueshëm, nga Ministria e Drejtësisë kërkoj që të kërkojë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të bashkëpunojë me Komisionin për Ndihmë Juridike që të zgjidhë çështjet me karakter civil, penal edhe administrativ, hapësirë dhe staf të domosdoshëm, si dhe komisioni punën e vet ta programojë në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sepse ndihma juridike është kategori e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Sanije! Fjalën e ka zonja Gjylnaze Sayla, të bëhet gati zotëri Riza Smaka.

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, i nderuari zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Po shqyrtojmë sot Raportin njëvjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike, pra për vitin 2008.

Ashtu siç është prezantuar raporti, unë do t'i përfshijë në tri nivele. E para, ka të bëjë me vet historikun, siç e shpjegon raporti, e dyta, ka të bëjë me organizimin e këtij komisioni dhe, e treta, me aktivitetet e komisionit. Sa i përket historikut të tij dhe themelimit, ashtu siç është cekur në raport, është formuar me Rregulloren e UNMIK-ut dhe më vonë dhe më vonë me marrëveshjen e cila është bërë në mes të komisionit dhe Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, është bërë bartja e kompetencave nga departamenti në komision. Do të thotë, ky është formimi i komisionit, i cili në të vërtetë është paraqitur ose është më tepër një agjencion i pavarur dhe qëllimi i të cilit është dhënia e ndihmës juridike falas për çështje të ndryshme, por jo vetëm për qytetarët e Kosovës, por edhe për qytetarët e huaj të cilët gjenden përkohësisht në Kosovë ose për personat tjerë që janë përcaktuar me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare.

Megjithatë, nga raporti kuptohet se ky komision i ka kapacitetet e vogla për dhënien e ndihmës falas ose të ndihmës juridike falas qytetarëve të Kosovës, sidomos duke marrë

parasysh gjendjen e rëndë ekonomike në të cilën gjenden qytetarët e Kosovës dhe nevojën e madhe që t'ju ofrohet ndihma juridike falas.

Nga aktivitetet, unë kisha shquar një memorandum që e ka bërë komisioni me Oden e Avokatëve, me të cilën përpiqet që të ketë qasje në shërbimet e anëtarëve të Odës së Avokatëve të Kosovës. Në përfundim, dilet nga ky raport se, në të vërtetë, i gjithë aktiviteti i këtij komisioni është më tepër referues. Nuk kemi të dhëna se cilat janë rezultatet e këtyre rasteve të cilat i kanë referuar.

Sa i përket organizmit, këtë e tha edhe kryetari i komisionit, është bërë në tri shtylla, do të thotë, e para është vetë komisioni ose Këshilli, pastaj Zyra ekzekutive dhe zyrat operative. Megjithatë, është e qatë se kanë vështirësi në funksionim, po ashtu edhe në efikasitet, duke marrë parasysh si numrin e stafit, por edhe mostrajtimin e tyre, si dhe buxhetin e vogël.

Prandaj, në fund, unë mbështes rekomandimet e komisionit, sidomos rekomandimin i cili ka të bëjë me nxjerrjen e Ligjit për formimin ose për Komisionin për Ndihmë Juridike, e cila, në fund të fundit, është edhe kategori kushtetuese. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, zonja Sylja! Radhën e ka zotëri Samaka.

RIZA SMAKA: I nderuari zotëri kryesues,
Kolegë të nderuar,

Në vendin tonë, mjerisht, është një numër jashtëzakonisht i madh i qytetarëve nevojtarë për ndihma juridike, ama për ndihma juridike reale, e jo udhëzime, se për këtë çështje duhet të shkoj këtu apo atje dhe, tek e fundit, edhe ato udhëzime shpeshherë kanë qenë pseudo apo huazi, që ka ndodhur që ka shkuar atje ku është udhëzuar, por ka dal se jo, nuk është dashur të shkohet atje, do me thënë hapet çështja e profesionalizmit, e insuficiencës profesionale në strukturat e këtij komisioni.

Ndryshe, rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi janë korrekte dhe konsideroj se ka bërë një punë shumë të mirë dhe do të duhej të përfilleshin, të mos mbeteshin vetëm rekomandime më pastaj, por me të vërtetë Qeveria ta merrte këtë punë menjëherë dhe të angazhonte atje ministrinë përkatëse për ta përgatitur projektligjin. Medoemos do të duhej me projektligj të ridefinohej jo komision, se komisioni, vetë komisioni apriori jep një nocion se është fjala për një organ kolegjal që e kontrollon një çështje dhe i skadon mandati me raportim. Ai është definicion, se ka definicion për komision e për komitete, për pleqësi e për të tjera. Ndoshta do të ishte term më i përshtatshëm -agjencion dhe do të duhej që ta kishim një agjencion në nivel qendror edhe agjensione për ndihmat juridike nëpër çdo komunë. Edhe nëpunësit, do të thotë stafi, do duhej të ishte i përbërë, se në konformitet me ligjin, sipas degëve për çështjet juridike penale, juridike civile, juridike ekonomike, juridike administrative dhe do të ishte zgjidhja shumë më e mirë sikundër të ishin ata dhe ato, stafi, të ishin së pakut në gradën e magjistratit apo të juristit specialist për fushat e caktuara, në mënyrë që rastet e përfaqësuara t'i përfaqësonin ashtu si duhet, sepse nevojtarët meritojnë. Ata që nuk janë, ata kanë mundësi për të paguar.

Gjithsesi do të duhej edhe norma të caktohej, që mos të mbetej ad-hoc aty, po norma dhe struktura e lëndëve, se nuk mund të merret ndihmë juridike, udhëzimi juridik se për këtë çështje duhet të shkosh në këtë institucion apo në këtë organ dhe, përfundimisht, apeloj që Qeveria ta marrë përsipër kompleksin e rekomandimeve të Komisionit për Legjislacion, natyrisht edhe të kolegëve të nderuar që i dhanë disa ide shumë të mira që

do të shërbenin si bazament solid për ta përgatitur një projektligj dhe sa më parë që të miratohej, do të bëhej më mirë, sepse kemi shumë nevojtarë, mjerisht, që kanë me të vërtetë nevoja të arsyeshme për t'u ndihmuar juridikisht. Ju faleminderit!

Drejtimin e seancës e rimerr zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit

KRYETARI: Ju faleminderit!

Ky ishte diskutuesi i fundit, tani është radha për të votuar. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten. A kanë për t'u votuar rekomandimet? Regjia, ziles i bie për t'i ftuar deputetët që janë këtu pari.

Konstatoj se në sallë janë 65 deputetë, ndoshta edhe më shumë, kështu që mund të fillojmë votimin. I thërras deputetët të përgatiten për votim dhe votojmë tash rekomandimet e komisionit.

Me 57 vota “për”, 5 “kundër”, 1 abstenim, konstatoj se Kuvendi miratoi Raportin e punës së Komisionit për Ndihmë Juridike për vitin 2008 me rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Vazhdojmë me pikën radhës:

9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2008

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, në pajtim me dispozitat e Rregullores së Punës, ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2008 dhe ka rekomanduar shqyrtimin e tij në seancën plenare. Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2008 u është shpërndarë deputetëve më 12.06. 2009. Radha i diskutuesve, kryetari i komisionit funksional, deputeti Esat Brajshori e ka fjalën!

ESAT BRAJSHORI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Konform nenit 3.8 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, Këshilli i Komisionit të Pavarur të Mediave i paraqet Kuvendit të Kosovës një raport vjetor brenda dy muajve pas përfundimit të çdo viti kalendarik, duke përfshirë në raport të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhjet me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit dhe objektivat e projektimit për vitin e ardhshëm.

Raporti vjetor i KPM-së për vitin 2008 i është adresuar Kuvendit të Kosovës me datën 03.03.2009. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 17 mars 2008, si pikë të rendit të ditës ka pasur shqyrtimin e Raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media. Komisioni me këtë rast e ka tërhequr raportin nga rendi i ditës për shqyrtim me arsyetimin se teksti i raportit në gjuhën serbe nuk është autentik me tekstin në gjuhën shqipe.

Komisioni, në mbledhjen e datës 24 mars 2009, ka shqyrtuar Raportin vjetor të KPM-së dhe ka nxjerrë konkluzion që nga KPM-ja të kërkohej plotësime shtesë për raportin me vërejtjet, si vijon:

1. Raporti nuk është strukturuar në formën që e ka paraparë vetë KPM-ja në planin vjetor 2008 dhe nuk është paraqitur ajo që ka qenë e paraparë të përmbushet në masën e asaj që parasheh ligji;
2. Të konkretizohen të dhënat për objektivat që KPM-ja ka përmbushur gjatë vitit 2008, objektiva të tjera që nuk i ka përmbushur dhe arsyet e mospërmbushjes;
3. Raporti nuk përmban të dhëna të plota në lidhje me përcaktimin e politikave të transmetimit;
4. Sa monitorime ka bërë KPM-ja gjatë vitit 2009-2008, përfshirë këtu edhe monitorimin ndaj transmetuesit publik. A ka monitoruar mediumet që nuk kanë licenca për transmetim, çfarë masash ka ndërmarrë;
5. Tek shkeljet e të drejtës autoriale, raporti nuk është i harmonizuar tek forma tabelare dhe forma e shkruar, shqiptimi i dënimeve me gjobë, të cilat figurojnë në formën e shkruar, nuk paraqiten në formën tabelare;
6. Tek shkelja e rregullave për reklamim, paraqitet vetëm shkelja që ka bërë Radiotelevizioni i Kosovës, ndërsa për transmetuesit tjerë nuk ka informim të plotë, meqë faktet flasin për shumë shkelje;
7. Raporti nuk përmban dedikimin e të hyrave nga gjobat;
8. Të sigurohet objektivi 5, të sqarohet objektivi për transmetuesin publik kombëtar në gjuhën e pakicave, a është fjala këtu për kanal televiziv një gjuhën e pakicave apo medium i veçantë për pakicën serbe;
9. Sa kohë i duhet KPM-së miratimi i Rregullores për subjektet transmetuese, për mbrojtjen e të miturve nga përmbajtjet e programeve të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin dhe edukimin e tyre.

Sipas Raportit të KPM-së për vitin 2007, është dërguar për komente te publiku në nëntor të vitit 2007. Këshilli këtë çështje e ka shtyrë për diskutim me arsyetimin se Zyrës së shefit ekzekutiv i duhet më shumë për ta kompletuar Rregulloren në bazë të standardeve evropiane.

Sipas Raportit të KPM-së për vitin 2008, drafti i fundit i kësaj Rregulloreje doli për komente më 31 dhjetor të vitit 2008, i cili afat është zgjatur deri më 21 janar të vitit 2009. Pastaj, cilat janë arsyet që KPM-ja nuk ka caktuar rregulla dhe kufizime për reklamim në Radiotelevizionin e Kosovës, me gjithë njoftimin se kontrata në mes KEK-it dhe RTK-së është vazhduar deri në nëntor të vitit 2009, arsyetimet që në raport janë të paqëndrueshme.

Çfarë është koordinimi me ART-në në menaxhimin e spektrit frekuencor. Raporti i Komisionit të Pavarur për Media, me plotësimet shtesë i është adresuar komisionit më 1 prill 2009. Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 21 prill 2009, ka rishqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Media me plotësimet shtesë dhe ka nxjerrë konkluzion që të shtyhet miratimi i Raportit vjetor të KPM-së deri në mbledhjen e radhës, kur edhe do të shqyrtohet rasti i Radio Sharrit, sepse më 30 mars 2009, Komisioni ka pranuar një

shkresë nga Radio “Zëri i Sharit” për mbylljen e kësaj radioje që ka rezultuar me konfiskimin e aparaturës në qershor të vitit 2008 nga Komisioni i Pavarur i Mediave.

Unë tani nuk do të hyja në gjithë historinë e kësaj çështjeje, por mund të them se komisioni ka thirr për ballafaqim të dy palët, do me thënë Komisionin e Pavarur për Media, drejtoreshën Argjentina Grazhdani, me ekipin e saj dhe drejtorin Radio “Zëri i Sharit” dhe nga gjithë ajo që është debatuar para komisionit, ka rezultuar se nga të dy palët ka pasur shkelje. Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 26 maj 2009, vendosi që për Raportin vjetor të KPM-së 2008, sipas nenit 3.8 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim, Kuvendit t’i paraqesë këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që Raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media 2008, të miratohet me vërejtjen e dhënë në arsyetim dhe arsyetimi pikërisht flet për çështjen e Radio Sharrit, çështje e cila akoma duhet të zgjidhet në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe të kësaj radioje.

Në anën tjetër, do të kisha dhënë disa informacione sa i përket punës së Komisionit të Pavarur për Media. Vitin e kaluar kur kemi debatuar për Raportin 2007 të KPM-së, kemi thënë se tregu medial është në kaos të vërtetë dhe unë mendoj se viti 2008 ka përmirësime të theksuara që prej momentin kur është kompletuar në përbërje gati të plotë Këshilli i Pavarur i Mediave, që nga koha kur është zgjedhur në këtë Kuvend Argjentina Grazhdani dhe Daut Demaku. Tani këtij Këshilli i mungon edhe një anëtar dhe ai anëtar duhet gjithashtu të zgjedhet nga ky Kuvend. Kuvendi e ka shtruar këtë çështje, saktësisht Kryesia e Kuvendit me datën 3 mars 2009, ka nxjerrë përfundimin që çdo grup parlamentar duhet të propozojë nga një anëtar të vetin dhe të vihet këtu në votim pastaj, sepse i mungon Komisionit të Pavarur të Mediave edhe një njeri që duhet të shkojë nga Kuvendi i Kosovës.

Sinqerisht, thënë, do me thënë puna që është bërë në vitin 2008 nga Komisioni i Pavarur për Media dallon shumë nga viti 2007. Ka një gatishmëri të madhe, një profesionalizëm më i theksuar, janë bërë punë të mira, sido që të jetë edhe Komisioni i Pavarur për Media nuk mund të dalë nga gjitha ato lëshime që bëjnë edhe në agjencionet e tjera. Ka një gatishmëri për bashkëpunim me Kuvendin dhe Komisionin gjegjë nga ana e KPM-së. Tani mund të them se jemi në rumbullakësim të amendamentimit të Ligjit të KPM-së dhe shpresoj që shpejt do të procedohet në këtë Kuvend dhe, si përfundim, unë them që Komisioni i Pavarur për Media, përkatësisht raporti që e kanë sjellë, të trajtohet në këtë Kuvend dhe të miratohet. E dhashë fjalën time në emër të kryetarit të komisionit parlamentar dhe në emër të grupit parlamentar. Ju faleminderit, shumë.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e shefave të grupeve parlamentare. Në emër të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Hajredin Hyseni.

HAJREDIN HYSENI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti ministër,

Të nderuar deputetë,

Raporti i Komisionit të Pavarur për Media dallon nga raportet e tjera të këtij komisioni të viteve të mëparshme, sepse mund të themi se ky raport i përmbush në masë të madhe kriteret e një raporti, i cili pasqyron punën e komisionit dhe ne, si Kuvend, nga ky raport mund të kuptojmë për realizimin apo mosrealizimin e detyrave ligjore që ka Komisioni i Pavarur për Media.

Në qoftë se i shikojmë objektivat e komisionit, të cilat i ka numëruar në 5 objektiva në raportin e tyre për vitin 2008, shohim se në ç'masë i ka realizuar ky komision këto objektiva, mund të themi se Komisioni i Pavarur për Media në vitin 2008 ka bërë një punë për çka është për t'u çmuar me gjithë vështirësitë që ka pasur, ka bërë licencimin e operatorëve kabllor dhe të ofertuesve të shërbimeve të programeve, ka punuar edhe në objektivat e tjera. Por, njëkohësisht nuk ka realizuar objektivat, siç janë: nxjerrja e Rregullores për mbrojtjen e të miturve, për të cilët mendoj se Komisioni i Pavarur për Media e ka neglizhuar dhe e ka shtyrë pa kuptim këtë objektiv, ku dihet se në çfarë mase të papërgjegjshme kanë qenë disa medime dhe kanë qenë të prekur të miturit nga programet e këtyre medimeve.

Por, është mirë që, më në fund, në vitin 2009, Komisioni të Pavarur për Media e ka aprovuar këtë rregullore. Mendoj se me gjithë përpjekjet e Komisionit të Pavarur për Media për hartimin e strategjisë së digjitalizimit në Kosovë, edhe pse këtu para nesh, në këtë raport na kanë sjellë edhe procesverbale nga takimi mbi strategjinë e rilicencimit dhe digjitalizimit, që kanë qenë shumë të panevojshme, Komisioni ende është larg hartimit të një strategjie të digjitalizimit për të qenë në hap me vendet e rajonit, kur dihet se në vitin 2012, në Bashkimin Evropian do të realizohet kjo objektivë apo në vitin 2015 në shtetet e rajonit.

Mendoj se kjo është një sfidë e rëndësishme edhe për Këshillin e Pavarur për Media, edhe për institucionet të cilat merren me këtë fushë. Prandaj, mendoj se duhet punuar edhe Kuvendi, edhe institucionet, edhe Këshilli i Pavarur për Media, që sa më shpejt ta realizojë këtë strategji për ta realizuar këtë objektivë.

Duhet kuptuar se Komisioni i Pavarur për Media ka pasur edhe pengesa të natyrave të ndryshme, si të asaj buxhetore dhe për shkak të buxhetit të saj kanë ikur shumë ekspertë nga ky komision, apo të natyrave tjera të plotësimit të Këshillit të Komisionit, por besoj se tani Ligji i Komisionit të Pavarur për Media është në amendamentim dhe edhe kjo pengesë do të tejkalohet. Andaj, mendoj se edhe aspekti ligjor do të rregullohet në mënyrë që Komisioni i Pavarur për Media të arrijë objektivat të cilat i ka para veti.

Grupi Parlamentar i PDK-së e përkrah raportin me rekomandimet e komisionit. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Anita Morina Saraçi.

ANITA MORINA SARAÇI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka shqyrtuar Raportin e Komisionit të Pavarur për Media. Ne mendojmë se ky raport nuk është i strukturuar në formë të raportit, është shumë voluminoz. Në lexim të parë lë përshtypjen e grumbullimit të procesverbaleve nga mbledhjet e takimit të Këshillit të KPM-së. Gjithashtu, përveç takimeve të Këshillit të KPM-së, këtu në fund të procesverbaleve janë paraqitur edhe

takimet e Komisionit ad-hoc për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së, që na rangohen këto takime si mbledhja e parë, e dytë, e tretë, e të tjera. Pastaj, pa nevojë na vijnë edhe shtesat, agjendat ditore të takimeve të KPM-së brenda dhe jashtë vendit, ku ata janë takuar për të punuar strategji të ndryshme.

Përveç këtyre, nuk ka përputhje të rasteve në formën e shkruar dhe në formën tabelare të Divizionit ligjor të shkelja e të drejtave autoriale, pastaj të kërkesa për ndërrim të lokacionit paraqiten rastet kur është lejuar ndërrimi, mirëpo nuk ka informata në lidhje me rastin e Radio “Zëri i Sharrit”, i cili fillimisht ka paraqitur kërkesë për ndërrim të lokacionit dhe më tutje ka ardhur deri me mbyllja e asaj radioje. Edhe pse ky rast tanimë është i mbyllur nga gjykata, unë mendoj se duhet të figurojë në Raportin e Komisionit të Pavarur për Media.

Te obligimet ndaj transmetuesit publik, edhe këtu, edhe pse KPM-ja është e obliguar që me ligj të përcaktojë politikat e qasjes së transmetuesit publik në reklamim, KPM nuk e ka përmbushur këtë obligim me arsyetimin e qëndrueshmërisë financiare. Duke e pasur parasysh këtë, ne mendojmë se nuk qëndron ky arsyetim, sepse për qëndrueshmërinë financiare të RTK-së, me ligj është i obliguar Kuvendi i Kosovës. Edhe sot e kësaj dite, Komisioni i Pavarur për Media ende nuk e ka formuar një rregullore për reklamim në transmetuesin publik.

Gjithashtu, te nxjerrja e Rregullores për mbrojtjen e të miturve, kjo ka qenë si objektive e paraparë në vitin 2007, është mirë që, më në fund, në vitin 2009 kjo Rregullore ka hyrë në fuqi, mirëpo ne i rekomandojmë KPM-së që të ketë një monitorim, që të ketë qasje më tepër në monitorimin e kësaj rregulloreje të televizionet tona pasi që, si duket, edhe në fillim nuk është duke u zbatuar në tërësi ashtu siç duhet.

Me gjithë këto vërejtje, vlen të theksohet se me zgjedhjen e anëtarëve të ri të Komisionit të Pavarur për Media ka ndryshuar dhe po ndryshon pozitivisht mënyra e organizimit të këtij komisioni, gjithashtu edhe po bëhet një punë shumë më e madhe në përmbushjen e objektivave për vitin 2008 dhe tash në vazhdim 2009. Kjo mund të vërehet edhe nga raporti, nëse bëjmë një krahasim të raportit të vitit 2007 me raportin e vitit 2008. Ne në parim e mbështesim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të AAK-së, deputeti Ahmet Isufi e ka kërkuar fjalën.

(Reagime nga salla)

Mirë, Donika Kadaj- Bujupi, atëherë. Regjia, fjalën deputetes Donika Kadaj-Bujpi!

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Ju faleminderit!

Realisht, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka përfillë konkluzionet e komisionit funksional, të cilat besojmë që duhet të inkorporohen, sidomos çështja e “Radio Sharit”. Në përgjithësi mendojmë se liria e medias në Kosovë është rrezikuar dukshëm. Ndërhyrjet politike po e cenojnë integritetin e medias dhe të gazetarëve.

Kohëve të fundit ne i kemi marrë edhe në kutitë tona, të nderuar kolegë deputetë, një mori materialesh që flasin për reagime të shumta nga ana e institucioneve ndërkombëtare dhe vendore, relevante...

KRYETARI: Në temë, në temë, raportin merre...

DONIKA KADAJ- BUJUPI: Në temë jam, në temë jam, mos më ndërhyjë të lutem!

KRYETARI: Të lutem, në temë, se të ndërpritet fjala.

DONIKA KADAJ- BUJUPI... po flasim për lirinë e medias në Kosovë, e cila është dukshëm, dukshëm do të thotë e rrezikuar. Influenca dhe presioni politik shumë herë po bën që të kemi ndërhyrje dhe keqpërdorim të etikës dhe të parimeve të gazetarisë. Pikërisht kjo është punë e KPM-së, do të thotë duhet që në një formë të rregullohet përmbajtja e medias në parimet dhe etikën gazetareske, gjë që nuk po ndodhë në Kosovë. Prandaj, konsiderojmë që ky është një obligim me të cilin KPM-ja krejtësisht ka dështuar dhe konsiderojmë që në raportet tjera do të fokusohet shumë më tepër në atë se çka ka bërë në realizimin e objektivit kryesor të një rregullatori të medias, që është përmbajtja në parimet dhe etikën gazetareske.

Prandaj, konsiderojmë që përveç përpjekjeve të cilat i kanë bërë, nuk janë parë rezultate konkrete dhe me këtë rast ne nuk do ta miratojmë. Do të votojmë kundër si Grup Parlamentar. Ju faleminderit shumë.

KRYETARI: Radha është për Grupin Parlamentar të AKR-së. Kush do ta marrë fjalën, Njomëza Emini apo... Esat, dëshiron ta marrësh fjalën përsëri? Esat Brajshori e ka fjalën.

ESAT BRAJSHORI: Asnjë gjë, zoti Kryetar, nuk kam të shtoj nga ajo që e thashë më herët, vetëm se edhe atëherë deklarova se fjala ime ishte edhe në emër të Grupit Parlamentar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Grupi Parlamentar të LDD-së, Synevere Rysha është lajmëruar. A e do dikush tjetër fjalën?

SYNAVERE RYSHA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Do të mundohem që në mënyrë të përmbledhur t'i paraqes pikëpamjet e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë për raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2008.

Duke e parë raportin ndërmjet asaj se çka është paraqitur dhe si është strukturuar ky raport, si dhe a është përmbushur objektivi që ka synuar KPM-ja për vitin 2008, ajo që është planifikuar krahas asaj që është realizuar.

Që në fillim vërehet se raportit i mungon struktura dhe kriteret sipas të cilave është dashur të hartohet. Nuk është realizuar ajo që ka qenë e paraparë të përmbushet në masën e kërkuar përballë rrethanave dhe kërkesave dhe asaj që parasheh ligji. Sipas këtij raporti, KPM-ja nuk ka arritur t'i përmbushë objektivat e veta që i ka paraparë sipas planit për vitin 2008. Kjo, nga fakti se nuk ka nxjerrë Rregulloren për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme programore, mandej nuk ka arritur ta hartojë strategjinë për transmetuesit kabllorë, nuk ka hartuar politika të qarta për stafin, sidomos për ata të cilët ka investuar me specializim, që pas përfundimit të specializimeve për një kohë të caktuar t'i shërbejnë Komisionit të Pavarur për Media si kuadro.

Monitorimi i pajtueshmërisë me rregulloren, me rregullën për reklamim, monitorimet dhe analizat e përmbajtjeve programore, monitorimet e operatorëve kabllorë dhe të ofruesve të shërbimeve kanë qenë një pjesë e rëndësishme që është dashur të jenë pjesë e monitorimit, mirëpo nuk i është kushtuar hapësirë e mjaftueshme dhe e nevojshme në raport, por nuk është bërë mjaft rreth këtij monitorimi të këtyre çështjeve.

Kemi rastin kur operatorët kabllorë shesin rrjetin e tyre operatorit tjetër kabllor. Sa është kjo e ligjshme, mbase edhe ata vetë e dinë. Mirëpo, në këtë drejtim nuk është ndërmarrë asgjë fare. Edhe më tej vazhdon një mos koordinim i punëve ndërmjet KPM-së dhe ART-së në menaxhimin e spektrit të frekuencave. Gjithashtu, vërehen edhe lëshime të tjera të cilat KPM-ja i ka paraqitur në raportin e vet.

Çështjet financiare apo raporti financiar është paraqitur në një mënyrë shumë të përmbledhur që na jep. Kemi pasur vështirësi për t'i identifikuar kërkesat dhe nevojat e KPM-së për vitin 2008 dhe nuk e kemi pasur të qartë edhe pse ata vazhdimisht janë ankuar në mungesë të buxhetit, ka qenë e pamundur të dihet se KPM-ja a ka pasur buxhet të mjaftueshëm për vitin 2008 për të realizuar objektivat e veta. Sido që të jetë, këto ishin disa nga vërejtjet që ne si Grup Parlamentar na detyrojnë që mos ta votojmë këtë raport. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Para se t'ua jap shefave të radhës fjalën, kërkoj nga shefat e grupeve parlamentare që, kur ata nuk e marrin fjalën, le ta adresojnë se cili deputet do të flasë në emër të grupit. Unë nuk mund ta di se cili në listën e lajmërimeve do të flasë në emër të Grupit. Prandaj, do të duhej, thjeshtë, shefat e grupeve t'i autorizojnë dhe të na bien letrën këtu, që ne ta dimë paraprakisht se cili deputet, i cilit grup parlamentar do të flasë në emër të grupit. Edhe anëtarët e komisionit është mirë të flasin në emër të komisionit, jo edhe në emër të grupit parlamentar. Vazhdojmë. Në emër të Grupit Parlamentar "7+", Shpresa Murati e ka fjalën.

ŠPRESA MURATI: Hvala, predsedniče!

Pozdrav svima!

Kada je u pitanju Izveštaj Nezavisne komisije za medije za 2008. godinu, na samom početku možemo reći da je kvalitetniji i sadržajniji od izveštaja za 2007. godini, naravno nakon dodatno dostavljenih odgovora i objašnjenja od strane Nezavisne komisije za medije.

Nekompletan savet Nezavisne komisije za medije od avgusta do decembra 2008.godine, imao je 3 člana od 7 koliko bi trebao da ima, što je naravno uticalo na rad Nezavisne komisije za medije. Jedan od ciljeva za 2008. godinu, bio je izdavanje dugoročnih licenci za emitere, gde kao peticiji pocesa za dugoročno licenciranje navedeno kreiranje nacionalnog emitera na jeziku manjina, koji će pokrivati čitavu teritoriju Kosova.

U izveštaju Nezavisna Komisija za medije navodi svoje napore kako bi ispunila ustavnu obavezu kada je u pitanju otvaranje kanala na srpskom jeziku, koji će pokrivati čitavu teritoriju Kosova. Odmah nakon toga, navodi da je Nezavisna komisija za medije za to otvorila javnu diskusiju kako bi pronašla najbolji i najadekvatniji način za otvaranje nacionalnog kanala na jeiku zajednica, kojoj su prisustvovali predstavnici vlade, nacionalnih i lokalnih medija, predstavnici manjina i međunarodnih institucija na Kosovu, asocijacije srpskih medija Kosova, predstavnici Fonda za humanitarno pravo i tako dalje.

Tu postojе neke nejasnoće kada je u pitanju s јedne strane otvaranje kanala na srpskom јeziku, a s druge strane kanala za zajednice. Ipak cenimo nastojanje Nezavisne komisije za medije za otvaranje kanala za zajedice.

U izveštaju se takodje navode i problemi sa tačkama emitovanja Goleš i Cvilen, tačke koje ne koriste kosovski emiteri. Tačku Goleš koristi KFOR, a korišćenje ove tačke bi radio i TV emiterima pružilo mogućnost pokrivanja 12% više teritorije Kosova, što bi rešilo pitanje pokrivanja RTK signalom kao što je i одredjeno zakonom.

Skupština Kosova, kao osnovač RTK, treba da u saglasnosti sa KFOR-om omogući korišćenje ove tačke za emitovanje i obezbediti sredstva za ulaganje u infrastrukturu na Golešu sa ciljem pokrivanja TV signalom teritorije gde pretežno žive zajednice i napokon se taj problem reši.

Usvajanje Uredbe o zaštiti dece i maloletnika od šetnog programskog sadržaja, cilj koji je одredjen za 2008. godinu, realizovan je negde maja ove godine. Date su takodje i dodatna objašnjenja u vezi rada odeljenja za nadzor koje je tokom 2008.godine, izvršilo 170 nadzora elektronskih i kablovskih medija, da li deli u skladu sa uslovima svojih licenci i poštovanja prava autora i poštovanja Uredbe o reklamiranju.

Nezavisna komisija za medije preduzela je zakonom одredjene mere protiv svih medija koja ne rade u saglasnoti sa одredjenim pravilima. Parlamentarna grupa „7+“ na samom kraju podržaćе ovaj izveštaj Nezavisne komisije za medije, uz nadu da će manjinski mediji biti na pravi način podržani od strane nje. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili.

MURSELJ HALILJI: Gospodine predsedniče,
Gospodine ministre,
Dame i gospodo poslanici,
Parlamentarna grupa SLS će podržati ovaj izveštaj bez obzira da ovaj izveštaj ima nedostatke na koje su ukazali neki od prethodnih govornika, medjutim samatramo da ti nedostatci nisu odlučujući da se ne da pozitivan glas za ovaj izveštaj. Stoga ćemo mi podržati ovaj izveštaj. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Radha është e deputetëve, fjalën e ka kërkuar deputetja Gjylnaze Syla.

GJYLNAZE SYLA: Ju Faleminderit!
I nderuar zoti Kryetar!
I nderuar ministër Gashi,
Të nderuar deputetë,
Nuk mund të paramendohet një shoqëri e lirë dhe demokratike në botë, e po ashtu edhe në Kosovë, pa ekzistimin e mediave të lira dhe të pavarura. Prandaj, edhe rregullimi i sistemit medial në Kosovë ka rëndësi të madhe. Në këtë kontekst, shqyrtimi i Raportit të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2008, është një tregues i rëndësishëm që flet për funksionimin dhe gjendjen e sistemit të tregut të mediave në Kosovë.

Raporti kryesisht është bazuar në Kushtetutë dhe në ligj, por kërkesat sipas ligjit, gjegjësisht të nenit 3.8 janë se raporti duhet t'i kalohet Kuvendit dy muaj pas çdo viti

kalendari dhe tani jemi në gjysmën e vitit, do të thotë jemi në fund të qershorit, jemi katër muaj më pas. Prandaj, kërkesa ime e parë është përmbushja e kërkesës ligjore në të ardhmen, në vitin e ardhshëm, që raportimi të bëhet me kohë, por edhe shqyrtimi në Kuvend, gjithashtu.

Kërkesa tjetër ligjore e cila përcakton se çfarë duhet t'i raportojë Komisioni i Pavarur i Mediave, është përcaktimi dhe zbatimi i politikave të transmetimit, dhënia e licencave, ankesat, sanksionet, aktivitetet financiare dhe objektivat për vitin vijues.

Tash, sipas raportit i shohim 5 objektiva. Nga këto objektiva, shumica prej tyre janë të plotësuara vetëm pjesërisht. Unë do t'i veçoj disa nga ato të cilat mendoj se kanë një ndikim të madh në funksionimin ose rregullimin e sistemit medial. Një çështje që ngrit dilemë të madhe këtu, është se në raport theksohet se është bërë, se komisioni funksional ka bërë, pra, licencimin e operatorëve. Mirëpo, nga ana tjetër, disa nga operatorët e licencuar kanë shitur jetën e tyre, në këtë mënyrë edhe licencën. Pra, duhet të shtrohet pyetja se a është e ligjshme që të shitet licenca e një operatori të licencuar një operatori tjetër, po ashtu të licencuar.

Po ashtu, dëshiroj të shpreh brengosjen sidomos për mungesën e miratimit të Rregullores për mbrojtjen e fëmijëve dhe të të miturve nga përmbajtja e dëmshme programore, e cila duhej të ishte bërë në vitin 2008. Disa të arritura gjithashtu dëshiroj t'i përmendi. Një, janë gjobitjet e dy operatorëve kabllorik, të cilat kanë sjellë diku 20.000 euro.

Sa i përket hartimit të strategjisë përgatitore, që është për transmetimet digjitale, ajo gjithashtu është e pjesërisht. Sipas mendimit tim, kjo është dashur të punohet ndryshe, së pari të bëhen politikat, pastaj strategjia dhe plani i veprimit. Po ashtu, për rilicencimin afatgjatë të subjekteve transmetuese, është paramenduar të bëhet licencimi i atyre të ekzistues dhe të reja, por për vitin 2008 kjo objektivë nuk është plotësuar.

Mekanizmat e parapara sipas ligjit, pra Këshilli i KPM-së dhe Bordi i ankesave, nuk kanë funksionuar të kompletuar në vitin 2008. Nuk është e qartë se si do të bëhet implementimi i pjesës së pakos së Ahtisarit, e cila ka të bëjë me krijimin e një kanali televiziv të pavarur në gjuhën serbe. Thuhet se është në diskutim, por nuk ka ndonjë zgjidhje se si do të zbatohet këtu.

Në fund, dëshiroj të ngrej edhe një çështje shumë të rëndësishme për transmetuesin publik - Radiotelevizionin e Kosovës, sepse nuk ka dhënë KPM-ja rregullat me anë të të cilave do të bëhej kufizimi i reklamave për arsye se, edhe pse ekziston marrëveshja në mes të KEK-ut dhe RTK-së se do të vazhdojë financimi i RTK-së deri në nëntor të vitit 2008, po ashtu mungojnë të dhënat për sponzorimin dhe reklamat për transmetuesit e tjerë.

Është e qartë nga raporti se është i nevojshëm ndryshimi i Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media. Në parim, nuk e përkrahim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është për deputeten Myzeje Selmanaj, le të përgatitet Hajdin Abazi.

MYZEJENE SELMANAJ: Ju faleminderit, kryetar!

Përsëritet për ministrin dhe të gjithë deputetët që janë prezent këtu!

Duke u nisur nga rekomandimet e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media të cilat obligojnë që KPM të ketë raport në bazë të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetim, unë kisha për të thënë se konkluzionet e para të cilat i ka vendosur Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale, ku të gjitha janë 12, pika e 12-të, më e keqja është çfarë ka qenë koordinimi me ART-në në menaxhimin... Konkluzioni i Komisionit ka qenë në spektrin frekuencor, unë mund të them brezin frekuencor, për të cilat edhe ne si Komision e kemi pasur një strategji të tillë nga ART-ja, që nuk është dashtë të jetë, se strategjitë për brezin frekuencor i bën Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit.

Mund të them se ky Raport i KPM-së, në bazë të të dhënave që janë raportuar këtu dhe në bazë të objektivave të përcaktuara për vitin 2008 dhe realizimin e tyre, mund të them se është deri diku i mirë për arsye se hartimi, që është si objektiv i këtij Këshilli të Pavarur për Media, hartimi i strategjisë për planin frekuencor digjital të Kosovës është shumë i rëndësishëm atëherë kur Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit apo Qeveria e Kosovës të jetë e gjithë Kosova anëtare e ITU-së, ku shumë qartë ne i kemi edhe mangësitë e tjera shkaku i mos anëtarësimit të Kosovës në këtë organizatë, kur nuk kemi edhe një kod telefonik, kështu që mund të them se Qeveria në raport që ka paraqitur Këshilli i Pavarur për Media, ku përcakton punën duke filluar nga krijimi i grupeve dhe strategjia për kalimin nga sistemi analog në atë digjital me ndihmën e madhe të Buxhetit të Kosovës, ku i është dhënë një ndihmë shumë e madhe, gjë që është dashur për arsye se Kosova do të mbetke pa përfaqësim në sistemin digjital, me gjithë këto objektiva që i ka paraqitur për vitin 2008 dhe vitin 2009. Mund të them shumë sinqerisht se do të jetë shumë e vështirë të arrihen të gjithë këto objektiva të Këshillit të Pavarur për Media, mirëpo me shpresë që në të ardhmen do të jetë më i mirë ky raport, në tërësi Grupi Parlamentar i AKR-së e përkrah. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi, le të përgatitet Naser Rugova.

HAJDIN ABAZI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër, zoti Gashi,

Raporti i KPM-së kësaj radhe me siguri gjithnjë e shohim se është shumë më i avancuar se sa i vitit 2007. Që kur është kompletuar KPM-ja me stafin vendor, shihet se ka një funksionalitet më të madh dhe më efikas. Në kuadër të Komisionit për Media ne i kemi përcjellë edhe rekomandimet tona se ku ka dobësi KPM-ja dhe ku duhet të përmirësohet. Kështu që jam plotësisht dakord me ato, por unë desha të ndalem kryesisht në një pikë të raportit.

Në faqen 12 kemi një njoftim shumë të shkurtër, shumë abstrakt dhe pa kurrfarë përmbajtjeje, ku tregon se Radio Sharri është shpallur si stacion ilegal, pa dhënë sqarime se përse. Për fat të keq, ky është i njëjti rast sikurse që ka qenë gjatë vitit 2007 rasti me TV Mitrovicën, kur është mbyllur në një kohë shumë të ndjeshme, kur në atë periudhë ka qenë në atë pjesë vetëm TV Mitrovica në gjuhën shqipe që ka emituar programet e veta. E njëjta gjë tani ka ndodhur edhe me Radio Sharrin. Kushdo që pak e njeh terrenin në atë anë, e di se me malësinë e Sharrit e vetmja radio lokale që është dëgjuar, që i ka ngritur problemet lokale, preokupimet e asaj ane, ka qenë Radio Sharri. Ne në komision e kemi diskutuar edhe këtë problem dhe aty kemi konstatuar se edhe KPM-ja ka bërë lëshimet e veta që në licencimin, kur i ka dhënë frekuencat Radio Sharrit, se ka pasur vonesa me përgjigjet ndaj Radio Sharrit që i ka bërë kërkesat për zhvendosje, gjë që faktikisht do ta

kishte bllokuar ndoshta edhe për muaj të tërë që të mos funksiononte dhe, në fund, edhe e ka mbyllur fare.

Dhe, çka është më interesantja, në vazhdim vetëm edhe një pikë më poshtë shohim se TV Mitrovica i është dhënë përsëri të njëjtit person, është shpall tani si OJQ dhe ajo funksionon. Unë e kuptoj se kjo strukturë e tashme e KPM-së nuk i ka krijuar këto probleme, i ka të trashëguara, mirëpo është shumë simptomatike se në njërën anë në veri të Mitrovicës, në tjetrën anë në buzë të Brezovicës mbyllen dy emetues që janë në gjuhën shqipe dhe nuk është gjetur një mundësi që të gjendet një kompromis pasi që është kërkuar vetëm zhvendosja e lokacionit dhe asgjë tjetër nuk është ndryshuar.

Ne i kemi kërkuar ose, më saktë, i kemi rekomanduar KPM-së dhe ata janë zotuar se do të përpiqen ta gjejnë një zgjidhje dhe t'ia bëjnë të mundur Radio Sharrit që të funksionojë dhe ajo pjesë e popullatës të ketë mundësi që të informohet edhe në gjuhën shqipe në ato anë se çfarë ndodh në komunën e tyre dhe më gjerë.

Kështu që, unë shpresoj se vërtet KPM-ja do të jetë fleksibile dhe do ta realizojë këtë. Me këtë kusht unë do ta përkrah këtë raport, përndryshe nuk është në interes të krijimit të territ informativ në pjesë të caktuara të Kosovës, që do të duhej të ishte politika e KPM-së, por është e kundërta.

Dhe, krejt në fund, do të them se ne duhet ta kemi të qartë edhe një problem. Shumë qytetarë paguajnë atë pjesën në kuadër të KEK-ut sa i përket RTK-së, kurse nuk kanë mundësi që ta ndjekin emisionin e RTK-së. Prandaj, këtu do të ishte mirë të gjendet ndonjë zgjidhje ose të jepet mundësia që Kuvendi të investojë dhe RTK-ja ta mbulojë gjithë territorin e Kosovës dhe të kenë mundësi të gjithë qytetarët, të gjitha etnive në Kosovë të mund të informohen. Duke shpresuar, pra, që do të gjendet një zgjidhje e lakmueshme që Radio Sharri të aktivizohet, me këtë kusht unë do ta përkrah dhe do ta votoj raportin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kisha kërkuar që vërtet të kursehem nga fjalët e mëdha, dritë informative në Kosovë kur s'ka pasur më shumë, edhe pse ka mangësi. Fjalën e ka deputeti Naser Rugova, le të përgatitet Adem Salihaj.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë insistoј që raportet e tilla të komisioneve të pavarura, të agjencioneve të pavarura apo të bordeve që i voton ky Parlament, ta kenë një performancë të caktuar të përpilimit dhe të hartimit të raporteve, ashtu si i takon organit më të lartë legjislativ të vendit.

Raporti nuk është strukturuar në formën që e ka paraparë vetë KPM-ja në Planin vjetor të vitit 2008, thotë një nga konkluzionet e komisionit funksional. Mirëpo, nëse shikohet dhe analizohet në tërësi ky raport, shihet se në raport nuk duhet të përfshihen agjendat ditore, takimet dhe work shopet që i mban Komisioni i Pavarur i Mediave apo stafi i tij, por duhet të raportohet për punën dhe objektivat dhe për substancën e aktivitetit të këtij komisioni tejet të rëndësishëm për rregullimin e fushës së mediave në vendin tonë.

Është në përsëritje e sipër nga po thuaj se 80% të agjencioneve dhe mekanizmave të pavarur që i raportojnë Kuvendit të Republikës së Kosovës, mangësia në hartimin e raportit financiar. Edhe këtë raport e përcjellin mangësi të caktuar.

Unë insistoј që ky Kuvend do të duheј ta hartonte një kornizë, një performancë të caktuar dhe mbase kolegët nga Komisioni për Buxhet dhe Financa do të ndihmonin këtu, edhe ekspertët të tjerë, që në një kornizë të caktuar të raportohet, do të thotë, për shpenzimet, të hyrat dhe të dalat e secilit institucion që e ka marrë votën e këtij Kuvendi.

Unë do ta përmbylli edhe me një sugjerim që KPM-ja sa më parë, do të thotë, ta miratoјë rregulloren për subjektet transmetuese për mbrojtjen e të miturve nga përmbajtjet e programeve të dëmshme, sepse jemi shoqëri në tranzicion dhe besoj që ajo rregullore është hartuar, por duhet të filloјë implementimi dhe monitorimi i transmetuesve publikë.

Dua bashkëngjitëm me apelin e kolegëve të tjerë që Radio “Zëri i Sharrit” thjeshtë të gjendet një kompromis dhe të filloјë me punën, sikurse është bërë edhe për operatorë të tjerë, sepse vërtet ka nevojë për atë pjesë të Kosovës dhe insistoј që KPM-ja të japë impute të caktuara edhe për atë 11% ku transmetuesi i vetëm publik, RTK-ja, nuk mund të shikohet dhe dëgjohet nga qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Është mirë të lajmëroheni me kohë, jo pas kohe. Fjala është për deputetin Adem Salihaj, le të përgatitet Hydajet Hyseni.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zot Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti ministër,

U tha nga shumë diskutues deri tash, ka rrezik t’i përsëritim nga pak gjërat. Raporti i Komisionit të Pavarur të Mediave ka një përmirësim, ka një avancim krahasuar me raportin e kaluar, por meqë edhe stafi ka ndryshuar, atëherë kjo është deri diku e kuptueshme. Megjithatë, u tha edhe nga shumë të tjerë, ky raport ka gjëra plotësisht të panevojshme, ka përshkrime të punëve ditore, e tjera, që nuk janë esenca e një raporti që do të duheј t’i jepeј Kuvendit të Kosovës.

Ne do të duheј të angazhoheshim në vazhdimësi që Komisioni i Pavarur për Media të veprojë në përputhje të plotë me ligjin dhe të jetë sa më shumë jashtë ndikimeve politike. Në të kaluarën, kjo nuk ka ndodhur. Njëherë ka qenë një komisioner për media, i cili ka pasur një politikë shumë të gabueshme ndaj shumë mediave të Kosovës. Pastaj Komisioni për Media po ashtu në disa segmente ka vazhduar këtë politikë dhe mendoј që edhe sot Komisioni i Pavarur i Mediave nuk është plotësisht jashtë ndikimeve politike.

Ne kemi pasur rastin e TV Mitrovicës, i cili është bllokuar dhe është mbyllur për një kohë të gjatë dhe pa një motiv të vërtetë ligjor. Mendojmë që motivet kanë qenë politike dhe i kanë shkaktuar një dëm informimit të popullatës së regjionit të Mitrovicës, një dëm të themi edhe në aspektin e informimit, edhe në aspekte politike.

Mendoј që e njëјta gjë po përsëritet me Radion “Zëri i Sharrit”. Radio “Zëri i Sharrit” ka qenë një medium ndoshta i vetëm që ka plasuar informata në regjionin e Hanit të Elezit, por që ka qenë i themeluar dhe i regjistruar për të vepruar aty ku është tash dhe aty ku i është marrë licenca dhe janë konfiskuar të gjitha pajisjet. Pra, këtu ka ndodhur diçka e çuditshme që s’ka ndodhur me media të tjera dhe mendoј se nuk qëndrojnë arsyet ligjore për të cilat edhe është mbyllur, edhe është konfiskuar teknika e tij.

Mendoj se edhe këtu ka ndikime politike, ka ndikime ndoshta të zyrtarëve të lartë komunalë, ndoshta ka ndikime të njerëzve që kanë ndikim politik në Radio Kaçanikun e tjera, që është si pasojë e luftës për konkurrencë. Po, mendoj se Komisioni i Pavarur i Mediave do të duhej të ishte vërtet i pavarur dhe të gjente mënyra që në përputhje me ligjin t'ia mundësojë dhe t'ia vazhdojë punën edhe këtij mediumi, i cili për komunën e Kaçanikut vërtet ka pasur një rol shumë të rëndësishëm në aspektet e informimit.

Mendoj se Komisioni për Media, por edhe Komisioni i ynë i Parlamentit e ka shqyrtuar këtë çështje, por mendoj se çështja ka mbetur e papërfunduar dhe mendoj që duhet të gjendet një mënyrë e zgjidhjes edhe të këtij problemi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Hydajet Hyseni dhe diskutuesi i fundit, Bahri Hyseni.

HYDAJET HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja dhe zotërinj deputetë,

I nderuar ministër,

Unë e mbështes kërkesën e Kryetarit të Kuvendit që vërtet edhe lajmërimet për diskutim të bëhen me kohë dhe nuk do ta merrja fjalën në këtë mënyrë, po të mos ishte një fenomen, i cili mendoj ia vlen ta theksojmë, me shpresë që do ta zgjidhim në të ardhmen. Prandaj, do të ndalem vetëm në një çështje të natyrës parimore dhe në një vërejtje konkrete lidhur me raportin.

Çështja e parë ka të bëjë me raportin ndaj raporteve të organeve të pavarura. Zonja dhe zotërinj, e kemi të ngatërruar dhe të paqartë këtë çështje. Është krijuar njëfarë përshtypjeje sikur ne duhet tash ta diskutojmë vetëm për raportet a janë shkruar mirë, a s'janë shkruar mirë, por jo për atë për çka janë krijuar organet e pavarura. Unë s'dua të zgjatem në këtë çështje, por vetëm tërheq vërejtjen se po krijohet një vakum i rrezikshëm, të cilin këto organe të pavarura mund të konsiderojnë në një farë mënyre se janë krejtësisht të pavarura dhe nga shoqëria, edhe nga ligji e tjera dhe natyrisht që kjo nuk është kështu dhe mund të jetë e rrezikshme.

E dyta, nuk kemi ndërtuar raportin e duhur të pavarësisë dhe të llogaridhënies shoqërore. Çështja për të cilën unë desha të ndalem konkretisht në raportin që është derivim edhe i kësaj, është fakti se janë krijuar shumë instrumente për mbrojtjen e mediave dhe unë i mbështes, jam gazetar dhe s'mund të mos jem në anën e fjalës së lirë dhe të gazetarëve. Po, duhen edhe mekanizma që mbrojnë gazetarët nga keqpërdorimet e mediave, mbrojnë mediat nga keqpërdorimet e lirisë së mediave, mbrojnë shoqërinë, siç tha edhe parafolësi me të drejtë, nga fenomenet që mund të jenë të rrezikshme shoqërisht dhe derivohen ndonjëherë nga mediat.

Raporti, për fat të keq, nuk e ka këtë dimension. Po tërheq vërejtjen vetëm që ky Bord i ankesave është mbledhur, thotë, vetëm një herë, sepse ka pasur vetëm një ankesë. Çka do të thotë kjo? Pse atëherë duhet të jetë një bord i tillë, sa i kushton Kosovës.

Dhe, tjetra, vërejtjet që janë bërë atje, e keni një kapitull të veçantë për shkeljet e kodit të sjelljes. Janë disa shembuj, unë mund të mos jem sa duhet i informuar, por më duket krejt marginale dhe vërejtjet që ka opinioni, nuk i gjejmë këtu, kurse ky komision përfaqëson shoqërinë nëpërmjet mandatit tonë që të monitorojë dhe t'i adresojë çështjet, defektet e shumta që janë në këtë fushë.

Dhe, nuk e kam ndërmend të ndalem te shembuj konkret, të cilët mund të bëjnë edhe me shumë njerëz që janë këtu, edhe me ua vetë, nuk u vë vesh, nuk i pres dëm gjithkujt. Po, ama tendencat që të goditen vlera të rëndësishë së veçantë shoqërore, siç është gjuha, nga media në mënyrë sistematike dhe me prapavi shumë të dyshimtë, po edhe të mos jenë dyshimtë, shumë destruktive, në mënyrë të pashembullt destruktive, që si kemi pasur as në periudhat e tmerrshme e të tjera, nuk mund të mbeten pa u adresuar. Dhe, dua të tërheq vërejtjen që përgjegjësia nuk është vetëm te ata që i lejojnë këto fenomene që i bëjnë, se ata edhe mund të kenë interesin, por pse tolerohen, pse toleron komisioni dhe ata që janë përgjegjës për të. Mendoj që fenomeneve të tilla duhet thënë stop. Lirinë e dëmtojnë më së shumti ata që e keqpërdorin atë. Ju faleminderit, zot Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Edhe pse jam shumë dakord, realisht, për ta mbrojtur gjuhën duhet të kemi ligj dhe ligji nuk kemi, prandaj mendoj që nuk është obligim i Këshillit të Pavarur të Mediave.

Fjalën e ka, i fundit, Bahri Hyseni.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nuk e kam ndërmend të bisedoj për raportin. Mirëpo, pasi që ky Kuvend duhet t'i aprovojë rekomandimet e komisionit, atëherë para se t'i votojmë këto rekomandime, do të kisha dash që rekomandimin e fundit, ku shkruhet: "Komisioni ka shqyrtuar edhe rastin e mbylljes së Radio Sharrit nga Komisioni i Pavarur për Media dhe ka konstatuar se ka pasur shkelje nga të dyja palët".

Unë konsideroj që edhe nëse e votojmë këtë rekomandim...

KRYETARI: Jo, nuk është rekomandim, më falë, ai është arsyetim, është vetëm një rekomandim.

BAHRI HYSENI: ...të lutem, Kryetar, unë mendoj që krejt arsyeja e nxjerrjes së këtij rekomandimi është konstatimi. Prandaj, është mirë që të gjithë deputetët janë pajtuar se me rastin e mbylljes së Radio Sharrit ka pasur shkelje procedurale dhe nuk është e nevojshme që ne vetëm të konstatojmë shkeljet procedurale, po të kërkojmë nga Komisioni i Mediave që sa më parë ta shqyrtojë edhe njëherë rastin e Radio Sharrit dhe të shfuqizojë procedurën që e ka marrë për mbyllje të Radio Sharrit. Përndryshe, nëse ne nuk e votojmë edhe këtë rekomandim, unë nuk e di se çka po votojmë rekomandimet e komisionit, çka është rekomandim i komisionit, nëse nuk e votojmë, së paku, që të shqyrtohet edhe njëherë procedura rreth Radio Sharrit. Faleminderit!

KRYETARI: I nderuar deputet dhe të nderuar të gjithë deputetët, Komisioni ka rekomanduar, e ka vetëm një rekomandim, dhe unë po e lexoj. "I rekomandohet Kuvendit të Kosovës që raporti vjetor i Komisionit të Pavarur për Media 2008 të miratohet me vërejtjet e dhëna në arsyetim". Realisht, kjo që po kërkon ti, deputet, nuk është në rekomandim. Kjo do të duhej të ishte në rekomandim shumë qartë. Prandaj, mendoj që është çështje e komisionit dhe kisha kërkuar që komisioni ta formulojë një qëndrim më të saktë në lidhje me Radio Sharrin, se për ndryshe këtu po thotë të dy palët janë fajtorë. Realisht, unë nuk di çka mund të kuptojmë në këtë rast dhe cili do të jetë rekomandimi ynë, si Kuvend. Duhet ta ndërrojmë.

Të nderuar deputetë,

Unë edhe një herë po kërkoj nga ju që kur të diskutojmë, të jemi në rend të ditës edhe në atë për çka vërtet jemi duke diskutuar. Nëse duam të flasim për medien e lirë, atëherë

duhet Komisioni për Media, le ta bëjë një raport me rekomandime dhe mbi bazën e atij raporti me rekomandime ne edhe mund të debatojmë, se sigurisht të gjithë kemi çka të themi. Prandaj, ta respektojmë një rend që është i përcaktuar. Fjalën po ia jap kryetarit të Komisionit, Esat Brajshori.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Realisht, komisioni tri herë radhazi e ka shqyrtuar këtë raport dhe çështja e cila ka ngelur akoma e pazgjidhur mes Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Radio Sharrit, është e vetmja çështje. Po, komisioni parlamentar nuk ka të drejtë që t'i diktojë Komisionit të Pavarur të Mediave, t'i thotë se ti duhet ta zgjedhësh kështu këtë çështje. Nuk kemi të drejtë ligjore, si komision, por ne e kemi marrë parasysh kërkesën e Radio Sharrit, i kemi ballafaquar palët dhe ky mund të jetë një proces në mes të KPM-së dhe Radio Sharrit deri në zgjidhje. Nëse Komisioni i Pavarur për Media, pra komisioni ynë funksional do të priste derisa sa ata të zgjidhnin këtë çështje, ne nuk do të mund ta sillnim këtë raport fare për debat ndoshta as brenda këtij viti për të diskutuar në Kuvendin e Kosovës.

Në anën tjetër, pavarësisht kësaj që unë nuk desha në fillim ta ngrehë këtë çështje, unë jam për media të lira, nuk diskutohet kjo. Duhet të shihet çështja e Sharrit dhe Komisioni i Pavarur për Media dhe drejtoresha e Komisionit, nënkryetari zoti Daut Demaku, në ballafaqim kanë marrë përsipër të rishikojnë këtë çështje e mos ta lënë të zvarritet deri në fund të viti, të mos mund të debatojmë për një raport. Jam i bindur që ata do ta rishikojnë edhe tani kur do të bëhet rilicencimi i medieve, kështu janë deklaruar në Komision. Po ta kishim lënë ne kështu këtë çështje, ndoshta s'do të vinte, po them edhe njëherë, brenda këtij viti raporti far, për të pritur se si do të përfundojë puna e Komisionit të Pavarur të Mediave me Radio Sharrin. Radio Sharri është e vetmja çështje që ka mbetur si pezull, do me thanë, në këtë raport.

Tani, ne kemi edhe dokumente tjera që na kanë ardhur, sepse kjo radio ka bërë një pati në Gjykatën Supreme të Kosovës në lidhje me rastin dhe kjo gjykatë ia ka refuzuar padinë. Pa hyrë në këtë çështje, që unë në fillim nuk e përmenda qëllimisht, si komision jemi të interesuar që Komisioni i Pavarur për Media të merret edhe njëherë seriozisht me Radio Sharrin dhe të gjendet një zgjidhje ashtu siç e kanë deklaruar në ballafaqim para komisionit parlamentar. Po të presim deri sa ata të gjejnë një zgjidhje, do të shkojë i gjithë viti pa e sjell raportin e KPM-së në këtë Kuvend, ja kjo është arsyeja. Ne kemi bërë thirrje të miratohet me këtë vërejtje, që çështja e Radio Sharrit duhet të zgjidhet mes KPM-së dhe Radio Sharrit. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Unë mendoj që me fjalën e kryetarit të komisionit e konsiderojmë të mbyllur debatin dhe shkojmë në votim të raportit me rekomandime dhe arsyetime.

Lus deputetë dhe regjinë të përgatiten për votim. Në sall kemi 65 deputetë. Votojmë tash: Konstatoj se me 43 vota "për", 13 "kundër" dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin 2008.

Pika e dhjetë e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë së Pronës dhe të dy anëtarëve të Bordit të kësaj agjencie**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë së Pronës dhe të dy anëtarëve të Bordit të kësaj agjencie dhe i ka rekomanduar që i njëjti të shqyrtohet dhe të miratohet në seancë plenare.

Propozim-vendimi i Qeverisë me dokumentacion dhe rekomandimet e komisionit u janë shpërndarë deputetëve.

Përfaqësues të Qeverisë nuk kemi. Kryetari i komisionit e ka fjalën.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuari zoti ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi, duke u bazuar në përfundimet e Kryesisë së Kuvendit, të datës 27 maj 2009, në mbledhjen e 15 qershorit 2009 shqyrtoi propozimin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, të datës 27 maj 2009, përkitazi me emërimin e kandidatëve të theksuar për pozitën e zëvendës drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive dhe të dy anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Duke pasur parasysh që ky agjencion ka një rëndësi të veçantë dhe duke marrë parasysh që qytetarët e Kosovës po presin me vite të tëra për shkak të problemeve që i kanë me patundshmëritë në Kosovë dhe po thuaj një numër i madh i problemeve kanë mbetur ende pa u zgjidhur në mungesë të anëtarëve të këtij Komisioni dhe Sekretarisë Ekzekutive, duke pasur parasysh që është i vetmi agjencion me përjashtim edhe të disa agjencioneve që kanë ende ndërkombëtarë dhe nuk janë plotësisht në duar të vendorëve, ne në komision e kemi shqyrtuar me vëmendje Propozimin që ka ardhur nga Zyra e Kryeministrit, duke u bazuar në ligjin që është aktual dhe që jep mundësinë që Kryeministri i vendit të propozojë kandidatët e përmendur për të udhëhequr Sekretarinë Ekzekutive dhe dy anëtarët e Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Vlen të theksohet se për propozimin ka pasur edhe shqetësime të anëtarëve të komisionit për disa anëtarë, duke menduar se nuk i plotësojnë kriteret e bazuara në ligj. Mirëpo, Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi me shumicë votash i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës që t'i miratojë propozimet e Komisionit, duke marrë parasysh që kandidatët e propozuar për të udhëhequr detyrat e lartpërmendura i plotësojnë kriteret e parapara me ligj. Prandaj, i kërkoj Kuvendit që të pranojë rekomandimin e komisionit dhe të votojë për kandidatët e përmendur.

Komisioni rekomandon Albiona Dumoshin, zëvendës drejtore e Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës, dhe Xhevdet Maqastenën e Aleksander Janiçeviqin, anëtarë të Bordit të Agjencionit Kosovar të Pronës, kurse edhe më tutje do të mbetet kryesues i këtij Agjencioni nga faktori ndërkombëtar dhe dy anëtarë të cilët, natyrisht, i emërojnë nga faktori ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, pajtohesh me kryetarin e Komisionit. Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Lutfi Haziri e ka kërkuar fjalën.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Ministër i nderuar,

Anëtarë të Kuvendit,

Grupi Parlamentar i LDK-së nuk e mbështet propozimin e paraqitur sot për rend të punës. Ne kemi paraqitur disa nga arsyet edhe përmes deputetëve tanë në komisione funksionale, kemi shpresuar që do të përballohet kjo çështje para se të vinte në rend të punës. Arsyet mbeten të njëjta, kështu që unë propozoj, zoti Kryetar, që sot të mos qitet në votim, pas deklarimit të grupeve parlamentare t'i kthehet Qeverisë për rivlerësim kjo çështje, në mënyrë që të vijë sa më shpejt në Parlament dhe të bëhet zgjidhja. Ne nuk kemi mund t'i përballojmë arsyet që i kemi paraqitur, edhe njëherë po them, ne nuk e mbështesim propozimin e Qeverisë dhe po propozojmë t'i rikthehet Qeverisë pa votim sot, t'i rikthehet në rishqyrtim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kemi hyrë në procesin e votimit dhe na shkojmë, ju mos votoni, do të thotë, e drejta është të mos votoni. Megjithatë, kemi hyrë në procedurë dhe ne duhet të ecim më tej.

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës mendon se kandidatët e paraqitur nuk janë profesionalisht të zotët për të kryer punën për të cilën sot duhet Kuvendi të deklarohet dhe ne nuk e mbështesim këtë listë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, e ka fjalën.

IBRAHIM MAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së nuk e përkrah listën e propozuar. Ne i kemi paraqitur edhe vërejtjet dhe shqetësimet tona edhe në Komision, e kemi thanë para disa ditësh në këtë Kuvend që tashmë jemi bindur dhe jemi të vetëdijshëm që kryesisht në mekanizma të tillë delegohen njerëz partiakë, por së paku po kërkojmë që të jenë profesionalë, që të mund t'i kryejnë obligimet të cilat ju ngarkohen. Tri propozimet nga ana e Qeverisë nuk garantojnë që ky agjencion shumë i rëndësishëm në Kosovë do të jetë efikas, sepse ky agjencion është i një natyre të veçantë dhe kërkon profesionalizëm brenda asaj. Grupi i AKR-së nuk i përkrah këto tri propozime. Faleminderit!

KRYETARI: Pasi shpeshherë po duhet të reagoj për një çështje, pasi shpeshherë po thuhet –partiakë, unë mund t'ju them që nuk janë të Partisë Demokratike. Unë nuk e kam problemin pse në Kuvend partitë që qeverisin propozojnë - partiakë, që e kanë përgjegjësinë dhe kanë obligim ta qeverisin vendin, po më tepër vërejtja ime do të shkonte pse partitë politike në koalicion nuk dërgojnë në Kuvend njerëz që kanë përgjegjësi dhe duhet ta udhëheqin vendin e tyre. Kjo është vërejtja ime, jo pse janë të partive politike.

Vazhdojmë me radhë. Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Adem Salihaj e ka kërkuar fjalën.

ADEM SALIHAI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i LDD-së nuk e përkrah këtë listë me këto propozime. Ne kemi shprehur qëndrimin tonë edhe në Komision për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe aty kemi votuar kundër këtyre kandidatëve. Mendojmë që asnjëri prej kandidatëve nuk i plotëson kushtet që të jetë në funksionin për të cilën është propozuar. Një kandidat në mënyrë të veçantë s'do duhej në asnjë mënyrë të ishte në këtë organ. Janë arsyet e shumta që ndoshta s'mund t'i themi këtu. Prandaj, ne si Grup Parlamentar, nuk e përkrahim dhe do të votojmë kundër.

KRYETARI: Unë jam konsultuar me ligjin dhe nuk është i kundërligjshëm propozimi. Megjithatë mund të keni të drejtë.

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", Xhezair Murati, e ka fjalën.

DŽEZAIR MURATI: Parlamentarna Grupa „7+“ podržava predlog Komisije za zakonodavstvo, jer je predlog došlo od Kabineta premijera. Mi smo u Komisiji za zakonodavstvo vrlo dugo i vrlo analitički raspravljali o svim kandidatima i preovladalo je većinsko mišljenje da oni ispunjavaju zahteve radi kojih treba da budu birani. Mi podržavamo znači predlog Komisije ili predlog Kabineta premijera. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović e ka kërkuar fjalën.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Parlamentarna Grupa SLS je naravno razmatrala i imala puno razgovora vezano za jedan ovakav organ. To je nama kao predstavnicima Sprske zajednice, Srpskog naroda jako bitno telo. Ima puno nerešenih slučajeva u imovinsko-pravnim odnosima i možemo o tome raspravljati i na jednoj posebnoj sednici. Ja ne bih želeo puno da dužim. Naravno da dolazi od predloga Vlade i mi smo koalicioni partneri i u Vladi, međutim ovoga puta nažalost nismo imali konsultacije vezano za člana iz Srpskih zajednica. Smatram da je bilo potrebno da nas neko pita ili da bar član taj zatraži podršku od nas. Ukoliko se glasa odvojeno, mi ćemo podržati ostala dva kandidata, ukoliko se glasa zajednički, nećemo podržati celu listu. Ali ukoliko budemo glasali odvojeno za posebnog kandidata, ja vas molim da odbratimo pažnju da ne dođemo u situaciji da imamo sukob interesa. Naime, treći kandidat po redu je direktor jednog javnog preduzeća koje bi trebalo da uđe u proces privatizacije, tako da je po meni neprihvatljivo da takva osoba bez obzira na stručne kvalifikacije, bude u jednom ovakvom organu. Molimo vas, da zbog svih ovih stvari da ne bi... Skupštini, u buduću budemo konsultovani bar po tim pitanjima, tako da opet kažem, ukoliko glasamo pojedinačno, pošto vidim da predsednik možda nije razumeo, za sva kandidata podržaćemo prva dva kandidata, trećeg nećemo podržati i pozivamo i Skupštinu da to Hvala!

KRYETARI: E kam kuptuar mirë po... Atëherë, sipas radhës, Bahri Hyseni e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, Bahri, se ti je kryetar i komisionit.

BAHRI HYSENI: Faleminderit, Kryetar!

Unë e kuptoj që deputetët e kanë të drejtën të mos i votojnë njerëzit, natyrisht, sepse ne si komision nuk kemi të drejtën të futemi në biografi, sepse komisioni e shikon vetëm bazën ligjore dhe kandidatët ia propozon Kuvendit që t'i aprovojë.

Mirëpo, po më befason vetëm një fakt. Ne vendimin në komision, e thashë, nuk e kemi marrë unanimisht, siç e marrim në të gjitha propozimet e tjera, do me thanë është rast i veçantë kur jemi ndarë me vota, por megjithatë në komision e kemi pas një shumicë

votash, sepse përndryshe do të ishte më e lehtë edhe për komisionin, edhe për ju, që mos të kishte ardhur propozimi fare këtu, por ne kemi pasur një shumicë votash, e kemi konstatuar bazën ligjore dhe e kemi bërë rekomandimin. Prandaj, nuk do të ishte shumë korrekte që kur komisioni e ka shumicën e votave, më pastaj në Kuvend po del që ne e kemi bërë vetëm 2 – 3 veta në komision. Jo, absolut, ne kemi votuar me shumicë votash me përjashtim të 3 – 4 anëtarëve që nuk e kanë votuar propozimin për të ardhur në Kuvend dhe natyrisht që thashë, kemi pasur shqetësime për biografinë e kandidatëve, por duke marrë parasysh që ne si komision nuk lëshohemi në biografë, atëherë Kuvendi nëse ka diçka për kandidatë, është mirë t'i thotë këtu. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Së pari votojmë për zëvendës drejtorin Albiona Dumoshin, pastaj vazhdojmë votimin tjetër.

Lus deputetë dhe regjinë, të përgatiten për të votuar për zëvendës drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Agjencionit Kosovar të Pronës.

Në sallë kemi 64 deputetë.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 23 vota “për”, 35 vota “kundër” dhe 2 abstenime, nuk miratohet propozimi.

Votojmë për dy të tjerët, të dytë së bashku.

Lus regjinë dhe deputetët, të përgatiten për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 11 vota “për”, 42 “kundër” dhe 4 abstenime, nuk votohet as zëvendës drejtori, as dy anëtarët e Bordit të Agjencionit Kosovar të Pronës.

Pika e fundit e rendit të ditës:

- **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për partneritet publiko – privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre**

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për partneritet publiko – privat dhe koncesionet për sigurimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve dhe procedurat për dhënien e tyre, nuk di çfarë gjuhe është kjo, po kaq shumë përsëritje, lidhëza dhe unë nuk e di pse, Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportet me rekomandime të Komisionit u janë shpërndarë deputetëve. Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Gani Koci, apo raportuesin e komisionit, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Vërtet, në titull edhe Komisioni ka pasur vërejtje, por dua të them shumë hapur dhe shumë publikisht që vërtet ta qojmë në vend atë fjalën transparencë, sepse ndërhyrjet e shumë ekspertëve të huaj dhe të zyrave respektive nganjëherë ndalen edhe të titujt, që s'kanë të bëjnë fare me përmbajtjen këtu, prandaj kemi qenë të detyruar kështu që ta pranojmë edhe këtë titull, që është shumë i gjatë, sepse propozimi ynë ka qenë që të jetë Ligji për koncesionet dhe partneritet privato – publik dhe procedurat, dhe jo të afërimit të shërbimeve, infrastrukturës publike e tjera e tjera, që është i stërzgjatur. Prandaj, nuk kemi mund ta ndryshojmë as titullin.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin dhe kohë më parë i ka ofruar këtij Kuvendi amendamentet e veta, në të cilat amendamente propozuesi, Qeveria, ka pasur disa vërejtje dhe është dashur që t'i rikthehet edhe njëherë Komisionit dhe të veprojë, të amendamendojë mbi bazë të vërejtjeve që ka ardhur nga Qeveria lidhur me disa çështje, sidomos me nenin 12.5 dhe 18.5 dhe Komisioni, bashkë me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, ka ardhur deri te propozimet të cilat i keni sot këtu në Kuvend dhe konsideroj se duhet të miratohen këto amendamente, se është e nevojshme që ta kemi ligjin, se edhe ashtu shumë herë në deklaratimet tona publike po themi nuk e kemi ligjin, nuk e kemi ligjin, prandaj ta bëjmë sot Ligjin për partneritetet privato- publik dhe koncesione.

KRYETARI: Faleminderit!

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara nga komisioni funksional sipas radhës së paraqitur në raport.

Urdhëro, deputetja Myzejene Selamni e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, Kryetar!

Do të flas në emër të komisionit. Të gjithë deputetët brenda komisionit kanë kërkuar që ky projektligj pas përfundimit të punës mirë që e ka bë Komisioni për Buxhet dhe Financa me gjithë anëtarët e vetë edhe me ekspertët, që së paku të kishte kaluar edhe në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë dhe Transport. Një moment, a ka mundësi të dëgjoni kur flas unë, si unë që po ju dëgjoj juve, kur dihet mjaftë mirë se të gjitha infrastrukturat rrugore të telekomunikacionit, të naftës-jellësit kalojnë nëpër komisionin tonë. Faleminderit, Kryetar, për deputetët që janë shumë të mirë në këtë Kuvend!

KRYETARI: Ju lutem, unë po ju lutem për mirësjellje, jo për tjetër send. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1.

Votojmë tash:

Votimi është i pavlefshëm. Regjia, i bie ziles!

(Ndërpritet incizimi)

Tani e kemi numrin e mjaftueshëm të votave. Vazhdojmë votimin.

Përsërisim votimin për amendamentin 1.

Votojmë tash:

Në sallë kemi 63 deputetë.

Konstatohet se me 39 vota “për”, 7 vota “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 40 vota “për”, 14 vota “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 38 vota “për”, 11 vota “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 42 vota “për”, 10 vota “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 votë “për”, 10 vota “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “për”, 10 “kundër” dhe 6 abstenime, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 38 vota “për”, 9 vota “kundër” dhe 5 abstenime, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 42 vota “për”, 20 vota “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 47 vota “për”, 10 vota “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 44 vota “për”, 10 vota “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 42 vota “për”, 11 vota “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 46 vota “për”, 10 vota “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 44 vota “për”, 11 vota “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 45 vota “për”, 10 vota “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 44 vota “për”, 11 vota “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 44 vota “për”, 11 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 44 vota “për”, 10 “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 42 vota “për”, 10 vota “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 46 vota “për”, 9 vota “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 46 vota “për”, 10 vota “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 46 vota “për”, 11 vota “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 44 vota “për”, 11 vota “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 45 vota “për”, 11 vota “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “për”, 11 vota “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “për”, 12 vota “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 41 vota “për”, 11 vota “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 44 vota “për”, 11 vota “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Për amendamentin 28 e ka kërkuar fjalën Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës mendon se ky ligj është tepër i rëndësishëm për Kosovën, do t’iu hapë rrugët investimeve në të ardhmen. Mirëpo, mendojmë se amendamenti 28 del prej vijës e cila është ndjekur në gjithë ligjin. Me këtë amendamentet eliminohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, si institucion, i cili është pjesë e vendimmarrjes në këtë proces dhe vendoset Organi Shqyrtues i Prokurimit në vend të komisionit. Ne mendojmë se nëse ky amendament mbetet kështu si ka ardhur, atëherë do të nxisë debate të panevojshme në të ardhmen për mënyrën se si do të merren vendimet në procesin e prokurimit, i cili do të ndodh detyrimisht kur do të zbatohet ky ligj në të ardhmen. Kështu që ne e ftojmë Kuvendin që këtë amendament, vetëm këtë amendament, të mos e votojë.

KRYETARI: Urdhëro, fjalën e ka deputeti Gani Koci.

GANI KOCI: Si duket, është një keqkuptim këtu në mes të asaj që njohim për Ligjin e prokurimit publik dhe përgjegjësitë që i ka Organi Rregullativ i Prokurimit Publik dhe Organi Shqyrtues. Organi Rregullativ i Prokurimit Publik në funksionin e vetë që e ka pasur deri sa është zgjedhur organi shqyrtues, atë funksion nuk e ka më absolutisht dhe Organi Rregullativ i Prokurimit Publik merret vetëm me rregullat e prokurimit publik dhe në rast të shkeljes së këtyre rregullave të prokurimit publik, absolutisht Organi Rregullativ nuk ka të drejtë dhe nuk ka kompetencë të asnjë veprimi. Për shkeljen e këtyre rregullave vendos Organi Shqyrtues. Prandaj, këtu kemi dy mekanizma, e kemi Organin e Prokurimit Publik dhe Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik. Në momentin kur ankesat paraqiten për shkeljen e këtyre rregullave të prokurimit publik, atëherë vjen në shprehje Organi Shqyrtues, prandaj këtu e ka vendin dhe këtu duhet të mbetet, por duhet ditur se cila është kompetenca e Organit Shqyrtues dhe e Organit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Bile, t’ju them të drejtën, Komisioni për Buxhet dhe Financa kur ka shqyrtuar Ligjin për prokurimin publik, kishte mendimin e vet se Organi Rregullativ i Prokurimit Publik duhet të shuhet dhe nuk duhet të ekzistojë më absolutisht.

KRYETARI: Faleminderit! Tash, së pari shkojmë për të votuar amendamentin 28, të propozuar nga Komisioni.

Lus regjinë të përgatitet për votim, votojmë tash:

Konstatohet se me 30 vota “për”, 27 vota “kundër” dhe 4 abstenime, miratohet amendamenti 28.

Amendamenti 29.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 44 vota “për”, 13 vota “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 29.

Amendamenti 30.

Votojmë tash:

Jemi në procedurën e votimit, deputetë.

Konstatohet se me 44 vota “për”, 7 vota “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 30.

Në radhë është amendamenti i fundit 31.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 48 vota “për”, 7 vota “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 31.

Votojmë ligjin në tërësi.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim, votojmë tash:

Në sallë janë 61 deputetë.

Konstatohet se me 52 vota “për”, 7 “kundër” dhe 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për partneritet publiko-privat, koncesione në infrastrukturë dhe procedura për dhënien e tyre.

Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale